Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (187) MARS 2022. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market

Së shpejti

hap marketin e ri në Peshkopi,

rruga "Abdyl Frashëri", pranë kryqëzimit të policisë

Plot oferta dhe surpriza...

DOKUMENTARI

Donika Mustafaj: Ju rrëfej dibranët e mi

Në Muzeun Historik Kombëtar shfaqet dokumentari "Kush është "dibranët"?, prodhim i RTSH

— Faqe 12,13

BOTIME

Greva, siç nuk e kemi njohur

Rreth monografisë së autorit Nehat Daci

Nga **SHAQIR SKARRA**

— Faqe 14

STUDIM

Dibra, qarku i bukurive përrallore të trashëgimisë glaciale në Shqipëri

Nga **ADRIATIK BALLA, FLORIAN FUSHA**

— Faqe 6,7

DEBAT

Diga që ndan dhe shkatërron



Nga **NAZMI KOÇI**

Ka vite që në opinionin dibran, atë kombëtar dhe më gjerë, tema e diskutimit që bëhet gjithnjë e më shpesh është ajo për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, rreth një problemi jetik për luginën e Drinit të zi, për Dibrën dhe dibranët, për të shkuarën dhe të ardhmen e tyre. As më shumë e as më pak, përtej çdo retorike e sofizmash për çka qeveria jonë e sidomos Kryeministri i saj janë ekspertë të fushës, kjo është zhdukje e pellgut të Drinit, e arkeologjisë së pa studiuar të atyre trevave, zhdukje e historisë, asaj të lashtë, të kohës së Skenderbeut dhe të luftrave shekullore me serbët e pushtuesit e çdo kallëpi, zhdukje e ekonomisë dhe kulturës së atyre viseve, specifikisht heroike e punëtore gjithashtu, është në fjalë të fundit zhdukja e Dibrës, e trupit dhe e palcës së saj.

— Faqe 4-5

Duke i thënë "Jo" Skavicës, ne i bëjmë një shërbim shumë të vyer vendit tonë

Nga **SELAMI NAZIFI**

Sot është e domosdoshme shfrytëzimi me eficensë i tokës bujqësore. Koha ka risjellë në skenë nevojën e prodhimit të drithërave për prodhimet bazë. Skavica do ta mbytë luginën e Drinit, këtë hambar të Dibrës dhe Shqipërisë në veri të vendit. Nesër me Skavicën ajo nuk do të jetë më. Dhe ndoshta nesër do të kuptojmë ne dhe brezat gabimin që është bërë.

— Faqe 9

20 milionë euro shtesë për tunelin e Murrizit

Lidhur me kostot shtesë të ndërtimit të alternativës së dytë të tunelit, Ministria e Infrastrukturës shtoi se "kjo vlerë është sipas parashikimeve të kontratës së koncensionit dhe shtojcave të saj, të miratuar me vendimin e sipërcituar. Ju informojmë se çdo kosto për projektin "Alternativa B- Tuneli i Murrizit/Hyrja Tiranë" është pjesë e përcaktimeve ligjore në kontratë dhe brenda detyrimit financiar në kontratën në fuqi", por pa sqaruar, nëse detyrimi financiar për tunelin e ri do të konsiderohet shkak kompensimi apo jo.

Në bazë të preventivit të dorëzuar nga kompania koncesionare, vlera e tunelit të ri arrin në 17.5 miliardë lekë (ose 145 milionë euro), nga 16 miliardë lekë që kushtonte varianti i parë, duke u bërë kështu tuneli më i shtrenjtë, i ndërtuar ndonjëherë në Shqipëri.

— Faqe 3



9 VJET NGA NISJA E PETICIONIT

'Edhe sa herë do ta inaguroni Rrugën e Arbërit?!'

Ndërkohë dibranëve, të cilëve u ka ardhur shpirti në majë të hundës me rrugën e vjetër prej 170 km, 'gëzohen' me rrugën e pa përfunduar. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e Rrugës së Arbërit që është në funksionim, nuk ka të ngjarë me video-klipet e stisura të Kryeministrit Rama, që nuk pasqyrojnë të vërtetën, si për volumin e punimeve, ashtu edhe për cilësinë e tyre. Po kështu, kemi vënë re se nuk ka asnjë komunikim zyrtar ndërmjet Tiranës dhe Shkupit për nisjen e punimeve në Rrugën e Arbërit në Maqedoninë e Veriut.

— Faqe 2

NË BRENDËSI:

■ **Histori**: Kundër ndërhyrjes Jugosllave ■ 'Bacë' **Baftjar Zajmi** i Dohoshishtit të Dibrës ■ Një bisedë e ngrohtë me profesor **Bajram Xhafën** ■ "Pasqyra e thyer" nga **Xhafer Martini** ■ **Kuplon**, 'Vjeshtë e parë" 1991 ■ **Legjenda**: Zanat e Shumbatit, Liqeni i Zi ■ **Tregim alegorik**: ÇSHENJTËRIMI ■ Poezia e dhimbjes njerëzore në pesë libra të **Demir Rusit** ■ **Neki Osmani**, mësuesi i Grazhdanit ■ **Valët e jetës**, të kthyera në valë malli ■ Eh, ç'më kujtove Veliun e furrës, or mec ■ **Nazmiu**, shtatore diturie te ish nxënësit e tij ■ Kur iku në përjetësi **Sami Shehu** ■ Unë nuk isha në varrimin e babait tim

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 3 (187). Mars 2022
Gazeta doli nga shtypi, 5 prill 2022.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Prill 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Adriatik BALLA,
Sami CURRI
Bashkim HOXHA
Xhafer Martini
Muharrem GJOKA
Halil RAMA
Besnik LAMI
Demir OSMANI
Jovan BARDHI
Tefta CAMI
Sulejman TOMÇINI
Stefan KUMARÁKU
Shuaip METHASANI
Zabit LLESHI
Mevlud BUCI
Nazmi KOÇI
Selman MEZIU
Agim DEMIRI
Bujar MUÇA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

‘Edhe sa herë do ta inaguroni Rrugën e Arbërit?!’

Deklaratë e Grupit të Lobimit për Rrugën e Arbërit, në përvjetorin e nëntë të peticionit.

Nga vëzhgimet e fundit në terren, duke parë çfarë është përfunduar, çfarë është në proces dhe çfarë nuk është filluar akoma, mund të themi pa rezerva se kjo rrugë nuk do të inaugurohet, jo vetëm në prill të këtij viti, siç pati premtuar Kryeministi Rama, por as për dy-tre vjet të tjera.

GRUPI I LOBIMIT
21 MARS 2022

Sot u bënë 9 vjet nga fillimi i peticionit online për Rrugën e Arbërit, ndërtimi i të cilës, siç thotë një shprehje dibrane, ‘ka kohë që është bërë tërkuzë (litar)’.

Të indinjuar nga premtimet e rreme elektorale të qeverive të majta e të djathta (terma që në politikën shqiptare janë pothuajse sinonime) që nga viti 2005, kur u bë studimi për fizibilitetin e kësaj vepre, me 18 Mars 2013 një grup intelektualësh dibranë nisën peticionin (tashmë me 20,000 nënshkrime në formularë dhe online) për të bërë presion me mjete demokratike pranë qeverisë që do të dilte nga zgjedhjet parlamentare të atij viti dhe duke premtuar se kjo nismë e shoqërisë civile do të qëndroj jashtë çdo influence partiake dhe do të përfundojë me inagurimin e rrugës sipas standardeve ndërkombëtare.

Këto premtime i kemi mbajtur. Vlen të theksojmë se edhe Kryeministri Rama, me stilin e qeverisjes që e karakterizon, e ka mbajtur betimin e tij për të mos marrë në dorëzim peticionin. Ndërkohë, ky Kryeministër ka 9 vjet që së bashku me pronarët e partive të tjera politike, vazhdojnë t’i servirin elektoratit dibran në çdo fushatë zgjedhjesh lokale dhe parlamentare të njëjtin refren: ‘Na jepni votat nëse doni të shikoni rrugën të përfunduar.’

Ky shantazhim i turpshëm u përsërit edhe në zgjedhjet bashkiake me 6 mars të këtij viti nga të gjitha klanet partiake.

Me këtë rast dëshirojmë të theksojmë se të gjithë kandidatët bashkiakë mbajtën një qetësi shurdhuese për rreziqet që ndërtimi i Skavicës përbën për ekzistencën e Dibrës, kësaj zone me rëndësi unike në historinë e Shqipërisë, burimet e të cilës janë shfrytëzuar dhe vazhdojnë të shfrytëzohen nga shteti sipas një logjike kolonializimi intra-nacional që trajton me shpërfillje deri në përbuzje popullin dibran në territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu si Shkupi zyrtar vazhdon të lërë në harresë pjesën lindore të Dibrës që u nda nga territori i atdheut në vitin 1913.

Për kujtesë të lexuesve, ndërsa kontrata zyrtare thotë se për 80 kilometra rrugë shtetit shqiptar do të paguaj 260 milionë euro, mediat të ndryshme shkruajnë se kjo shumë është shumë herë më e lartë, deri në 400 milionë euro, të cilat kanë filluar të paguhen nga taksapaguesit dhe do të vazhdojë të paguhen në 10 vitet e ardhshme. Ndërsa rruga akoma nuk ka përfunduar, vetëm Zoti dhe shpura e Kryeministrit e di se sa milionë të tjerë do të shkojnë për ndërtimin e kësaj rruge që është inauguruar disa herë, megjithëse dita e përfundimit të saj duket e largët.

Nga vëzhgimet e fundit në terren, duke parë çfarë është përfunduar, çfarë është në proces dhe çfarë nuk është filluar akoma, mund të themi pa rezerva se kjo rrugë nuk do të inaugurohet, jo vetëm në prill të këtij viti, siç pati premtuar Kryeministi Rama, por as për dy-tre vjet të tjera.

Ka shumë mundësi që ky Kryeministër ta bëjë këtë vepër strumbullarin e fushatës së tij elektorale për mandatin e katërt, i ndihmuar nga kori i bretkosave partiake dibrane, që i bëjnë temenara, ndërkohë që ata dhe tarafet e tyre vazhdojnë të majmen nga tenderat që vazhdojnë të akordohen pa transparencë.

Mos vallë Kryeministri pret ‘miratimin’ e Skavicës nga publiku që të vazhdojë ndërtimin e Rrugës së Arbërit?!

Disa segmente të Rrugës së Arbërit, edhe pse jo të standardeve të duhura, duke filluar që nga Tirana deri në fshatin Fshat, është në funksionim. Në një shtet normal përdorimi i një rruge që përbën rrezik për pasagjerët, nuk do të ishte lejuar.

Ndërkohë dibranëve, të cilëve u ka ardhur shpirti në majë të hundës me rrugën e vjetër prej 170 km, ‘gëzohen’ me rrugën e pa përfunduar. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e Rrugës së Arbërit që është në funksionim, nuk ka të ngjarë me video-klipet e stisura të Kryeministrit Rama, që nuk pasqyrojnë të vërtetën, si për volumin e punimeve, ashtu edhe për cilësinë e tyre.

Po kështu, kemi vënë re se nuk ka asnjë komunikim zyrtar ndërmjet Tiranës dhe Shkupit për nisjen e punimeve në Rrugën e Arbërit në Maqedoninë e Veriut. Grupi i Lobimit filloi një dialog konstrukiv me drejtues të politikës shqiptare (lokale dhe vendore) në Maqedoni në vitin 2014, dialog që do të rifillojë së shpejti.

Me këtë rast, falënderojmë përkrahësit e peticionit me shpresë se numri i nënshkrueseve do të rritet në Shqipëri, territoret shqiptare në Ballkan dhe diasporë.

Peticioni mund të nënshkruhet këtu: https://www.change.org



Dy foto nga Rruga e Arbrit në luginën e Planit të Bardhë. Foto lartë është e muajit gusht 2009, atëherë kur nisën punimet në këtë segment rrugor, i gjatë 10 km, i cili është tenderuar me 21,5 milionë euro pa TVSH. Afati i ndërtimit të këtij segmenti ka qenë 20 muaj, por prej vitit 2011 kur duhej të ishte i mbaruar dhe deri më sot, aty nuk janë zhvilluar punime. Foto e dytë është e datës 26 mars 2022. Ky segment flitej se do të hapej në prill të këtij viti, por duket se afati i mbarimit të saj do të shtyhet.



Ndërkohë dibranëve, të cilëve u ka ardhur shpirti në majë të hundës me rrugën e vjetër prej 170 km, ‘gëzohen’ me rrugën e pa përfunduar. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e Rrugës së Arbërit që është në funksionim, nuk ka të ngjarë me video-klipet e stisura të Kryeministrit Rama, që nuk pasqyrojnë të vërtetën, si për volumin e punimeve, ashtu edhe për cilësinë e tyre.
Po kështu, kemi vënë re se nuk ka asnjë komunikim zyrtar ndërmjet Tiranës dhe Shkupit për nisjen e punimeve në Rrugën e Arbërit në Maqedoninë e Veriut.

kryesore



20 milionë euro shtesë për tunelin e Murrizit

Nga **OLA XAMA***

Në mesin e vitit 2019, kur ndërtimi i Rrugës së Arbrit ishte në fazë intensive, kompania Gjoka 87 mori vendimin për ta braktisur zonën e punimeve të tunelit të Murrizit.

Siç shpjegon raporti i grupit të inxhinierëve të Institutit të Ndërtimit, terreni, për shkak të materialeve me përmbajtje argjilore, ishte shumë i lëvizshëm, çka detyroi kompaninë të merrte vendimin për braktisjen e kantierit dhe nisjen e studimit për të ndërtuar në një gjurmë tjetër.

"Ana perëndimore shfaqi shenja të proceseve intensive gjeodinamike, të tilla si rrëshqitjet e mëdha të dheut. Në këto kushte nga zbatuesi i punimeve është kërkuar të bëhet një gjurmë e re e tunelit me kushte më të mira gjeologjike-inxhinierike", - thuhet në oponencën teknike që Instituti i Ndërtimit bëri për projektin e Alternativës B të Tunelit të Murrizit, ku dhe argumentohet vendimi për ndërtimin e tunelit në një zonë tjetër.

Edhe pse kompania në disa raste tentoi të përforconte strukturën e tunelit me ndërtimin e pilotave dhe forcimin e mureve mbajtëse me beton dhe hekur, lëvizjet ndodhnin në pjesën tokësore, duke e bërë veprën të paqëndrueshme.

Në preventivin e koncesionarit shpenzimet për këto punime kapin vlerën 10 milionë euro, faturë, e cila është dorëzuar për kompensim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kostoja e ndërtimit të tunelit të ri arrin në 145 milionë euro, 10 milionë euro më shumë se alternativa e parë, faturë, e cila po ashtu pretendohet të paguhet nga buxheti i shtetit.

DEBATE SE KUSH DUHET T'I PAGUAJË KOSTOT

Prej disa muajsh Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duhet t'i kthejë një përgjigje palës koncesionare, nëse do ta njohë si "shkak kompensimi" faturën shtesë për punimet në tunelin e Murrizit.

Juristja Ledina Mandia, ish-Avokate e Shtetit, sqaron se "Neni 29, pika C e kontratës koncesionare përcakton një rast për shkak kompensimi, kur Koncesionarit i kanë lindur ose do t'i lindin kosto, që nuk do t'i lindnin. Në një rast të tillë ai e fiton të Drejtën e Kompensimit, nëse ka vënë paraprakisht në dijeni Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për ngjarjen dhe humbjen e pritshme."

Debatet lidhur me pagesën e kostove shtesë janë përqendruar për të zbuluar, nëse ka përgjegjësi pala koncesionare si projektuese e segmentit për rrëshqitjet që ndodhën e nëse i ka bërë të gjitha matjet e duhura.

"Koncesionari merr përgjegjësi të plotë për ecurinë e projektit, përshtatshmërinë e skicave ekzistuese të projektimit dhe për çdo informacion tjetër që i është dhënë, përveçse kur përcaktohet shprehimisht si shkak kompensimi", - thuhet në kontratë, por po ashtu kontrata i njeh kompanisë të drejtën për kompensim, nëse gjatë zbatimit të saj kanë dalë probleme gjeologjike, që nuk mund të njiheshin më parë.

"Koncesionari nuk do të jetë përgjegjës për dëmtime, defekte, riparime dhe vonesa në zbatimin e punimeve, të cilat janë shkaktuar si rezultat i përbërjes gjeoteknike, gjeologjike të tokës apo defekte të rrugës, të cilat nuk mund të diheshin apo të zbuloheshin nga koncesionari, duke zbatuar kujdesin e zakonshëm, profesional dhe duke zbatuar metodat e njohura dhe të përdorshme inxhinierike", - saktësohet më tej në kontratë.

Burime zyrtare thanë për Investigative Network Albania, se kompanitë që mbikëqyrin punimet e kësaj rruge, *GR Albania* dhe *Gauff Gmb*, të cilat janë kontraktuar nga shteti shqiptar për të bërë kontrollin e punimeve, kanë dalë në konkluzionin se defektet kanë ndodhur për shkaqe të paparashikueshme gjeologjike, duke miratuar pagesën e faturës në favor të kompanisë koncesionare, *Gjoka 87*.

"Shpimet në malin Starvec për testimin e tokës janë bërë në 35 metra thellësi, ku është konstatuar tokë solide, duke i hapur rrugë ndërtimit të veprës, por, kur kanë nisur punimet, është kuptuar që pas thellësisë së 35 metrave kishte lëvizshmëri të tokës. Më pas në testimet e tjera për të ndërtuar tunelin në zonë tjetër, janë kryer shpime deri në 130 metra për t'u siguruar që nuk do të kishte lëvizje të tokës", - tha një burim zyrtar, i cili kërkoi të mbetej anonim.

"Ky ishte një nga variantet më të lira, pasi mund të përdoreshin metoda të tjera për të vazhduar tunelin në të njëjtën gjurmë, por që do të kërkonin kosto të mëdha apo që në një variant tjetër mund të shkaktonte masakër mjedisore", - shtoi ai.

Në këtë pikë ish-Avokatja e Shtetit, Mandia, sqaron se nuk ka vend për dyshime.

"Nëse është konsideruar shkak kompensimi, do të thotë që kjo është pranuar si e tillë nga Autoriteti Kontraktor dhe Inxhinieri e në këtë rast Koncesionarit i lind e drejta për kompensim", - përfundon Mandia.

Investigative Network Albania dërgoi disa kërkesa për informacion në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për dy muaj rresht, por edhe pas ankesave të kryera nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale e vetmja përgjigje që ka arritur të sigurojë është se ministria do të respektojë kontratën koncesionare, pa u shprehur se kush do t`i paguajë kostot shtesë të ndërtimit të tunelit të Murrizit.

Lidhur me kostot shtesë të ndërtimit të alternativës së dytë të tunelit, Ministria e Infrastrukturës shtoi se "kjo vlerë është sipas parashikimeve të kontratës së koncesionit dhe shtojcave të saj, të miratuar me vendimin e sipërcituar. Ju informojmë se, çdo kosto për projektin "Alternativa B- Tuneli i Murrizit/ Hyrja Tiranë" është pjesë e përcaktimeve ligjore në kontratë dhe brenda detyrimit financiar në kontratën në fuqi", por pa sqaruar, nëse detyrimi financiar për tunelin e ri do të konsiderohet shkak kompensimi apo jo.

> Në bazë të preventivit të dorëzuar nga kompania koncesionare, vlera e tunelit të ri arrin në 17.5 miliardë lekë (ose 145 milionë euro). 1 kilometër i këtij tuneli do të kushtojë 38.1 milionë euro.

Por MIE, edhe pse thotë se risku i projektimit të veprës duhet të mbahet nga privati, saktëson se koncesionari ka kryer të gjitha matjet dhe se defektet ishin të paparashikueshme.

"Qëllimi dhe objekti i kontratës është hartimi i një projekt-zbatimi, në përputhje me Standardet e Projektimit për zgjidhjen më të mirë teknike dhe ekonomike. Gjatë realizimit të projektit dhe gjithashtu në implementim janë kryer studime dhe investigime sipas standardit, por dukuritë dhe fenomenet natyrore, sidomos ato të nëntokës, jo gjithmonë janë të parashikueshme", - përfundon përgjigjen e saj për INA MEDIA-n Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Burime konfidenciale pranë Avokaturës së Shtetit thanë për *Investigative Network Albania* se ka patur diskutime lidhur me pagesën e dëmeve gjatë shembjes së tunelit dhe miratimit të projektit tjetër.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kërkuar një sqarim ligjor pranë Avokaturës së Shtetit se kush do të duhej të paguante diferencën, por deri tani nuk është marrë një vendim përfundimtar.

Vetë ministria në kërkesën për informacion konfirmoi "negociatat" për kostot shtesë.

"Ka patur korrespondencë të vazhdueshme me Avokaturën e Shtetit, lidhur me këtë kontratë koncesionare", - pranon MIE.

145 MILIONË EURO PËR TUNELIN E RI TË MURRIZIT

Projekti i ri i tunelit zgjat me 500 metra gjatësinë e tij, nga 3.3 kilometra, që ishte në variantin e parë, në 3.8 kilometra në të dytin. Sipas të dhënave zyrtare, tuneli do të përbëhet nga dy tuba, një për emergjencat, që do të shërbejë si tunel shërbimi me diametër më të vogël dhe një tjetër me përmasa më të mëdha, ku do të lejohet qarkullimi normal i automjeteve.

Instituti i Ndërtimit ka kërkuar edhe në këtë projekt që të kryhen shpime shtesë me sondë, edhe pas studimeve të tjera gjeologjike që ka bërë firma koncesionare, pasi "vetëm në këtë mënyrë do të evitohen problematikat që ndodhën edhe në rastin e tunelit të parë".

Në bazë të preventivit të dorëzuar nga kompania koncesionare, vlera e tunelit të ri arrin në 17.5 miliardë lekë (ose 145 milionë euro), nga 16 miliardë lekë që kushtonte varianti i parë, duke u bërë kështu tuneli më i shtrenjtë, i ndërtuar ndonjëherë në Shqipëri.

1 kilometër i këtij tuneli do të kushtojë 38.1 milionë euro, ndërsa ai i Llogorasë ka një vlerë prej 23.3 milionë eurosh për kilometër dhe ai i Kalimashit është ndërtuar me një kosto mesatare prej 21 milionë eurosh/ km. Lidhur me këto kosto Instituti i Ndërtimit ka kërkuar sqarime për disa zëra.

"Për të bërë vlerësimin e kostove të ndërtimit duhet të ishin paraqitur volume metrike të ndërtimit", por është shprehur parimisht dakord me vlerën, pasi zërat e tjerë të preventivit janë paraqitur konform rregullave.

Deri tani kanë mbetur 400 metra për t'u hapur në tunelin e emergjencës, ndërsa punimet në tunelin kryesor janë në fillim të tyre. Kjo ka bërë që kompania dhe mbikëqyrësi i punimeve të kërkojnë shtyrje të afateve për përfundimin e veprës për në gusht të vitit 2022.

Rruga e Arbrit është aksi i parë që qeveria zbatoi për projektet koncesionare të ndërtimit në infrastrukturën rrugore, duke përdorur formën e partneritetit publik-privat, ku propozohej që vlera e investimit të kryhej nga kompania, ndërsa shteti do të niste vitin e dytë pas realizimit të 25% të volumit të punimeve pagesën e këtyre për 13 vjet, duke paguar një interes në vlerën e 40 milionë eurove. Investimet e kompanisë Gjoka Konstruksion bashkë me problemet në tunelin e Murrizit për këtë segment janë 235 milionë euro, ndërsa shteti do të paguajë në fund 348 milionë euro.

(Marrë nga INA.media. Botuar me shkurtime. Shkrimi i plotë gjendet në lidhjen më poshtë: https://ina.media/?p=4009&fbclid=IwAR2hGb6e1aWJ2pjQ4dbbQDCxSQ9_D6VFM5wvRpOIPYcm9OBHJ4Vuk096kHQ)

Rruga e Arbërit nr. 187

opinion

As më shumë e as më pak, përtej çdo retorike e sofizmash për çka qeveria jonë e sidomos Kryeministri i saj janë ekspertë të fushës, kjo është zhdukje e pellgut të Drinit, e arkeologjisë së pa studiuar të atyre trevave, zhdukje e historisë, asaj të lashtë, të kohës së Skenderbeut dhe të luftrave shekullore me serbët e pushtuesit e çdo kallëpi, zhdukje e ekonomisë dhe kulturës së atyre viseve, specifikisht heroike e punëtore gjithashtu, është në fjalë të fundit zhdukja e Dibrës, e trupit dhe e palcës së saj.

Diga që ndan dhe shkatërron

Nga NAZMI KOÇI

Ka vite që në opinionin dibran, atë kombëtar dhe më gjerë, tema e diskutimit që bëhet gjithnjë e më shpesh është ajo për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, rreth një problemi jetik për luginën e Drinit të zi, për Dibrën dhe dibranët, për të shkuarën dhe të ardhmen e tyre. As më shumë e as më pak, përtej çdo retorike e sofizmash për çka qeveria jonë e sidomos Kryeministri i saj janë ekspertë të fushës, kjo është zhdukje e pellgut të Drinit, e arkeologjisë së pa studiuar të atyre trevave, zhdukje e historisë, asaj të lashtë, të kohës së Skenderbeut dhe të luftrave shekullore me serbët e pushtuesit e çdo kallëpi, zhdukje e ekonomisë dhe kulturës së atyre viseve, specifikisht heroike e punëtore gjithashtu, është në fjalë të fundit zhdukja e Dibrës, e trupit dhe e palcës së saj. Pas kësaj mbeten ca shkëmbinj e ca pyje që rreth 6 muaj në vit i zë bora, ku ndonjë çoban mund të kullosë ca dhi a dele dhe dhelprat të shëtisin nëpër shkrepa.

Edhe pse nuk banoj në Dibër e jam dhe unë një votues, kësaj radhe dua të them dy fjalë, të shpreh votën time kategorikisht kundër e ti bëj nja dy pyetje kryeministrit të vendit dhe le të më quaj edhe mua tru shplarë e që nuk jetoj me fatkeqësinë e Ukrainës. Por zakonet e të parëve kanë qenë, kur ke mort në shtëpi, mos shko të qash te komshiu. Europa dhe Amerika po e ndihmojnë dhe Ukraina po lufton dhe do të ja dalë vetë, ne u solidarizuam me të, folëm në OKB dhe në Këshillin e Sigurimit dhe kaq mjafton për një popull të vogël si ky yni, që ka një ushtri dhe ekonomi krejt modeste, prandaj mos luani më me kartën e fatkeqësisë së saj. Po përse e mendoj të pa studiuar dhe në kufijtë e aventurës ngritjen e Digës së Skavicës dhe mbytjen e Dibrës. Le të analizojmë disa fakte.

KUR BËRA THIRRJEN "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!

Kur dymbëdhjetë vjet të shkuara e përcolla për ta bërë bashkë vikamën që më buronte nga shpirti "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!" në një thirrje intelektuale që Dibra, siç thoshte enciklopedisti popullor Murat Koltraka, "Lenie Luginën e Drinit të Zi të bukur e të begatë siç e ka krijuar Zoti", ishim pak: Bujari, Aliu, Murati, Xhemali, Linda, Argëtimi, Hakiu...

Të ndrojtur, herë – herë me një gjysmë të shkruari, sepse zë nuk na hapte kush ekraneve shërbëtorë të pushtetit. Nuk u guxua që thirrja të shpërndahej në një sallë dibranësh, të organizohej "promovim libri" siç organizohej rëndom me libra me "poezi pleqsh".

Ti thoshe Skavicës Jo për pushtetarët mburravecë që deklaronin "Unë di të ndërtoj vepra botërore" ishte vetëvrasje, vetëhumbje pune dhe prestigji, rrugë kurbeti...

Ndryshoi diçka: "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!, një parullë e madhe, mbajtur nga dy vetë, u pa këto ditë para kryeministrisë. Më parë ishte parë në NewYork, nga zëra të fortë intelektualësh dibranë, në një peticion për ti thënë me firmë e me shpirt "JO SKAVICËS", në tubime në Dibër, në një konferencë shkencore...

Kohë e re. Mundësi e hapësi të reja për të shkruar e për të ngritur zërin lart që Dibra mos mbytet, që Dibra mos zhytet, që Dibra mos të mbetet një toponim kërkimi historik në brezat që vijnë.

Erdhi koha për të guxuar, për të dalë në rrugë, për tu kundërshtuar, pse jo edhe për tu përleshur në demonstrata për të drejtën, për mbrojtjen e trojeve të blera me flori e të lara në gjak më shumë se çdo krahinë tjetër e Shqipërisë.



E në këtë kohë mendimi intelektual po zgjohet, argumentimi shkencor intelektual për mosmbytjen e Dibrës po ngrihet çdo ditë lart e më lart.

I kërkova një mikut tim ta thotë fjalën e vet për Dibrën, megjithëse trojet e të parëve lart në mal nuk i mbyten. Ma kishte dërguar në një mesazh në linjë të ngushtë kur më shkruante: "Dibra është unike, kur vdes një pjesë ka vdekur e gjithë Dibra"

Lexojeni...

Por më parë merrni laps e letër. Ka shumë dokumente cituar nga studjuesi, dokumente që duhen lexuar, shkruar e rishkruar, jo thjesht për tu mbajtur mend por si udhëheqje për veprim, si kustrim në barrikada.

Dibra duhet të qëndrojë e bukur dhe e begatë si e ka krijuar natyra dhe dora punëtore e Dibranit.

ABDURAHIM ASHIKU
30 mars 2022

PAK HISTORIK:

Ideja e ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës është hedhur diku para nja 50 vitesh kur ndërtoheshin hidrocentralet e kaskadës së Drinit. U bënë disa studime e llogaritje dhe u pa si një çështje e ndërlikuar dhe me pasoja të rënda ekonomike, jo rentabël, bile që cënonte edhe raportet me fqinjët e do të kishte impaktin e vet negativ. U la në sirtar dhe nuk u nxor më prej atje. Tani ka disa vjet që po flitet me të madhe dhe propaganda e ka bombarduar aq shumë trurin e dibranëve që mendojnë se vërtetë do të ja kalojnë edhe Zvicrës. Kaq të bukura janë përrallat e gjyshes sa i kanë vënë në gjumë me sy hapur. Edhe pse e di se do te me quani nostalgjik, si dëshmitar i kohës kur ndërtoheshin hidrocentralet unë mendoj se qe krijuar një traditë, eksperiencë e stafe dhe me siguri një shtet i centralizuar si ai i kishte mundësitë për ta ndërtuar atë vepër. Por nuk e bëri si një vepër jo rentabël, pa përftimin e nevojshëm ekonomik, me pasoja të rënda në shume plane e me që më shumë prishte se ndreqte punë. Në vitin 1976 kur ndërtohej Fierza, një brigadë arsimtarësh dibranë u dërgua dy muaj për të punuar atje, isha edhe unë midis tyre. Rrugës për në Kukës ra një shi i dendur e që zgjati disa orë. Në Kolesjan rrëkeja rrëmbeu një mësues që po kthehej nga shkolla, e përplasi në një përrua dhe ai i shkreti i la fëmijët jetim. Në darkë fjetëm në Kukës, pasi ishte e pa mundur ecja përpara. Fjetëm në Kukësin e ri pasi ai ishte ndërtuar ndërkohë. Me nja dy shokë bëmë vizitë në Kukësin e vjetër, ndërtesat ishin aty bosh, por nuk ishin përmbytur akoma. Rrugës në drejtim të Hasit dhe të Kamit të Tropojës, nëpër kodra ishin ngritur lagje e fshatra të tëra ku pritej te stabilizioheshin banorët e fshatrave që do ti mbulonte uji. Të gjitha gjërat ishin organizuar në mënyrë të rregullt, siç kërkon një vepër serioze. Ndërsa toka atëhere me kushtetutë konsiderohej pronë e shtetit.

Nuk kam dëgjuar asnjë masë të tillë të jetë marrë këto kohë për një vepër kaq të madhe dhe që prek jetën dhe ekonominë e një rrethi të madh siç është Dibra dhe që shpërngul nga trojet e tyre jo pak, por 35 fshatra, të cilat dikur ishin rreth më vete.

E dëgjova një herë një ministreshë që kur flet përkëdhelet dhe nuk merret vesh se ç'thotë, të shpjegonte se "Kompania amerikane që është thirrur për këtë vepër ka eksperiencë në zgjidhjen e këtyre problemeve". Po zonja Ministreshë, por ne të kemi votuar ty të na i zgjidhësh këto probleme, prandaj zgjidhi ose na ler rehat në shtëpitë tona, në trojet e të parëve tanë. Pa i zgjidhur, as një hap nuk duhet bërë përpara.

PROBLEMI EKONOMIK:

Në trajtimin e problemit të pronave të dibranëve që mbyten dhe duhet të kompensohen qeveria luan me dy karta, të dyja në dëm të qytetarëve të atyre trevave.

Së pari, ata janë shumë më të pasur se dokumentacioni që posedojnë për pasurinë e tyre. Ata janë përballë qeverisë së tyre, që vetë e kanë zgjedhur e duhet ti arsyetojë e ti pajisë me dokumentacion, ata nuk janë përballë ndonjë qeverie pushtuese. Në sistemin e mëparshëm, toka u konsiderua pronë e shtetit dhe u kolektivizua. Në vitet e demokracisë, dibranët pa zhurmë shkuan në kufijtë e të parëve dhe respektuan njeri tjetrin e të drejtën e pronës. Qeveritë që erdhën në radhë nuk u kujdesën që ti pajisin me dokumente pronësie qytetarët, u mjaftuan me ndonjë çertififikatë pronësie për disa dynym tokë arë. Por në gjithë Dibrën, sidomos në zonën që mendohet të zërë liqeni, qytetarët posedojnë edhe livadhe e kullota, zabele e pyje, vakëf e mal, troje e varre dhe të gjitha këto janë pronë e tyre, të gjitha duhet të evidentohen e të kompensohen.

Së dyti, thuhet shpesh se do të kompensohen sipas çmimit të tregut. Po kush është çmimi i tregut? Një i tillë në Dibër mungon. Kjo sepse shumë banorë të atyre anëve kanë zbritur në qytete e rreth tyre për një jetë më të mirë. Ata në masë nuk e kanë shitur tokën. Në përgjithësi ua kanë lënë të afërmve të tyre në ruajtje, ose dikujt me ndonjë qera modeste. Ata e dinë vlerën e tokës, prandaj nuk e shesin, ajo është i vetmi mall që nuk prodhohet më. Ato që përmenden si çmim tregu për tokën në Dibër e që sipas llogaritjeve të anës së pushtetit konsiderojnë 1-1.5 Euro një m2 tokë të atij niveli, bëjnë spekulim flagrant e duket sikur tallen me njerëzit. Sipas kësaj logjike 1 m2 tokë kushton më pak se një bukë. Në logjikën e ekonomisë së tregut çmimet nuk i cakton blerësi, por ai që shet, ai që i merret toka në këtë rast. Prandaj kjo kërkon uljen në tryezë me grupet e interesit e pronarët e ligjshëm. Në se ndokush kërkon çmimin e tregut, mbetet të merret parasysh çmimi fillestar i blerjes së saj nga pronarët e ligjshëm. Në fshatin tim që është më shumë se 800m mbi nivelin e detit, janë ende gjallë dëshmitarët që tregojnë se kur një fshatar bleu në kohën e Monarkisë një copë tokë 5-6 dn., pagoi 400 napolona ari. E po të llogaritet se lira dhe napoloni kishin rreth 7 gram një monedhë, i bie që hallexhiu pagoi rreth 3kg. flori për një copë arë. Ky është çmimi real i tregut. Ka dhe njerëz të arsyeshëm, siç pata rastin të dëgjoj një deputet të maxhorancës, i cili tha se fatura reale ekonomike e kësaj vepre kushton miliarda dollarë.

PO PËRFITIMET NGA NDËRTIMI I KËSAJ VEPRE CILAT JANË?


Gjatë këtyre ditëve, në përpjekje për të argumentuar nevojën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, Kryeministri i vendit bëri një deklaratë kuptimplotë.

Ai tha se me hidrocentralet që kemi trashëguar ne mbulojmë rreth 70 % të nevojave të vendit me energji elektrike. (Po, pasi në këto 30 vjet nuk kemi ndërtuar ndonjë vepër që të ndikojë në prodhimin vendas të energjisë veç ndonjë heci lokal pa ndonjë ndikim të dukshëm). Atëhere rezulton që rreth 1/3-tën e kemi blerë sipas nevojave, rastit e stinës. Në se është fjala për 1/3 e nevojave, një qeveri që ecën me laps në dorë duhet ta menaxhojë situatën. Ajo mund të bëjë kujdes me shumë për kursimin e energjisë në stinët me shi, ruajtjen, apo huazimin e saj të tjerëve, për ta marrë në momente kur ne kemi nevojë. Jam i informuar se kur kemi energji tepër ne e shesim atë lire, ndërsa kur na nevojitet e blejmë shtrenjtë. Kësaj në Dibër i thonë, shit qen e blej këlyshë. Pa dashur të bëj specialistin ka shumë mënyra alternative të prodhimit të energjisë, pa ndërmarrë veprime me karakter aventure, që përmbysin një rreth të tërë dhe një pjesë të rëndësishme të territorit të vendit. Këto ditë pata rastin të lexoj një informacion mbi një investim rreth 200 miliard dollarë që vendet e BE, do të realizojnë në kuadër të një projekti për të marrë energji nga burimet e erës dhe panelat në pa mundësi tjetër, do ti vendosin në det. Imagjinojeni Dibrën me shtrirjen gjeografike që zë gjysmën e pjesës lindore të vendit,nga kufiri shtetëror me Maqedoninë në Gjoricë e deri në Kukës, atë luginë që përshkon Drini me bukurinë që natyra i ka dhënë. Gjatë gjithë këtij rrugëtimi disa km të gjatë në Drin derdhen lumenj e përrenj malorë dhe këta janë mundësi potenciale për prodhim të energjisë pa bërë atë përmbytje kataklizmike që bën diga që mendohet të bëhet mbi degën kryesore të Drinit, një nga lumenjtë më të gjatë e më të rëndësishëm të vendit.

Por në se do të përdoreshin burimet e erës për prodhim të energjisë, mundësitë janë të pafundme. Imagjinoni shpatet e larta malore me dhjetëra km të gjatë të Kërçinit, Deshatitit e Korabit, filloni në se doni nga gryka e Llangës e deri në Krej Lurë, në Qafë Bualli, Qaf Drajë e deri në Qaf Murrë ku ka shpate pa fund ku era dhe flladi nuk ndalen asnjë herë. Në to nuk ka nevojë të instalohen sisteme të ndërlikuara si ai i projektit të BE, që duhet të vendosë stativë me dhjetëra a qindra metra të gjatë në thellësi te detit. Jo, ne natyra na i ka dhënë gati, janë ekonomike dhe ekologjike njëkohësisht. Në se vërtetë do të bëhet një investim serioz në këtë drejtim jo vetëm Dibra nuk ka nevojë të mbytet, por dhe do të kemi siguruar energji elektrike për vendin tonë dhe disa vende të Ballkanit. Kam bindjen se do të duhet një përqindje fare e vogël e asaj shume që është menduar të përdoret për të mbytur Dibrën dhe historinë e saj. Po kështu mundësia e vendosjes së paneleve diellore e burimeve

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

debat



Hidrocentrali i parë që është ngritur mbi rrjedhën e Drinit është ai i Spiles në territorin e Maqedonisë, disa qindra metra larg kufirit tonë shtetëror. Por edhe në territorin shqiptar është ndjerë impakti i tij. Kush e njeh nga afër atë zonë e din fort mirë se në stinë të caktuara edhe në ditët me diell, Gjorica dhe pellgu i saj e fshatrat e Maqedonisë përballë, mbulohen nga një mjegull e dendur dhe vetëm nga pasditja mund të shohin ndonjë rreze dielli, bimët që rriteshin dikur me bollëk tani bëhen me vështirësi atje.

Dibranët ia dinë vlerën tokës, prandaj nuk e shesin. Toka është i vetmi mall që nuk prodhohet më. Ato që përmenden si çmim tregu për tokën në Dibër, e që sipas llogaritjeve të anës së pushtetit konsiderojnë 1-1.5 Euro një m2, bëjnë spekulim flagrant e duket sikur tallen me njerëzit. Sipas kësaj logjike 1 m2 tokë kushton më pak se një bukë. Në logjikën e ekonomisë së tregut çmimet nuk i cakton blerësi, por ai që shet, ai që i merret toka në këtë rast. Prandaj kjo kërkon uljen në tryezë me grupet e interesit e pronarët e ligjshëm.

të tjera alternative të sigurimit të energjisë në vend, janë të pafund në Dibër e në gjithë Shqipërinë pa bërë përmbytje kataklizmike siç bën diga e Skavicës.

ARKEOLOGJIA:

Dibra është një trevë e banuar herët dhe në kohen e ilirëve aty ishin Penestët. Kush ka kërshëri të mësojë më shumë mund të lexojë punimin e shkencëtarit të mirënjohur dibran Adem Bunguri "Prehistoria e Dibrës". Aty do të mësoni shumë të dhëna për lashtësinë e kësaj treve, por dhe një të vërtetë shumë të hidhur. Objektet arkeologjike në Dibër janë studiuar në një masë fare të vogël që ka filluar pas vitit 1970-të. Kjo do të thotë se objektet arkeologjike në Dibër, në shumicën e tyre janë ende pa u studiuar.(1) Këto do të asgjësohen përgjithmonë. Dihet se njerëzit e parë u vendosën pranë lumenjve ku kishin resurse për të banuar. Mendoni pak se Dibra dhe pellgu i Drinit janë më poshtë se shumë qytete të tjerë, më poshtë se Pogradeci, Struga e Ohri, Korça e Maliqi, sepse lumi buron prej andej dhe rrjedh poshtë gjatë luginës. Ka shumë gjëra për të studiuar dhe me këtë projekt ne do ti varrosim përgjithmonë ato, kemi varrosur historinë tonë, të lashtë e të re.

Gjatë zgjerimit të rrugës Bulqizë –Peshkopi, në Grazhdan, një fshat afër Peshkopisë, u zbuluan muret e një kalaje të lashtë që ndërtuar në periudhën e pushtimit romak. Historia është aty dhe ka nevojë të studiohet.

Duke gërmuar tokat e bukës në fshatin Muglicë të Okshtunit u gjetën disa enë balte që tregojnë se aty kanë banuar njerëz së paku që nga mesjeta e hershme. Kalldrëmet në Borovë, Okshtun e Lladomericë, qytezat ilire në gjithë Dibrën duhet të studiohen me vëmendje, pasi deri sot pak profesionistë dhe ndonjë mësues amator janë marrë me këto punë.

Në zonën e pellgut të Drinit e në Dibër të poshtëme ka pëllëmbë e objekte arkeologjike. Një mjek amator që punonte dikur në ato anë, duke bërë xhiro për qef të vet, zbuloi një shpellë interesante. Kur atë e vëzhguan specialistët e fushës përkatëse, rezultoi të ishte një objekt arkeologjik i klasit të parë.

Në një emision televiziv të kohëve të fundit u tregua për një zbulim interesant në një shpellë që nuk është në breg të lumit, por në rrëzë të malit të Pratit, mbi fshatin Mazhicë te Grykës së Vogël. U gjetën mbetje njerëzore aty dhe pati shumë hamendësime e spekulime, por studimet shkencore të realizuara në një shtet të përparuar të Europës, vërtetuan se ato eshtra ishin të shekullit te II-III të erës tonë, pra 1700 apo 1800 vjet më parë aty kanë banuar njerëz. Shkenca sot e zbuloi këtë fakt, por duke mbytur pellgun e Drinit dhe fshatrat që banojnë aty, ne e kemi zhdukur përjetësisht mundësinë për ti studiuar ato.

HISTORIA:

Historia e atyre anëve është e pasur, po shumë e pasur. Për këtë kanë shkruar shumë të tjerë dhe thjeshtë do të them disa fjalë. Është fakt historik se aty është vendlindja e Kastriotëve e për këtë flet fare qartë historiani Kristo Frashëri në "Historia e Dibrës" (2012) (2). Ka dhe një muze historik për Kastriotët, tamam aty. Po ashtu ka dokumente të sakta se në atë zonë u zhvilluan shumë beteja e masakra nga perandoria turke. Aty nuk ka gurë pa njolla gjaku. Aty luftoi Skënderbeu me trimat e tij dhe nga 25 betejat historike qe zhvilloi me turqit, 19 i përkasin Dibrës (3). Është Skënderbeu që të gjithë fqinjët kërkojnë ta përvetësojnë, por ai mbetet shqiptar dhe pikërisht i kësaj ane ku edhe luftoi si luan për rreth 25 vjet. Kush ka shkuar në Romë dhe e ka parë atë, e din se në një nga sheshet kryesore të Romës ndodhet një përmendore e Skënderbeut mbi kalë, që ngjason me atë të Krujës, por është ndërtuar para saj. Në të është shkruar në gjuhën e tyre: "Kushtuar Gjergj Kastiroti Skënderbut, heroit kombëtar të Shqiptarëve, mbrojtës i madh i krishtërimit dhe i qytetërimit Europian". Ai shesh e ka emrin Piazza Albania dhe prej aty fillon një rrugë me emrin Via Tirana. Ata janë kujdesur për historinë tonë, pasi kështu bëjnë kombet e qytetëruar. Ndërsa ne jo, ne jemi gati ta mbysim përgjithmonë historinë tonë. Gjermanët e ruajnë Holokaustin edhe pse ai nuk ju bën nder atyre, por e ruajnë si një dëshmi historike. Ndërsa ne e groposim historinë tonë edhe kur ajo është e lavdishme. Popujt e tjerë i krijojnë heronjtë e tyre nga legjendat, i nxjerrin nga balta, kurse ne jemi të prirur ti baltosim e përmbysim tanët edhe kur janë figura reale historike. Kështu veprojnë vetëm kombet barbarë, jo ata të qytëruarit.

Në se do ti përmbahemi fabulës së "përrallës së Gjyshes" që u tregua kohët e fundit edhe në Peshkopi dhe që ja kalon edhe përrallave të Andersenit, sikur këto zona do të bëhen si Venecia dhe njerëzia do të lodhen duke shëtitur me gondola nëpër liqen, më lejoni të tregoj edhe unë "përrallën" time. Sa mirë do të ishte që të mos mbytet lugina e Drinit dhe të ruhet, siç do të ju thoshte një fetar me kulturë banorëve të Thethit në Shkodër "ruajeni këtë mrekulli të natyrës ashtu siç zoti e ka jeretisë". Sa mirë do të ishte që kjo zonë të bëhej një park natyral me përmbajtje historike. Sa mirë do të ishte që në atë park të improvizoheshin të gjitha betejat dhe fitoret e Skënderbeut dhe të shqiptarëve në shekuj, por dhe shumë beteja të tjera. Mund të jetë aty selia e "Komitetit Kombëtar të Arrasit " me atributet e një qeverie, ku drejtoi Elez Isufi si Kryetar. Atëherë po, do të shihni se si do mbushej me turistë ai vend e si do të gumzhinte ai park me dhjetëra kilometra i gjatë. Por historia na tregon se dibranët nuk kanë luftuar vetëm me turqit. Atëherë ja vlen në këtë "muze" të ketë edhe një pavion për

Vepra të tilla kanë ndikim të fuqishëm mbi klimën e rajonit e më gjërë. Ata i prishin ekuilibrat e natyrës dhe biodiversitetin ekologjik dhe sjellin ndryshime klimatike që në shkallë globale rrezikojnë jetën në tokë. Prandaj bota sot është në këmbë dhe ka ndaluar ndërtimin e digave të larta e atje ku janë po i çmonton ato.

luftërat legjendare me serbët, me bullgarë, gjermanë, italianë e pushtues të çdo kallëpi. Këtë e ka sqaruar mirë ushtaraku Moisi Murra në librin e tij " Dibra nga Antikiteti ne Monarki" ku thotë: "Nga viti 1444 kur shqiptarët nënë udhëheqjen e Skënderbeut nisën dhe fituan betejën e parë kundër turqve osmanë, në Torvioll, Fushë të Kastriotit të Dibrës së poshtme dhe deri në çlirimin e Dibrës nga pushtuesit nazi fashistë me 2 shtator 1944, dibranëve u është imponuar një luftë në çdo 10 vjet"(4), pra gjatë pesë shekujve kanë zhvilluar mbi 50 luftëra të mëdha. Në se do të bëhej një vepër e tillë, turistëve do tu duheshin disa ditë për ta vizituar. Por që të bëhet kjo sigurisht do rrugë të asfaltura, teleferikë, resorte e infrastrukturë tjetër nga ajo që është sot. Në atë park natyral mund të ngrihen teleferikë që njerëzia të shohë edhe Qafën e gëlqeres e të ngjitet edhe në Lan Lurë. Pse jo, më tej edhe një teleferik për te Liqenet e Lurës. Ndoshta ndonjë guximtarë do thoshte bëni dhe ndonjë pistë për të rrëshqitur me ski, sepse ato zona nga bukuria nuk kanë gjë mangët nga Kolashini a Movrova, për veç dorës së njeriut që ka punuar më pak. Dikush mund të më thotë se duhen fonde. Unë ju siguroj se do te mjaftojnë fondet e Digës dhe që ky investim mund të sjellë fitim më shumë se çdo hidrocentral, përfitime kulturore dhe ekonomike, pa shkaktuar asnjë dëm. Edhe Rruga e Arbërit për këtë qëllim u ndërtua, përndryshe ç'kuptim ka, ndërto rrugën dhe pastaj mbyt Dibrën?

Me që i përmenda fqinjët të cilët kanë bërë masakra ç'njerëzore në gjithë Dibrën, ata kanë patur në qëllimet e tyre strategjike anën lindore të rrjedhës së Drinit dhe këtë objektiv e përmbush për mrekulli diga dhe liqeni që krijon ajo, i cili siç thotë Abdurahim Ashiku, e ndan Dibrën për mesi ashtu siç ndahet berri për penës së kurrizit(5). Ata përpiqeshin ti bindin dibranët se në se ju do të pranoni të bëheni me ne, (me Serbinë, shën. im), ne do të ju ndërtojmë një hekurudhë gjatë bregut të Drinit që të dilni direkt në Prizren. Ndërsa Elez Isufi u përgjigjej : "Në na ngucshi shumë, paska qenë thënë që ne të ngelim pa shtëpi dhe ju pa krye"(6).

Ky vend pëllëmbë e histori, pëllëmbë e heroizma, po projektohet të mbytet përgjithmonë. Kush do ta mbajë përgjegjësinë para historisë. Aktorët po e po, por edhe spektatorët kanë përgjegjësi të madhe historike. Burrat e dheut që luftuan e ranë në këto troje për ti mbrojtur ato, nuk do të falin askënd si ai që mori kazmën, ashtu edhe ai që heshti dhe lejuan të mbytet një trevë historike, nga më të lavdishmet në gjithë Shqipërinë, hambar drithi e djep historie dhe një perlë e natyrës e pa përsëritshme në llojin e vet. Neroni, perandor i Romës, e dogji atë dhe hyri në histori. Roma e ndërtua e rindërtua, por turpi mbi Neronin ka mijëra vjet që rëndron. Nuk besoj se brezat e sotëm do ta mbajnë këtë barrë para historisë. Megjithëse në pazar dibranët pyesin: "E ke tënden, apo ta ka lënë baba".

Shkrimtari i njohur dibran Abdurahim Ashiku nga Athina thërret: "Është koha që të ngrihet zëri për mos mbytjen e Dibrës, bukurisë dhe historisë së lavdishme të luginës së Drinit " (7).

EKOLOGJIA DHE KLIMA

Vepra të tilla kanë ndikim të fuqishëm mbi klimën e rajonit e më gjërë. Ata i prishin ekuilibrat e natyrës dhe biodiversitetin ekologjik dhe sjellin ndryshime klimatike që në shkallë globale rrezikojnë jetën në tokë. Prandaj bota sot është në këmbë dhe ka ndaluar ndërtimin e digave të larta e atje ku janë po i çmonton ato. Në SHBA, thotë Fazilete Gjika, janë çmontuar mbi 2000 diga të tilla.

Hidrocentrali i parë që është ngritur mbi rrjedhën e Drinit është ai i Spiles në territorin e Maqedonisë, disa qindra metra larg kufirit tonë shtetëror. Por edhe në territorin shqiptar është ndjerë impakti i tij. Kush e njeh nga afër atë zonë e din fort mirë se në stinë të caktuara edhe në ditët me diell, Gjorica dhe pellgu i saj e fshatrat e Maqedonisë përballë, mbulohen nga një mjegull e dendur dhe vetëm nga pasditja mund të shohin ndonjë rreze dielli, bimët që rriteshin dikur me bollëk tani bëhen me vështirësi atje. Ndërsa fshatrat nga Shupenza e lartë dielli i ndriçon që në orët e para të mëngjesit e bujqësia zhvillohet normalisht. Se çfarë ndikimi pati ky hidrocentral mbi banorët shqiptarë që jetojnë në Maqedoni, po ja lë fjalën Argëtim Fidës, ish kryetar i Komunës në Dibër të Madhe (cituar A.A.): "Dibranët nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës dhe hidrocentralit të Spiles nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet, pos humbjes së 5000 hektarë të tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane. Sot të mirat nga prodhimi i rrymës përfitohen vetëm nga qeveria maqedone që nuk don të dijë në se këto familje u detyruan të largohen në Turqi ose ShBA për të siguruar ekzistencën"(8).

(Vijon)

Rruga e Arbërit nr. 187

studim

Një vështrim gjeografik mbi liqenet akullnajore të qarkut Dibër

Dibra, qarku i bukurive përrallore të trashëgimisë glaciale në Shqipëri

Nga **ADRIATIK BALLA**
(Doktor i Shkencave Gjeografike)
FLORIAN FUSHA
(Doktor i Shkencave Gjeografike dhe Antropologjike, Firence-Itali)



Fig. 1. Paraqitje e liqeneve akullnajore në fragmentin e imazhit satelitor që paraqet qarkun Dibër.

Lura është simboli përfaqësues i liqeneve akullnajore në Shqipëri. Në masivin magmatik të Kunorës së Lurës ndodhen afro 20 liqene, por vetëm 15 prej tyre mbajnë ujë thuajse gjithëvjetor. Grupi kryesor është ai i liqenit të Madh, ku ndodhen 6 liqene, por liqeni i Madh bën diferencë pasi në kapacitetin maksimal ujor ka sipërfaqe afro 11.7 hektarë (të gjitha shifrat që jepen nga AZM Dibër dhe në literaturë nga autorë të ndryshëm më herët duhen marrë me rezervë.

HYRJE

Liqenet akullnajore janë një nga pasuritë e çmuara të vendit tonë. Shumë pak është folur për vlerat e tyre të rralla shkencore, peizazhore, turistike, ekonomike e natyrisht fiziko-gjeografike, dhe shumë pak është bërë për t'i mbrojtur këta "sy të kaltër" në zemër të maleve shqiptare.

Gjatë Kuaternarit, klima është ftohur e ngrohur disa herë, duke krijuar të ashtuquajturat periudha akullnajore (glaciale) midis të cilave shtriheshin periudhat ndërakullnajore (ndërglaciale). Njihen 4 periudha akullnajore gjatë 2 milionë vjetëve të fundit, por në territorin shqiptar kanë lënë gjurmët e tyre akullzimet e Rissit (i parafundit) dhe akullzimi i fundit që njihet si **Vyrmian (Würm)**. Akullzimi i fundit është shtrirë në lartësinë mbi 1100-1300, e nëpër luginat e Alpeve edhe poshtë kësaj lartësie. Tre tipe akujsh janë regjistruar në këtë periudhë akullzimi që nisi 115 mijë vjet më parë e përfundoi 10 mijë vjet më parë. Tipi i parë është akulli luginor, me trashësi deri në 200 m, sot në reliev shfaqet me luginat e lugjet akullnajore në relievin e lartë në Alpe, Korab etj. Tipi tjetër është ai i pllajave, në lartësitë mbi 1500 m, gjurmët e të cilit nuk janë shumë të ruajtur për shkak të erozionit pas akullnajor ndërsa tipi i tretë është ai i cirqeve, ku format e erozionit akullnajor nga ky tip ruhen më mirë se kudo tjetër në relievin malor mbi 1300 e sidomos në lartësitë 1600-1800 m. Më të shprehura format e relievit akullnajor të cirqeve janë të shprehur në Alpe, por edhe në vargmalin e Korabit dhe atë të Lurës, vargjet malore në rrjedhjet e mesme të Shkumbinit e Devollit, në Gramoz etj. Në fundin e cirqeve, gropat e krijuara nga zhvendosja e akujve dhe shkrirja e tyre çoi në mbushjen me ujë dhe shndërrimin në liqene, të cilët ruhen deri në ditët e sotme.

Liqenet dhe format e relievit akullnajor janë më të ruajtura në zonat që ndërtohen nga shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë, pasi këta lloj shkëmbinjsh janë të patretshëm kimikisht dhe të padepërtueshëm, prandaj këto forma ruhen më mirë se në shkëmbinjtë karbonatikë dhe mbi shkëmbinjtë terrigjenë.



Foto 1. Liqeni i madh i Lurës (foto nga Artur Nikolli, maj 2021)

Parë në këtë kuadër, masivet malore të Lurës, Balgjait, Dhoksit, Shebenikut, Valamarës etj, mbajnë grupet kryesore dhe numrin më të madh të liqeneve akullnajore. Në të gjithë Shqipërinë, të evidentuar nëpërmjet hartave topografike 1:25000 dhe imazhet satelitore të 20 vjetëve të fundit, janë 225 liqene akullnajore dhe karsto-akullnajore, por vetëm afro 100 prej tyre mbajnë ujë gjithëvjetor dhe janë të shëndetshëm plotësisht. Të tjerët janë me ujë të përkohshëm, të karakterit stinor, ose me ujë vetëm për një muaj apo dhe për disa javë kur shkrin bora në pranverë.

Qarku i Dibrës, ka plot 115 liqene të tillë, por vetëm 55% e tyre mbajnë ujë vazhdimisht, të tjerët janë ose në proces tharje të pakthyeshëm, ose me ujë të përkohshëm e me tipare jo shumë të qarta.

1. LIQENET E LURËS

Lura është simboli përfaqësues i liqeneve akullnajore në Shqipëri. Në masivin magmatik të Kunorës së Lurës ndodhen afro 20 liqene, por vetëm 15 prej tyre mbajnë ujë thuajse gjithëvjetor. Grupi kryesor është ai i liqenit të Madh, ku ndodhen 6 liqene, por liqeni i Madh bën diferencë pasi në kapacitetin maksimal ujor ka sipërfaqe afro 11.7 hektarë (të gjitha shifrat që jepen nga AZM Dibër dhe në literaturë nga autorë të ndryshëm më herët duhen marrë me rezervë. Autorët e këtyre radhëve kanë mbi 15 vjet që monitorojnë situatën e tyre në të gjithë Shqipërinë dhe po botojnë me bashkëautorë monografinë "Liqenet akullnajore të Shqipërisë"). Liqenet e tjerë rreth e qark tij kanë sipërfaqe maksimale jo më shumë se 2-3 ha, ku spikasin i Rrasave, i Lopës, i Tushës etj.

Një liqen i bukur, por disi i vetmuar ndërmjet majës së Kunorës dhe Nezhdës së Lurës, është ai i Hotit, me sipërfaqe maksimale 2 ha, liqen relativisht i thellë, i rrethuar me pyje, por të dëmtuar disi vitet e fundit. Më në jug, në vazhdim të Nezhdës së Lurës, shtrihen dy grupe liqenesh. Fillimisht liqeni i Zi dhe liqeni i Thatë, bashkë me një tjetër të paemër, që përbëjnë një trio unike në këto lartësi, me ujë gjithëvjetor, ngjyrë blu të thellë dhe të rrethuar me pisha që u japin bukuri mahnitëse. Në skajin më jugor të Nezhdës së Lurës, shtrihen dy liqene të veçantë, që janë ai i Kallabekës dhe i famshmi liqen i Luleve, i pari me sipërfaqe 4 ha e tjetri me 1.5 ha. Bimësia halore që i rrethonte është dëmtuar së tepërmi vitet e fundit dhe është vënë në rrezik vetë liqeni i Luleve, nga ku ka marrë emrin për shkak të një zambaku të bardhë uji që lulëzon në qershor (Nymphaea alba).

Liqenet e Lurës janë përfshirë që nga viti 1966 në parkun me të njëjtin emër, i zgjeruar vitet e fundit edhe me atë të Zall-Gjoçajt. Por edhe pse zonë e mbrojtur, bimësia në park është dëmtuar në 20 vjetët e fundit , duke krijuar një situatë aspak të këndshme.

2. LIQENET E BALGJAIT

Për nga numri, përmasat dhe disa tipare morfohidrografike, liqenet akullnajore të Balgjait shënojnë kulminacionin e trashëgimisë glaciale në Shqipëri. Veçantia tjetër e




Foto 2. Grupi i liqeneve të Allamanit në masivin e Balgjait (foto e autorëve, korrik 2021).

këtij masivi është se liqenet ndahen sipas kreshtave ujëndarëse në katër bashkitë e qarkut, pra Dibrës, Bulqizës, Matit dhe Klosit, ku secila bashki përfaqësohet me më e pakta nga një grup liqenesh. Në periudhën ujëshumë dhe në fund të pranverës kur shkrin masivisht bora, në të gjithë Balgjain numërohen deri në 45 liqene, prej të cilëve grupin më të madh e përbën ai i Allamanit, me afro 20 liqene në total por shumica me ujë të përkohshëm. Në këtë grup 4 janë liqenet që bëjnë diferencë, ai i Hysen Begut me sipërfaqe maksimale 12 ha, i Allamanit me 4.5 ha, liqeni i dyfishtë i Allamanit me 5.5 ha, si dhe liqeni i Dhive me një bukuri mahnitëse me 1.7 ha.

Grupi i dytë më i madh është i Kacnisë, ndoshta liqenet më të bukur akullnajorë të Shqipërisë, që krahasohen me ata të Lurës por ndoshta janë edhe më të bukur. Në periudhën ujëshumë numërohen mbi 15 liqene, të ndarë në dy nëngrupe, së pari liqenet e mirëfilltë të Kacnisë, që janë të sistemuar që gjysmëshekulli më parë si pasojë e shfrytëzimit të ujt të tyre për ujitje nëpërmjet një kanali vaditës që shkon deri në Maqellarë, si dhe nëngrupi i liqeneve të Bataqeve, që janë unikalë për nga bukuria. Në grupin e parë spikasin liqeni i Zi (i madh) i Kacnisë, me 9 ha në maksimum, ai i Shtrungës me 6.5 ha, i Barzanës me 2 ha, liqeni "Yll" i fshehur

Ritheksojmë se liqenet akullnajore janë një pasuri e madhe e vendit dhe e turizmit malor në Shqipëri, e në këtë kuadër, qarku i Dibrës spikat në të gjithë vendin për përqindjen e konsiderueshme të kësaj pasurie.



Foto 3. Liqeni i Zi (madh) në grupin e liqeneve të Kacnisë (foto e autorëve, korrik 2021).

mes kreshtash shumë të larta e të mprehta të Balgjait verior (1.8 ha) etj. Në grupin e Bataqeve nga 7 liqene gjithsej 4 mbajnë ujë gjithë vitin, me sipërfaqe maksimale secili deri në 2 ha, ku spikasin ai i Milloshit, i Kalisë etj. Ndërmjet grupit të Allamanit dhe atyre të Kacnisë spikat një grup më i vogël me 3 liqene gjithsej, ku diferencën e bën liqeni i Kolo Madhit, pranë majës së kotecit të Ramës, liqen me sipërfaqe maksimale deri në 4 ha, por me bukuri të madhe.

Po në Balgjai, i rëndësishëm është dhe grupi i liqeneve në Balgjain qendror, ku spikat në shpatin perëndimor liqeni i madh i Balgjait, me sipërfaqe afro 5 ha, që e përmend dhe autori italian Sestini që më 1940. Pranë tij shtrihet një liqen më i vogël por me bukuri të veçantë. Në shpatin lindor, para një shekulli (referuar hartave topografike) shtriheshin plot 9 liqene, të fushës së Balgjait, por nga ata që mban ujë thuajse gjithë vitit është vetëm njëri, kurse të tjerët po shkojnë drejt tharjes përfundimtare. Drejt zhdukjes janë edhe liqenet në cirqet akullnajore të Balgjait jugor, pranë majës së Kreshtës, si pranë lugut të Valit, ai i Dragunit në shpatin juglindor etj.

3. LIQENET E MARTANESHIT

Martaneshi ka një numër të madh liqenesh akullnajore, e me përmasat nga më të mëdhatë e këtij lloji në Shqipëri. Për nga sipërfaqja, liqenet e Martaneshit zënë afro 30% e të të gjithë liqeneve akullnajore të



Foto 4. Liqeni i Zi i Valikardhës në masivin e Martaneshit (foto e autorëve, qershor 2021).

Shqipërisë, kurse për nga numri zënë 10 %. Diferencën në Martanesh e bëjnë dy liqene, ai i Sopeve dhe liqeni i Zi i Valikardhës, që përbëjnë edhe dy liqenet më të mëdha të këtij tipi në Shqipëri. Liqeni i Sopës është me origjinë të gropës akullnajore, por formimi i tij ka edhe natyrë artificiale për shkak të digës, e cila ka krijuar një liqen me sipërfaqe maksimale 34 ha. Kurse liqeni i Zi i Valikardhës, që llogaritej nga Sestini në vitin 1940 si më i madhi i këtij tipi në Shqipëri, me sipërfaqe 21 ha, sot është një liqen me sipërfaqe mesatare 16.5 ha, ujërat e të cilit shfrytëzohen nga një HEC pranë fshatit Valikardhë. Ky liqen është unik në Shqipëri për nga thellësia, pasi shkon deri në 60 m dhe është liqeni me volumin më të madh ujor nga ky lloj në Shqipëri. Me përjashtim të liqenit të Sopeve, që është disi i vetmuar (të tjerët pranë tij po thahen në mënyrë të pakthyeshme), liqenet e tjerë të Martaneshit janë në grupe. Grupi më i madh është ai i Tërnovës, ku spikat liqeni i Zi, dy liqenet e Bardhë (5 dhe 8 ha), si dhe liqeni i Sopotit (7 ha në maksimum). Përveç tyre, ndodhet dhe




Foto 5. Liqeni i Skënderit në Dhoks, malësinë e Martaneshit (foto e autorëve qershor 2021).

një ujëmbledhës me sipërfaqe maksimale 15 ha, por ai ka marrë jetë vitet e fundit si paspojë e ndërhyrjeve humane.

Grupi i dytë më i madh është ai i Dhoksit, mbi qytetin e vjetër të Bulqizës, me 6 liqene gjithsej, ku spikasin për bukurinë e tyre mahnitëse, thellësinë e konsiderueshme dhe pastërtinë e ujërave. Spikat ai i Skënderit, me 3.2 ha, i Koçhysës me sipërfaqe maksimale 3 ha, liqeni i Thatë (Duriçeve) me 4.5 ha maksimalja, i Gjuricës (1.5 ha), si dhe dy liqene

Grupi i dytë më i madh është i Kacnisë, ndoshta liqenet më të bukur akullnajorë të Shqipërisë, që krahasohen me ata të Lurës por ndoshta janë edhe më të bukur. Në periudhën ujëshumë numërohen mbi 15 liqene, të ndarë në dy nëngrupe, së pari liqenet e mirëfilltë të Kacnisë, që janë të sistemuar që gjysmëshekulli më parë si pasojë e shfrytëzimit të ujt të tyre për ujitje nëpërmjet një kanali vaditës që shkon deri në Maqellarë, si dhe nëngrupi i liqeneve të Bataqeve, që janë unikalë për nga bukuria.



Foto. Liqeni i Zi i Radomirës (foto Artur Nikolli, 2021)

Qarku i Dibrës ka në gjirin e vet një prej pasurive natyrore më të çmuara, sepse liqenet akullnajore konsiderohen të tillë në çdo vend europian që ka të tillë. Prandaj lipset që ata të qëndrojnë larg ndërhyrjes humane. Por mund të shfrytëzohen për turizëm, nga grupe të ndryshme alpinistësh dhe atyre që pëlqejnë ecjet malore (hiking), apo shëtitjet për ajër të shëndetshëm etj.

tek Gatelli (nga 0.5 deri në 1 ha). Midis grupit të Tërnovës dhe të Dhoksit shtrihen liqenet e majës së Lopës, të cilët po shkojnë drejt zhdukjes përfundimtare, si pasojë e dëmtimit të pyjeve dhe cektësisë së tyre.

4. LIQENET E VARGJEVE TË SKËNDERBEUT

Këtu bëhet fjalë për afro 10 liqene në total që po shkojnë drejt zhdukjes së plotë, pozicionuar në shpatet lindore e verilindore të vargut të Skënderbeut, që përfshihen administrativisht në Bashkinë e Matit e të Klosit. Këta liqene ndodhen në grupin e majës së Liqenit (afro 1700 m), një grup tjetër pranë Gurrës së Kuqe, si dhe një minigrup në malin me Gropa ku ndahet qarku Dibër nga ai i Tiranës. Këta liqene janë më të rrezikuarit sot në Shqipëri, për shkak se kanë përmasa të vogla, janë të cekët, një pjesë ndodhen në shkëmbinj gëlqerorë ku ka humbje të ujit në rrugë nëntokësore, prerje pyjesh, shfrytëzim për ujitje etj.

5. LIQENET E KORABIT

Në të gjithë vargun e Korabit (Koritnik-Deshat) ka afro 20 liqene akullnajore, me sipërfaqe të vogël (deri në 0.2 ha). Natyrisht, ata kanë karakter sezonal, pra marrin konture të qarta vetëm kur shkrin bora në fund të pranverës, sikurse ndodh në gropat e Korabit, pranë Portave të Korabit, në rrafshin e Korabit, bjeshkën e Inoskës, bjeshkën e Zonjave etj. Tre liqene janë për tu evidentuar në këtë masiv, liqeni i Gramës, më i madhi në të gjithë Korabin, gropa e të cilit është me origjinë akullnajore, por liqenin vetë e ka krijuar njeriu nëpërmjet argjinaturës gjysmëshekulli më parë, me sipërfaqe maksimale 8 ha, liqeni akullnajor krejtësisht natyror i Zonjës (sipërfaqe maksimale 1.8 ha), i cili ka luhatje të konsiderueshme të nivelit, si dhe liqeni i Zi i Radomirës, 0.4 ha, i rrethuar me pisha dhe me bukuri të veçantë. Liqenet në Korab, duke qenë të karakterit stinor, vlen të vizitohen vetëm në fund të pranverës e në fillim të verës, kur kanë nivelin e tyre maksimal. Kujtojmë që liqenet e vegjël akullnajorë të Korabit janë të varur krejtësisht nga shkrirja e borës.

PËRMBLEDHJE

Siç shihet, qarku i Dibrës ka në gjirin e vet një prej pasurive natyrore më të çmuara, sepse liqenet akullnajore konsiderohen të tillë në çdo vend europian që ka të tillë. Rasti i menaxhimit të suksesshëm të këtij lloji është në Alto Adige në Italinë veriore, ku liqenet menaxhohen me kritere strikte shkencore. Profesor Perikli Qiriazi shprehet se objekte të tilla natyrore bota i ruan si sytë e ballit, atje edhe shkencëtarët marrin leje për t'i vizituar. Sot Shqipëria ka një numër të konsiderueshëm prej tyre dhe duhen menaxhuar me kujdes që të mos zhduken përfundimisht. Prandaj lipset që ata të qëndrojnë larg ndërhyrjes humane. Por mund të shfrytëzohen për turizëm, nga grupe të ndryshme alpinistësh dhe atyre që pëlqejnë ecjet malore (hiking), apo shëtitjet për ajër të shëndetshëm etj. Përmirësimi i infrastrukturës, duke afruar rrugët e shtruara pranë tyre, si dhe ngritjen e bujtinave me dru, pa bërë ndërhyrje të tjera në mjedis, mund të jetë e efektshme për ngritjen e një lloj turizmi mjaft efikas dhe pa e dëmtuar natyrën. Ritheksojmë se liqenet akullnajore janë një pasuri e madhe e vendit dhe e turizmit malor në Shqipëri, e në këtë kuadër, qarku i Dibrës spikat në të gjithë vendin për përqindjen e konsiderueshme të kësaj pasurie, nisur nga dy element themelorë: prania e madhe e vargjeve malore (Korabi, vargu i Lurës, malësia e Martaneshit etj) dhe pozicioni lindor i tij. Duhet që secili nga ne të bëjë më të mirën për ta ruajtur këtë pasuri dhe që të ruhet duhet që njeriu të qëndrojë sa më larg ndërhyrjeve për qëllime shfrytëzimit të ujit e njëherësh të ndalohet rreptësisht prerja e pyjeve. Sa më të shëndetshëm të jenë pyjet aq më të shëndetshëm do të jenë edhe liqenet. Në kushtet kur klima globale po ngrohet, pozita e këtyre ojekteve hidrografike bëhet e vështirë dhe shumë prej tyre janë sot në kushtet e mijetesës.



Ora e tokës

Zhvillohet aktiviteti “Ora blu e Drinit” nga gjimnazi “Fiqiri Dine”

Nga **OSMAN XHILI**

Ndonëse tingëllon disi e çuditshme, që dhe toka paska një orë të vetën, por kjo tani është bërë realitet. 15 vite më parë në Sidnei të Australisë lindi një lëvizje me emrin që përmendëm më sipër. Lindi si nevojë, lindi si domosdoshmëri për të shpëtuar, tokën, natyrën, florën dhe faunën, biodiversitetin, në gjithë kompleksitetin e tij. Dhe pse ka një ditë të tokës, që është 22 prilli, “Ora e tokës” kremtohet të shtunën e fundit të muajit mars të çdo viti.

Shumë shpejt, kjo lëvizje u zgjerua aq shumë, sa dhe vetë nismëtarët e saj nuk do ta kishin besuar. Lëvizja e quajtur “World Wide”, përfshiu vende dhe kontinente, duke u jetësuar në gati 180 shtete.

Natyrisht dhe Shqipëria nuk mund të mos bëhej pjesë e kësaj nisme botërore dhe nismëtari i saj do të ishte Romeo Hanxhari. Më pas, ka një kronologji në vite, se si ajo erdhi dhe në Dibër, për tu bërë e pranishme dhe për të nxitur aktivitete të ndryshme, në nder të saj. Në vitin 2011, një ish nxënëse e gjimnazit të Maqëllarës, fton në Tiranë një grup gjimnazistësh për tu njohur me nismën në fjalë. Një vit më vonë, “Ora e tokës”u festua dhe në Maqëllarë. Ishte viti 2012, kur kremtohej dhe 100 vjetori i pavarësisë. Nxënësit u ndanë në grupe sipas fshatrave, u bë pastrimi i mbeturinave, të hedhura pa kujdes nga banorët, u stimulua lëvizja me biçikleta dhe u programua mbjellje pemësh nga të rinjtë e shkollave. Krahas nxënësve të gjimnazit në këtë nismë të bukur u përfshinë dhe ato të nëntëvjeçares. Simbolikisht u bë dhe fikja e dritave për një orë, shoqëruar kjo me një darkë familjare, ku të kishte sa më shumë produkte bio.

Një vit më vonë, nisma u zgjerua akoma më shumë me një risi “Firmos dhe ti për orën e tokës”. Madje këtij firmimi ju shtua dhe një tjetër firmë, ajo për “Rrugën e Arbërit”. Nismëtari i këtij peticioni, Gëzim Ismaili, mbeti i kënaqur nga angazhimi i gjimnazit duke bërë një vizitë në ambientet e këtij institucioni.

Në gjithë këto aktivitete mbresëlënëse binte në sy një organizatore e talentuar dhe e palodhur, profesorja e fizikës në gjimnazin e Maqellarës, Zamira Gjeleshi. Ajo udhëhiqte me shembullin e saj. Shpesh kapte thesin me plehra për ta dërguar në destinacion, bashkë me nxënësit e saj. I duhej dhe të paguante nga xhepi i saj për të sponsorizuar aktivitetet e shumta. Shpesh i duhej të linte një pjesë të gjumit të natës për të menduar e projektuar, që eventi që do të zhvillohej të nesërmen, të dilte sa më bukur.

Disa vite pune të saj qenë me një destinacion pak më ndryshe, e shkëputur nga nxënësit. Por nëse u shkëput prej tyre për pak kohë, nuk u shkëput nga bashkëpunimi me organizata dhe partnerë të ndryshëm, në rolin e koordinatores së Bashkisë Dibër. Ato vite i shërbyen për njohje dhe eksperienca të reja dhe sërish kthehet tek gjimnazi “Fiqiri Dine”, që aq shumë e donte.

Vitin e kaluar, në javën e fundit të marsit, ajo pati një ide që nxënësit të njiheshin me fermat e kafshëve. Në oborrin e shkollës zbritën lloje të ndryshme kafshësh e shpendësh, të ndara e të sistemuara shumë bukur. Ishte një mesazh se zona dhe Shqipëria po humbisnin disa lloje autoktone kafshësh si delja Rudë, dhia e Bulaçit, dhia e Misirit, fazani e shumë specie të tjera. Ishte ky një mesazh për gjimnazistët, se kudo që të shkonin, sado kohë të kalonte, ata duhej ta donin tokën dhe kafshët, aleatët e njeriut gjatë gjithë jetës.

Çdo vit që vjen e që kalon e shton ndjeshmërinë e nxënësve dhe të komunitetit për lëvizjen “Ora e tokës”. Organizatore Zamira e konceptoi si “Ora blu e Drinit” dhe si e tillë nuk mund të zhvillohej diku tjetër, përveçse në luginën e Drinit. Kjo ide kishte ardhur nga dy të rinj, Drini Xhafa dhe Aurora Zylaj, që sensibilizonin njerëzit dhe komunitetin në Shkodër për mbrojtjen e basenit të liqenit dhe të lumit të Drinit. Bujtina e Pajtim Beçës, në krahun e djathtë të urës së Topojanit, u përzgjodh për të pritur mysafirët. Ishte një grup i madh prej 60 gjimnazistash, por dhe miq të tjerë të ftuar nga zona dhe më gjerë. Prezantonin çifti Karafil dhe Lirije Rexha, të talentuar në prodhimet tradicionale, biznesmeni Baftjar Kurtulla, zonja Teuta Qosja, doktori Rubin Kosiqi, Edi Truka, Pajtim Vraniçi në rolin e guidës turistike, Roland Doda, specialisti i zonave të mbrojtura... Merrnin pjesë dhe grupi i biologut, nxënës të shkollës së Majtarës, me mësuesen e tyre Zana Qoku.

Aktiviteti ishte shumë i larmishëm. Mesazhet për këtë ditë të veçantë jepeshin





nëpërmjet materialeve organike, si kashtë gruri, bimë, lule, dërrasë e zezë dhe të tjera si këto. Roland Doda nëfjalën e tij tregoi se si po përpiqen ADZM, që nënkupton zonat e mbrojtura për të përfshirë sa më shumë nxënës të shkollave në projektet e tyre. Kështu të rinjtë, jo vetëm do të shtojnë njohuritë e tyre rreth natyrës, por do të jenë kontribues të rëndësishëm në ruajtjen e mbrojtjen e saj.



Një tjetër specialist i pyjeve, Durim Kaba, u ndal në disa nisma të marra për mbrojtjen e gjallesave të ujit. Nisma antidinamit është një nga ato më të rëndësishmet. Tregohet se në disa vende si Zvicër dhe Amerikë, të pasionuarit e gjuetisë me grep, kanë të drejtë të marrin me vete vetëm dy tre peshq, të katërtin duhet ta hedhin sërish në lumë apo në det. Po të krahasosh një shembull të tillë me dinamitin e hedhur, kur jo vetëm gjallesat e mjera, por nganjëherë vetë autorët e këtij veprimi janë dëmtuar deri në vdekje, konkluzionet janë mëse të qarta.

Të gjithë lektorët, përfshirë dhe mësuese Zamirën ngrenë alarmin se shumë gjëra e shumë tregues janë përkeqësuar, në lidhje me natyrën, florën dhe faunën. Pemë të tilla, si manat, vidhat e lisat gati po zhduken. Shumë janë dëmtuar dhe llojet e peshqve, si krapi dhe trofta. Ngjalat po shihen rrallë e më rrallë.

Ashtu si Pajtimi, pak kilometra më sipër, Shaban Beça është munduar që të shtojësa më shumë drurët e shkurret rreth bujtinës së tij. Falë këtij meraku e kujdesi janë shtuar ndjeshëm patat e egra, qukapiku dhe pëllumbat e egër. Bile këto të fundit janë bërë më miqësorë e nuk tremben kollaj nga njeriu. Është shtuar dhelpra, kunadhja dhe derri i egër. Ndoshta ka ardhur momenti, që krahas këtyre masave spontane të mendohet ngritja e një rezervati me një apo shumë kafshë të egra, që do të rriste mjaft fluksin e turistëve.

Lugina e Drinit të Zi është një thesar i pashfrytëzuar. Flora dhe fauna shumë interesante, mundësitë për të bërë rafting, kanionet dhe ujvarat që të ftojnë për ti vizituar, toka pjellore për bimë, perime e pemë frutore, janë vetëm disa nga shumë më tepër arsye, që duhet ta vlerësojmë këtë potencial të jashtëzakonshëm. Janë këto arsye për ti thënë një “Jo” të madhe Skavicës e për të gjetur mjaft mënyra të tjera alternative për energjinë.

Aktiviteti nuk kaloi vetëm me ligjërata e me soditje, por u bë një veprimtari konkrete për pastrimin e luginës dhe grykëderdhjen e përrenjve nga plehrat dhe mbeturinat e shumta. Falë një bashkëpunimi me Bridge plast Alb, këto mbetje u dërguan për përpunim dhe riciklim, duke treguar se ku ka vullnet, vizion e dëshirë për të punuar gjërat rregullohen dhe jeta bëhet e bukur. Ndoshta ne nuk mund të ndalim luftën në Ukrahinë e nuk mund të mbrojmë pyjet e botës, ama mundemi të mbrojmë ambientin dhe natyrën rreth nesh.

Profesore Zamira ka shumë projekte në mendjen e saj, të cilat gjithmonë i dërgon në udhën e zgjidhjes dhe të realizimit. Ata kanë aplikuar si gjimnaz i Maqellarës në panairin e shkencave në Tiranë, të iniciuar nga universiteti “Marin Barleti, në një konkurrim ndërkombëtar mes shkollash të mesme. Ata kanë zgjedhur të paraqesin një projekt interesant, pikërisht me “Orën blu të Drinit”, ku gërshetohen biologjia, fizika dhe artet.

Suksese Zamira, suksese ju nxënës, miq ambientalistë, të dashuruar me natyrën. Projektoni e ndërtoni kështu të ardhmen tuaj, më të bukur e më të mirë se realiteti i sotëm!

Në gjithë këto aktivitete mbresëlënëse binte në sy një organizatore e talentuar dhe e palodhur, profesorja e fizikës në gjimnazin e Maqellarës, Zamira Gjeleshi. Ajo udhëhiqte me shembullin e saj. Shpesh kapte thesin me plehra për ta dërguar në destinacion, bashkë me nxënësit e saj. I duhej dhe të paguante nga xhepi i saj për të sponsorizuar aktivitetet e shumta. Shpesh i duhej të linte një pjesë të gjumit të natës për të menduar e projektuar, që eventi që do të zhvillohej të nesërmen të dilte sa më bukur.

opinion

Duke i thënë “JO” Skavicës, ne i bëjmë një shërbim shumë të vyer vendit tonë



Sot është e domosdoshme shfrytëzimi me eficensë i tokës bujqësore. Koha ka risjellë në skenë nevojën e prodhimit të drithërave për prodhimet bazë. Skavica do ta mbytë luginën e Drinit, këtë hambar të Dibrës dhe Shqipërisë në veri të vendit. Nesër me Skavicën ajo nuk do të jetë më. Dhe ndoshta nesër do të kuptojmë ne dhe brezat gabimin që është bërë.

Nga **SELAMI NAZIFI**

Si shumë të tjerë e kam ndjekur me interesim dhe shqetësim problematikën që është ngritur për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Është folur shumë në rrjetet sociale, në media e televizor. Ndjekja e kësaj çështje përmes mediave, sidomos përmes gazetës “Rruga e Arbërit”, më nxiti të shkruaj, për të qenë pjesë e këtij shqetësimi, jo vetëm si dibran, por mendoj se ky shqetësim duhet të bëhet mbarëkombëtar.

Para shumë vitesh kam vizituar Butrintin dhe kalanë e Lezhës dhe kam rastisur të gjej duke punuar ekipe pune me arkeologë, që në duart e tyre mbanin objekte dhe e pastronin me furçë me një përkujdes e përkushtim të veçantë, nën rrezet e diellit përvëlues, kapele kashte në kokë e pantallona të shkurtra. Më bënte shumë përshtypje e largohesha pa u menduar më gjatë. Çfarë durimi?! Ata në profesionin e tyre nuk bënin as më shumë e as më pak, por përpiqeshin të zbulonin të vërtetat historike.

Këto ditë po lexoja librin “Shtyllat e kombit” të Shtjefën Gjeçovit. Në faqen 19 më tërhoqën vëmendjen këto rreshta: “Sa vlerë ka literatura për një komb, aq ka dhe arkeologjia. Arkeologji, sa është punë e lakmueshme e punë e vlefshme, aq më shumë gjendet në rrezik me na shpëtue duarsh. Mjafton një qese e mbushur me objekte të vjetra të zbulueme në tokën tonë prej një të huaji, për me na lanë në errësirë ndonjë pikë të historisë”. Kjo është thënë e shkruar para 100 vitesh nga Gjeçovi, që njihet si etnolog, folklorist, si mësues, historian, arkeolog, shkrimtar e gjuhëtar, luftëtar e atdhetar. Vritet nga plumbat serbe në tetor 1929. “Për me lanë në errësirë ndonjë pikë të historisë...”.

Skavica nuk lë në errësirë një pikë të historisë, por mbyt, sakaton e vret në mënyrë barbare historinë e një krahine. Dhe këtë nuk na e bëjnë të huajt, por e bëjmë ne, me duart tona.

Duhet t’i themi “Jo, Jo dhe Jo Skavicës!”. Nuk zhduket vetëm historia e krahinës së Dibrës, por zhduket një pjesë e mirë e historisë kombëtare. Historia e Skënderbeut nuk i takon vetëm Dibrës, por gjithë kombit dhe më shumë.

Dje dhe sot kemi qenë dhe mbetemi një vend i varfër për të investuar aq sa duhet në lëmin e arkeologjisë, por sot të paktën, nëse s’kemi mundësi të investojmë për të zbuluar të vërtetat historike, mos të investojmë për t’i mbytur e zhdukur ato nën ujërat e Skavicës. Se do të vijë një ditë që do të kërkojnë pasardhësit tanë me polumbarë për të kërkuar të vërtetat historike e visaret që sot i mbulon vetë toka e nesër do t’i mbulojë edhe uji.

Historia e një kombi nuk fillon e mbaron vetëm në 2-3 breza. Do ngopemi me energjetikë, por brezat e ardhshëm do të na mallkojnë për këtë krim që po bëjmë ne e pushteti. Për një anije “Titanik” të mbytur harxhon bota me miliarda dollarë. Po Titaniku ynë Skënderbe, që e mbysim dhe zhdukim të vërteta historike me duart tona?! A ka lidhje ndërtimi i kësaj vepre me “Ballkanin e hapur”? Pas k: tyre pyetjeve q: shtrojn: Abdurahim Ashiku dhe Nazmi Koçi, mund t: shtrojm: pyetjen tjet: r: A jemi në një pikë të errët të historisë?!

Bashkëfshatarët e qytetarët e mi nga Zall-Dardha, Çidhna, Muhurri, Luznia etj., fati dhe rrethanat i kanë vënë në një situatë të ndërlikuar. Çdo njeri e ka një borxh për të shlyer ndaj vendit të tij. Sot para jush shtrohet detyra e madhe patriotike që t’i themi “Jo Skavicës, Po Dibrës”. Skavica do të përmbysë më shumë se 25 fshatra, rreth 30 vende prehistorike, antike e mesjetare, vrasim objekte e visare historike, varret e të parëve, historia, tradita dhe e vërteta. Mendojeni mirë, do t’i bëni ju shërbim Dibrës, Atdheut, familjarëve, duke i thënë “Jo Skavicës”, në respekt të të parëve tuaj. Nëse s’ka respekt për të parët e tu, të familjeve, traditave e kujtimeve tona, mos prit të kenë respekt për ty të tjerët, farefisi apo të huajt. Duke i thënë “Jo Skavicës”, ti i bën një shërbim shumë të vyer vendit tënd, krahinës e atdheut.

Duke lexuar peticionin e hapur për t’i thënë “JO Skavicës’, shkruhej se “dëmi ekonomik në aspektin kombëtar qëndron në plan të dytë, në krahasim me dëmin që shkakton në aspektin gjeopolitik, historik dhe etnokulturor”.

Ai njeri që nuk është i lidhur me vendlindjen e tij, në përgjithësi nuk është i lidhur as me njerëzimin. Ajo firmë e juaja tregon se qëndroni shumë më lart se deputetët, qeveritarët e intelektualët indiferentë, duke dhënë një mësim se qeveria të mendojë më shumë për të ringjallur tek qytetarët rrënjët tona shpirtërore për lirinë, historinë, arkeologjinë, artet.

Edhe nga ana ekonomike nuk besoj se Skavica do t’i përmbushë nevojat tona. Këtij vendi natyra i ka falur mrekullitë natyrore. Vendit tonë s’i kanë munguar pasuritë natyrore, si ato nëntokësore me pasuritë minerale si kromi, bakri, flori etj., dhe ato mbitokësore si deti, lumenjtë, malet e plot pasuri të tjera të rralla. Por ne asnjëherë nuk ngritëm kokë. Ne i kemi shfrytëzuar keq pasuritë tona. Mjaftojnë të sjellim shembullin e shfrytëzimit të minierës së Bulqizës, të ardhurat e së cilës nuk ndikuan në rritjen ekonomike të punëtorëve e të qytetarëve. Kjo për faj të keqqeverisjes.

Sot, në kohët moderne, ka edhe alternativa të tjera të shfrytëzimit dhe prodhimit të energjisë. Ajo e shfrytëzimit të erës dhe diellit po shfrytëzohet shumë pak në vendin tonë, për të mos thënë aspak.

Sot është e domosdoshme shfrytëzimi me eficensë i tokës bujqësore. Koha ka risjellë në skenë nevojën e prodhimit të drithërave për prodhimet bazë. Skavica do ta mbytë luginën e Drinit, këtë hambar të Dibrës dhe Shqipërisë në veri të vendit. Nesër me Skavicën ajo nuk do të jetë më. Dhe ndoshta nesër do të kuptojmë ne dhe brezat gabimin që është bërë.

Ndaj, është koha, para se të merret një vendim i gabuar, të gjykohet ftohtë dhe me arsye. Sepse nuk na takon të gjejmë një zgjidhje afatshkurtër, për brezin tonë; por një zgjidhje afatgjatë në të mirë të brezave që vijnë dhe vendit mbarë.



Bashkoju peticionit të krijuar nga shqiptarët në SHBA,
Kliko në lidhjen më poshtë dhe firmos peticionin online në
www.change.org
tinyurl.com/mrykme42

POPULLI DIBRAN, NË SE DO TË JETË I BASHKUAR, NUK DO TA LEJOJË SKAVICËN


Prof. dr. Eshref Ymeri më erdhi në adresën time elektronike me një mesazh nga Kalifornia. Një mesazh i ngrohtë, një thirrje nga larg, një vikamë për ti thënë JO SKAVICËS dhe PO DIBRËS.

Lexojeni me kujdes thirrjen e tij drejtuar popullit dibran, thirrjen për tu bashkuar si njëherë e një kohë me “Trimin legjendar Elez Isufi”.

Po e përcjell për të treguar se me Dibrën e pro Luginës së Drinit të Zi për të qenë e bukur dhe e begatë siç e ka krijuar natyra dhe siç e ka bërë një popull i shquar për punë dhe mendje, Dibra dhe Dibranët nuk janë vetëm dhe se të bashkuar nuk do ta lejojnë Skavicën.

Faleminderit Profesor Ymeri!

Abdurahim Ashiku
18 mars 2022



* * *

Populli dibran, në qoftë se do të jetë i bashkuar, nuk do ta lejojë Skavicën.

Unë shpresoj shumë te dibranët se ata janë pasardhës të trimit legjendar Elez Isufi, të gjeneralit me shajak, siç e pati quajtur ai anglezi. Sepse Elez Isufi ishte ai, i cili, si askush tjetër në trojet e pushtuara nga ushtria kriminale serbe, Drinin e Zi e pati mbushur me kufoma ushtarësh të vrarë serb, çka Beogradi e kujton me tmerr edhe sot e kësaj dite.

Shëndet dhe mbarësi.
Eshref Ymeri
Kaliforni, 14 mars 2022

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

cyan magenta yelloë black

profil

Luftim Kuka është vlerësuar vazhdimisht për realizimin e revizioneve dhe të detyrave të tij, duke punuar për disa vite edhe pas arritjes së moshës pensionit

Rruga 57-vjeçare e financierit **Luftim Kuka** nga minierat e kromit, në dikasteret qendrore

Nga **BASHKIM LAMI**

Shohim në gazeta e media vlerësime të punës së mësuesve, të mjekëve, inxhinierëve, agronomëve etj., por shumë rrallë shohim të shkruhet për punën me vlera të rëndësishme të ekonomistëve që kanë ushtruar këtë profesion nëpër zyra, pa bërë zhurmë dhe larg syrit të njerëzve. Në këtë shkrim do ju njohim me ***z.Luftim Kuka, njëri prej financierëve që për 50 vjet e ushtron këtë profesion me shumë dashuri, ndershmëri e përkushtim në ndërmarrjet dhe dikasteret më të rëndësishme të ekonomisë së vendit tonë.***

Babaj i tij Jonuz Kuka ka punuar gjithmonë në administratë si përgjegjës i gjendjes civile, sekretar gjykate, ku dallohej për përdorimin e makinës së shkrimit me shpejtësi që askush nuk e bënte. Jonuzi ka punuar më pas disa vite në tregti, ku për arsye shëndetësore ka ndërprerë punën dhe familja ka kaluar një gjendje ekonomike të vështirë në vitet 1959-1967. Babai Jonuz, nëna Sabrie Kuka (motra e Ali e Rexhep Dishës) i rritën fëmijët me vështirësitë e kohës, por gjithmonë me pikësynime të qarta që të bëhen për ti ngjarë kohës. Prindërit ngulmonin që fëmijët të shkollohen dhe ia arritën qëllimit, pasi Luftimin e dërgoj në UT për ekonomist e vajzën Lumturie e dërgoj në shkollën e mesme të mamive në Korçë, që pas mbarimit me sukses të shkollës punoi në Zogje e Shupenzë mbi 10 vjet, ndërsa pas martesës punoj në Tiranë tek spitali civil dhe ai ushtarak si k/infermiere e pavijonit infektiv. Jonuz Kuka vdiq i ri kur fëmijët kishin nevojë për të ndjekur shkollat, pasi Luftimi ishte student në Tiranë dhe të tjerët në shkolla të mesme e 7-vjeçare.

* * *

Luftim Jonuz Kuka ka lindur në Zerqan më 01.09.1943 në një familje me tradita ku dashuria për arsimin e shkollën ishte prioriteti më i rëndësishëm i kësaj familje. Luftimi arsimin fillor e shtatëvjeçar e kreu në vendlindje. Kujton me rrrespekt të gjithë mësuesit e kësaj shkolle për përkushtimin e tyre në punën edukative e mësimore me nxënësit. Në veçanti ai kujton mësuesin e matematikës, Daj Aliun, si dhe mësuesit Gafurr Dervishi, Riza Novaku, Myslim Brata dhe të paharrueshmin Idriz Biba, drejtor i shkollës në atë kohë. Në vitin 1957 e caktuan të vazhdoj shkollën teknike bujqësore në Kavajë dhe në pedagogjike të Peshkopisë që nuk i donte dhe në vitin 1959 e dërgojnë në teknikumin ekonomik "Nako Spiro" në Tiranë, ku vazhdoj rregullisht duke qenë nxënës me rezultate të larta. E mbaron ekonomiken në vitin 1963 në degën financë-kontabilitet. Në shkollën e mesme Luftimi thotë se ka qenë aktivizuar rregullisht në aktivitete artistike si këngëtar i këngëve popullore, por më pas nuk e ka ndjekur këtë prirje, veçse në gëzime familjare apo me shoqërinë e tij.

Pas diplomimit Luftimin e emërojnë në NFP Bulqizë, në sektorin Thekën-Martanesh, me detyrë llogaritar, që ai e donte shumë si profesion. Jeta e tij në gjirin e punëtorëve, duke njohur realisht vështirësitë e burrëruan atë para kohe. Aty mbushi tre vite pune dhe vendos të vazhdoj shkollën e lartë në UT, fakultetin ekonomik, degën financë-kontabilitet, që kishte mësuar edhe në shkollën e mesme. Gjatë viteve të shkollës së lartë ai arriti të jetë në dhjetëshen e studentëve me rezultate më të larta. Natyrisht që ishin të rëndësishme edhe shkolla e mesme edhe tre vite përvojë pune si llogaritar e financier. ***Jeta studentore gjithashtu ishte për Luftimin shumë e rëndësishme duke njohur shokë nga gjithë Shqipëria dhe gjithashtu jetën në kryeqytetin e vendit që i dha mundësinë***



të njohë edhe jetën e qytetit. Edhe kultura në vendlindjen e tij, Zerqan, ishte për të e shtrenjtë dhe e bënte të ndjehej mirë në grupet shoqërore. Me mbarimin e shkollës së lartë në vitin 1970 kryen gjashtë muaj përgatitje ushtarak në Berat, siç ishte programi për mbarimin e plotë të UT.

Luftimi tashmë kuadër me arsim të lartë emërohet k/degës planit në ndërmarrjen e Minierës Kromit "11 heronjtë" në Batër Martanesh. Pas një viti e ngarkojnë me detyrën k/degës organizimit të punës e të pagave në këtë ndërmarrje deri në gusht të vitit 1975. Në këto vite Luftimi kujton me respekt drejtuesit e kolegët ku fitoj një përvojë të rëndësishme të ushtrimit të profesionit si financier-kontabilist duke bërë edhe kërkime e zbatime shkencore të njohurive të fituara gjatë shkollimit, por edhe gjatë punës në këtë ndërmarrje ekonomike të rëndësishme. Drejtues e specialistë të rrethit të Matit e vlerësuan nivelin profesional të Luftimit dhe i afruan disa pozicione në administratën e rrethit, por ai duke qenë shumë i lidhur me ushtrimin e profesionit në ndërmarrjen prodhuese të kromit, nuk i pranojë ato vende pune.

Në gusht të vitit 1975 e kanë transferuar për arësye të forta familjare në Ndërmarrjen e Minierës së Kromit në Bulqizë, në detyrën specialist në degën e financës. Në këtë kohë ai shpreh dëshirën të punojë në Kooperativën Bujqësore në Zerqan ku kishte banimin dhe e caktojnë k/degës së planit të kësaj kooperative. Aty ai u njoh nga afër me ***vështirësitë e mëdha të jetës e të punës në fshatin e lindjes e fshatrat e tjera dhe u befasua nga gjëndja e organizimit të punës me shumë probleme që bënin të vështirë për disa arësye ngritjen e nivelit ekonomik të kooperativës.*** Kontrasti ishte shumë i madh me organizimet në ndërmarrjet e minierës, por edhe rrugët për të dalë nga gjendja e dobët e të ardhurave ishte e vështirë. Personeli i administratës ishte me nivel të lartë shkencor si Hasan Okshtuni, Ilir Puca, Kasem Kaleci, Dalip Tollja, Sali Marku, që në nivelin e tyre profesional ishin shumë të përgatitur, por niveli i drejtimit lente shumë për të dëshiruar dhe ky kontrast bënte që puna e tyre të mos jepte efektin e duhur. Pesha për këtë divergjencë i bie edhe Luftimit që e largojnë nga puna për ta dënuar, por fati deshti dhe ndodhi ndryshe.

Luftimin e rimarrin në punë tek miniera e Bulqizës, ku kishte qene edhe më parë dhe e dinin mirë se sa i përkushtuar është ai për punën. Aty i ngarkojnë detyrën e specialistit në degën e kontrollit financiar, ku Luftimi gjen veten profesionalisht edhe për arsye

Shumë rrallë shohim të shkruhet për punën me vlera të rëndësishme të ekonomistëve që kanë ushtruar profesionin e ekonomistit.
Luftim Kuka, njëri prej financierëve që për 50 vjet e ushtron këtë profesion me shumë dashuri, ndershmëri e përkushtim në ndërmarrjet dhe dikasteret më të rëndësishme të ekonomisë së vendit tonë.

se drejtuesit vizionar, si Martin Cukalla (drejtor) e Bujar Pata (k/inxhinier), Vasil Gruda, Vasil Jovani, Todi Sema, Jorgo Kola, etj., inxhinierë të talentuar, nuk i ndërhynin në realizimin sipas ligjeve të kontrollit financiar të kësaj ndërmarrje, pasi edhe ata e vlerësonin realisht rëndësinë e këtij kontrolli, që lidhej me zbatueshmërinë e ligjeve për investimet dhe studimin e efektivitetit të tyre në bilancin e suksesshëm të ndërmarrjes. Në këtë detyrë Luftimit ju dha mundësia të bëhet pjesë e ekipeve të kontrollit, që organizonte Ministria e Minierave në ndërmarrje të tjera nëpër Shqipëri. Në këto ekipe ai u njoh me përvoja të tjera të specialistëve të aftë që gjendeshin në ato ndërmarrje. Duke kontrolluar dokumentacionin dhe bilancet Luftimi vlerëson se ishte përvojë shumë e rëndësishme profesionale e zbatimeve financiare e të kontabilitetit. ***Përpilimi me vizion studimor i raporteve të kontrollit e bëri Luftimin shumë të njohur në dikasteret e larta të shtetit*** dhe me këtë angazhim ai njohu financier të shquar e përvojat e tyre nëpër Shqipëri, që i shërbyen për ngritjen e tij profesionale.

Në vitin 1980 del nga dikasteret qendrore dhe u bë edhe ligj i veçantë ngritja e "kontrollit të brendshëm financiar" nëpër ndërmarrje dhe në të gjithë dikasteret. Ministria e Financave të Shqipërisë organizon një seminar me financierët më të zgjedhur nëpër institucione e ndërmarrjet më të mëdha dhe Luftimit i ngarkohet të mbajë temën: "Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm financiar në Minierën e Kromit në Bulqizë". Kjo temë u vlerësua shumë nga auditori dhe drejtuesit e lartë, që morën pjesë, të cilët dhanë porosi që përvoja e organizimit e funksionimit të kontrollit të brendshëm financiar të Minierës së Bulqizës të jetë një shembull për të gjitha ndërmarrjet në Shqipëri. Në shtator të vitit 1981 Luftimi emërohet në detyrën "revizor" në drejtorinë e financë - kontrollit të Ministrisë së Industrisë e Minierave të Shqipërisë, ku ka punuar deri në vitin 1991 me përkushtim të vlerësuar në plotësimin e detyrës.

Në vitin 1991 Luftimin e kanë transferuar në Ministrinë e Arsimit në po të njëjtin pozicion si më parë. Luftimi kohën që punoj në Ministrinë e Arsimit kujton me respekt ministrin Ylli Vejsiu, Qamil Talka, drejtor i drejtorisë ekonomike dhe specialistin e mirënjohur Baki Berberi në këtë ministri me të cilët ka punuar ***në kohën e tranzicionit dhe kanë lënë gjurmë profesionale në hartimin e projekt ligjeve mbi trajtimin e studentëve, duke plotësuar kërkesat emergjente të kohës, që janë në fuqi e zbatim edhe sot.***

Në vitin 1992 – 2006 Luftimin e emërojnë si financier me emër të mirë në Degën e Tatimeve në Tiranë, në detyrën "inspektor dhe përgjegjës sektori" ku puna e tij në vazhdimësi ka pasë vlerësimet më të larta për ndershmëri, saktësi e përkushtim në përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Në vitin 1992 ka filluar punë në sistemin fiskal në Drejtorinë e Tatimeve të Tiranës, si inspektor mbi të ardhurat personale. Aty kujton me respekt drejtorin Robert Çeku, që e ka mbështetur për realizimin e reformës fiskale të kohës. Po kështu edhe Florian Mimën me të cilin së bashku hartuan rregulloren e sistemit fiskal mbi mënyrën e organizimit e funksionimit të këtij sistemi, që ka mbetur në përdorim edhe sot. Kujton gjithashtu Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, Kujtim Brovina, që ka qenë drejtues me kohën më të gjatë aty, pasi ishte ***organizator dhe vlerësues real i punës së specialistëve në të gjithë sektorët duke i trajtuar ata jashtë opinioneve partiake***, por vetëm nga niveli i punës që mbulonin, duke ju dhënë edhe shpërblime për realizimin me sukses të detyrave. Drejtori Brovina çdo organizim të ri e bënte duke u konsultuar me specialistët më me përvojë. Në vitet 1992-1995 këtu u punua intensivisht në hartimin e dokumentacionit të tatimeve, si "faturat tatimore" dhe ngritja e sektorit të evazionit fiskal e hartimi i pasqyrave financiare vjetore të cilat janë në përdorim edhe sot, ku specialist si Xhavit Çuni, Niko Lera, Artur Papajani, Fatmir Kazazi, etj. që ishin në nivel të lartë profesional, Luftimi e konsideron shumë me fat që punoi me njerëz të tillë, për realizimin e hartimin e disa ligjeve e dokumentacioneve të rëndësishme për sistemin fiskal, nga mund të mësoje shkencë ekonomike dhe qytetari. ***Luftimi është vlerësuar vazhdimisht për realizimin e revizioneve dhe të detyrave të tij, duke punuar për disa vite edhe pas arritjes së moshës pensionit*** dhe tani vazhdon të ushtroj detyrën e ekonomistit në studion e tij të licensuar nga Ministria e Financave, "Kontabilist i Miratuar", ku u shërben me korrektësi disa kompanive private.

* * *

Jeta familjare e Luftim Kukës gjithashtu ka qenë në vëmendjen e tij. U martua me Lumturie Ali Kaçanin dhe krijuan një familje tradicionale me taban, ku mirërritja e fëmijëve dhe dashuria për të afërmit e shokët ishin vëmendja e tyre në çdo kohë pa harruar detyrat që mbulonin me profesionet e tyre. Bashkëshortja e Luftimit, Lumturia ka mbaruar arsimin e mesëm për mamije në Shkodër me rezultate të shkëlqyera dhe në vitet 1964 – 1981 ka punuar në spitalin e Zerqanit ku mbulonte me kontrollin shëndetësor njëmbëdhjetë fshatra. Pas vitit 1981 familja u vendos në Tiranë dhe Lumturija punoj në spitalin ushtarak deri sa doli në pension. Bashkëshortët Kuka rritën me përkujdesje dy djem, ku barra më e rëndë në familje mbeti tek Lumturia pasi Luftimi e kishte punën me shërbime të gjata në revizionin e ndërmarrjeve të mëdha industriale në Shqipëri. Djali i tyre Edmondin ka mbaruar arsimin e mesëm dhe punon tek ndërmarrja e trajtimit të studentëve nga viti 1992 duke qenë i përkushtuar në përmbushjen e detyrës së tij. Djali tjetër Jonuzi ka mbaruar me rezultate të larta UT në fakultetin ekonomik dhe më pas është vendosur në Kanada, ku edhe atje ka mbaruar specializim për ekspert kontabël dhe e ushtron këtë profesion me sukses. Luftimi me familjen jetojnë në Tiranë dhe janë të kënaqur, që arritën të përmbushin misionin e tyre si qytetarë të denjë, pavarësisht problemeve që sjell shëndeti që edhe ato do të tejkalohen me përkujdesjen që nuk mungon. Familja e Luftimit dhe Lumturies bashkë më djemtë e tyre respektohet e nderohet në rrethin shoqëror të vendlindjes Zerqan e të vendbanimit në Tiranë, si familje shembull në sjellje, komunikim, përkushtim e kontribute të paharruara në shoqëri.

kujtime

Një bisedë e ngrohtë me profesor Bajram Xhafën



Nga **ERVINA TOPTANI**

Libri im i parë "Esad Toptani dhe shqiptarët në vështrimin europian" u botua në korrik 2017. Unë kisha pak muaj që isha kthyer në Shqipëri nga Brukseli. Dalja e librit ishte disi e vonuar pasi prisja që të dilte që një vit më parë, në 2016, megjithatë u gëzova shumë kuptohet.

Por doja të tregoja diçka tjetër në fakt.

Kishte rreth dy javë që libri kishte dalë në librari, fillimisht në Tiranë tek librari "Adrion" e tek "Albania" e në Shkodër në Parrucë besoj. Unë nuk bëra asnjë njoftim për daljen e librit përveç një lajmërimi të vogël me katër rreshta në faqen time të Facebook. Unë nuk isha aspak aktive në rrjete sociale në atë kohë, kam vetëm pak kohë, rreth një vit e ca që kam filluar të ndaj herë pas here shkrimet e mia me miqtë virtualë në faqen time të FB.

Pra, dalja e këtij libri nuk përbënte ndonjë lajm për askënd. Kisha vendosur ta lë të lirë, që të shpjegohem: ky libër nuk kishte nevojë për mua që të lexohej e të tërhiqte vëmendjen e atyre që duan të dinë, sidomos për atë periudhë të njohur pak e keq nga shqiptarët në përgjithësi. Unë kisha pasur kaq shumë nevojë për këtë libër. Gjithçka që disponoja, në dokumente, autorë, mendime, artikuj, emra të mëdhenj gazetarësh, historianësh, politikanësh, studiuesish etj., të fillim shekullit të 20-të e ca të tjerëve shumë më të hershëm, i kisha sjellë të gjithë së bashku në një libër të vetëm, me përkushtimin, dashurinë, asnjanësinë e saktësinë më të madhe që mundesha. Kisha udhëtuar nëpër Europë në shërbim të mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar e kam njohur njerëz të mrekullueshëm me dëshirën për të më ndihmuar, si në Europë, Amerikë, etj. Ky libër ishte më i madh se unë por unë nuk e kisha kuptuar kur e shkruaja atë.

Pas dy javësh nga dalja e tij në librari, diku nga data 26 korrik, një mëngjes të nxehtë, bie telefoni. Numrin nuk e njihja. Zotëria që më telefonoi kishte një zë te butë, të paqtë e foli me një dialekt të ëmbël e të dashur për mua, me atë shkodran. Po e sjell bisedën në ligjeratë të drejtë:

- T'me falni, a flas me zojën Ervina Toptani?

- Po, unë jam. Kush jeni ju lutem?

> "I ke bâ Atdheut nji shërbim mjaft të madh zojë, por sigurisht që nuk mund ta kuptoni tani këtë gjë. Jam i bindur se pas 10 a 15 vitesh do ta kuptoni mirë dhe ju çfarë pune keni bâ duke mos i përkitur direkt fushës për të cilën keni shkruar. Unë jam krenar për ju".

- Mirmjesi zojë, uroj mos t'ju besdis. Unë jam nji zotni prej Shkodret. Bajram Xhafa ma thonë emnin, profesor universiteti në degën e historisë se s'po du me i thanë vedit historian.

- Gëzohem shumë z. Bajram. Jam e lumtur që komunikoj me ju. Unë ju njoh mirë nga librat tuaj e jam e nderuar të bëj këtë bisedë me ju.

- Kam 2 javë që të njoh zojë, domethanë qysh prej se kam lexu librin tuj e po du me ju kërku nji nder. A mund të më dedikoni nji pasdite kohë? Kam shumë nevojë me ju taku e me bisedu për librin. Do të vij unë kasten në Tiranë për ju, s'ka nevojë me ardh ju n'Shkodër.

- Do të jetë kënaqësi takimi me ju profesor. Mund të takohemi që nesër, por vij dhe unë me shumë dëshirë në Shkodër.

- Jo jo, nuk asht nevoja. Unë me thanë të drejtën nuk e dija që ishte botu ky libër por qysh ato ditët e para të daljes së tij, nji mëngjes herët, në ora 7, me bie telefoni e ishte nje miku im që ka shkrue mjaft e asht njohës shumë i mirë i historisë, me emën të madh në Shqipni, që më thotë: "akoma se ke lexu Esadin e zojës Toptani? Shpejt me u veshë e me shku n'Parrucë me e gjet". Kështu të njoha ty nëpërmjet Esadit. E kam studju me shumë seriozitet e dua të di mbi dokumentet e autorët që shpalosen aty.

Të nesërmen pasdite, ne u takuam diku rreth ores 1 të drekës e kafja përfundoi në 8 të mbrëmjes. Çdo faqe e librit ishte shënuar me ngjyrë të kuqe, të zezë e jeshile sipas seksionit të mendimit që i korrespondonte ngjyrës së përdorur. Folëm mjaft, komentuam dokumentet, autorët, emrat e pushtetarëve të kohës që përmenden në libër, historianët, të vërtetat e shtrembëruara, kujtime të vetë profesorit që ka qenë i pari historian besoj që ka kërkuar qysh në vitet e para të post-komunizmit rishikimin e figurës së Esad Toptanit.

Biseda në fund përfundoi me një shprehje që nuk do ta harroj kurrë pasi ishte gjëja më e bukur që dikush i atij kalibri, një njohës i shkëlqyer i fushës së historisë, një zotëri në moshë të madhe krahasuar me mua e një profesor mjaft i nderuar, mund të më thoshte.

"I ke bâ Atdheut nji shërbim mjaft të madh zojë, por sigurisht që nuk mund ta kuptoni tani këtë gjë. Jam i bindur se pas 10 a 15 vitesh do ta kuptoni mirë dhe ju çfarë pune keni bâ duke mos i përkitur direkt fushës për të cilën keni shkruar. Unë jam krenar për ju".

Nuk besoj se jam ndjerë ndonjëherë më krenare, me përulësinë më të madhe, se në atë moment. M'u mbushën sytë me lot nga emocioni. E sa herë gjendem përpara profesorësh e doktorë shkencash, sidomos të huajve që janë të ftohtë e gati-gati të ngurtë, më kumbojnë në vesh si atë mbrëmje fjalët e profesorit shkodran.

Atë pasdite në fakt, mora konfirmimin se ky libër nuk kishte vërtet aspak nevojë për mua, as për promovim, as për artikuj gazetash, as për ftesa në emisione televizive siç ndodh shpesh këto kohë, që të lexohej apo të kërkohej. Ai e kishte gjetur rrugën vetë e do të shkonte aty ku përkiste. Të njëjtën praktikë ndoqa dhe me librin e dytë "Mafia në familjen time".

Këtë shkrim për herë të parë po e shkruaj pas 5 vjetësh nga dalja e këtij libri që unë e dua shumë fort. Ai tashmë nuk gjendet më në librari edhe pse është ribotuar disa herë e kurrë nuk është promovuar nga askush, as nga unë vetë që e kam fort përzemër.

Duke qenë se para pak kohësh lexova një analizë shumë të mirë nga një zotëri i nderuar që e përmendte librin "Esad Toptani dhe shqiptarët në vështrimin europian", vendosa të ndaj këtë moment të këndshëm me ju në kujtim të daljes së këtij libri në librari në korrik 2017 e sigurisht në formë falendërimi e respekti për profesor Bajram Xhafën.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**

Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

TANI MUND TË PAJTOHENI PRANË SPORTELEVE TË POSTËS SHQIPTARE NË TË GJITHË SHQIPËRINË. NJË PAJTIM VJETOR KUSHTON 600 LEKË

Rruga e Arbërit nr. 187

kulturë



"Kush është "dibranët"?

Në Muzeun Historik Kombëtar u shfaq premiera e filmit dokumentar nga Donika Mustafaj, prodhim i RTSH.

"Kush është "dibranët" është filmi i ri dokumentar i Donika Mustafajt, prodhuar nga RTSH. Më parë ajo është bërë e njohur për publikun dhe vlerësuar lart nga kritika për veprat e saj si "Jetë pezull". "Magjia klarinetë", "Ustai i fundit", kushtuar mjeshtrit të madh Laver Bariu, "Një amerikane në Tiranë", "Fëmijëria peng", "Autografi" apo "Marramendja". Në realizimin e kësaj vepre morën pjesë kameramanët Arben Ahmetli dhe Igli Murati, Juxhin Dushku si operator zëri, Gjergji Pano kreu montazhin dhe Ermal Bardhi miksazhin.

Në punët e saj të mëparshme, Donika Mustafaj ka hulumtuar disa herë në çështje të identitetit kombëtar shqiptar, duke u ndalur posaçërisht në trashëgiminë tonë muzikore, parë kjo përmes një instrumenti të mrekullueshëm, siç është klarineta, përdorimi i të cilës shtrihet në pjesën më të madhe të trevave shqiptare, apo edhe përmes krijuesve të shquar të muzikës shqiptare, siç është Zef Çoba apo siç ka qenë i tillë Laver Bariu. Në këtë vazhdë është edhe filmi tjetër i saj "Një amerikane në Tiranë". Por kësaj here autorja ka përdorur si pasqyrë veprën e piktores amerikane Lea Christina, krijuar gjatë një periudhe disa vjeçare në Shqipëri, duke kërkuar të zbulojë aty, si në një laborator, çfarë frymëzimesh i kanë ngjallur identiteti dhe peizazhi shqiptar një artisteje të ardhur nga një mjedis krejt tjetër kulturor, historik e shoqëror, siç mund të jetë një piktore amerikane.

Kërkimet mbi identitetin kombëtar shqiptar, Donika Mustafaj i ka vazhduar edhe në filmat dokumentarë "Jetë pezull", "Fëmijëria peng", "Autografi" apo "Marramendja", kësaj here duke u përqëndruar posaçërisht te transformimet që ka pësuar ky identitet gjatë dekadave të fundit me ardhjen e demokracisë dhe hapjen e vendit tonë ndaj zhvillimeve të natyrshme të një shoqërie të lirë. Autorja shqyrton ndikimin që kanë në sjelljen shoqërore të individit shqiptar shthurja e të drejtës zakonore, Kanuni ("Jetë pezull"), apo treguesit e mirëqenies, siç është paraja bashkë me simbolet e kësaj mirëqenieje, siç është vetura. Në këto vepra, autorja hedh një vështrim sociologjik mbi identitetin dhe ngre disa shqetësime të mprehta.

Ndërsa në veprën më të fundit, Kush është "dibranët"?, Donika Mustafaj përqendrohet tek një nga bashkësitë krahinore më të spikatura të Shqipërisë, dibranët, të cilin ajo nuk e ka zgjedhur rastësisht. Ajo vetë është dibrane. Autorja nuk e fsheh që nxitjen e pare për këtë vepër e ka marrë nga "borxhi" që ndjente ndaj vendlinjes së vet. Pra, është një vepër e konceptuar në zanafillë si një himn për virtutet e dibranëve. Por himn në gjuhën artistike të Donika Mustafajt nuk do të thotë zbukurim dhe as rënie në folklorizëm. Ajo ka qëmtuar me seriozitet dhe realizëm në trashëgiminë e pasur kulturore dhe zakonore të kësaj krahine, e cila ndahet përgjysmë nga kufiri shtetëror midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke nxjerrë në pah kryesisht ato virtute me vlerë të dyfishtë: edhe si përbashkuese të dallueshme midis dibranëve, edhe si arterie lidhëse jetike me identitetin kombëtar të shqiptarit. Nëpërmjet një paradoksi gjuhësor të theksuar qysh në titull, autorja synon të tërheqë vëmendjen te fakti se "dibranët" nuk janë një grumbull njerëzor me një fyryrë të përbashkët, por janë secili veç e veç individualitete me personalitet të qartë.

> Në mënyrë të përmbledhur do thënë se Donika Mustafaj synon nëpërmjet kësaj vepre të kuptojë dhe të shpjegojë për publikun se edhe dibrani i sotëm si shqiptar i mirë duhet t'i përvetësojë me krenari virtutet e të parëve të vet dhe t'i pëcjellë ato te pasardhësit.

Duke u kujdesur për të mos rënë në kultin e të shkuarës, Donika Mustafaj shqyrton rrethanat historike dhe kulturore gjatë të cilave ka ndodhur rrënjosja e këtyre virtuteve në karakterin dhe në mënyrën e jetesës së dibranit. Ajo është e vetëdijshme se këto rrethana nuk gjenden më në realitetet e sotme shoqërore ku jetojnë dibranët. Por kjo nuk e lëkund aspak bindjen e saj se një trashëgimi e tillë përbën një thesar shumë të çmuar dhe të dobishëm për edukimin e brezave të rinj në përballjen e tyre të natyrshme me sfidat e zhvillimit të shoqërisë së konsumit në kontekstin e hapjes dhe të globalizmit. Një trashëgimi e tillë duhet të jetë për brezat e rinj sot siç është rrënja për pemët.

Në mënyrë të përmbledhur do thënë se Donika Mustafaj synon nëpërmjet kësaj vepre të kuptojë dhe të shpjegojë për publikun se edhe dibrani i sotëm si shqiptar i mirë duhet t'i përvetësojë me krenari virtutet e të parëve të vet dhe t'i pëcjellë ato te pasardhësit.

Filmi dokumentar Kush është "dibranët"? përbën një arritje të re në krijimtarinë e Donika Mustafajt dhe shënon rritje të dukshme në pjekurinë e saj si artiste. Premiera e tij u organizua ne sallën UNESCO të Muzet Historik Kombëtar nga Shoqata e Intelektualëve Dibranë.

Donika Mustafaj:

Nga **ENTELA RESULI***

"Kush është "dibranët" është filmi i ri dokumentar i Donika Mustafajt, prodhuar nga RTSH. Më parë ajo është bërë e njohur për publikun dhe vlerësuar lart nga kritika për veprat e saj si "Jetë pezull". "Magjia klarinetë", "Ustai i fundit", kushtuar mjeshtrit të madh Laver Bariu, "Një amerikane në Tiranë", "Fëmijëria peng", "Autografi" apo "Marramendja".

Ndërsa në veprën më të fundit, Kush është "dibranët"?, Donika Mustafaj përqendrohet tek një nga bashkësitë krahinore më të spikatura të Shqipërisë, dibranët, të cilin ajo nuk e ka zgjedhur rastësisht. Ajo vetë është dibrane.

Autorja nuk e fsheh që nxitjen e pare për këtë vepër e ka marrë nga "borxhi" që ndjente ndaj vendlindjes së vet. Pra, është një vepër e konceptuar në zanafillë si një himn për virtytet e dibranëve. Por himn në gjuhën artistike të Donika Mustafajt nuk do të thotë zbukurim dhe as rënie në folklorizëm. Ajo ka qëmtuar me seriozitet dhe realizëm në trashëgiminë e pasur kulturore dhe zakonore të kësaj krahine, e cila ndahet përgjysmë nga kufiri shtetëror midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke nxjerrë në pah kryesisht ato virtyte me vlerë të dyfishtë: edhe si përbashkuese të dallueshme midis dibranëve, edhe si arterie lidhëse jetike me identitetin kombëtar të shqiptarit.

Nëpërmjet një paradikme gjuhësore të theksuar qysh në titull, autorja synon të tërheqë vëmendjen te fakti se "dibranët" nuk janë një grumbull njerëzor me një fytyrë të përbashkët, por janë secili veç e veç individualitete me personalitet të qartë.

Duke u kujdesur për të mos rënë në kultin e të shkuarës, Donika Mustafaj shqyrton rrethanat historike dhe kulturore gjatë të cilave ka ndodhur rrënjosja e këtyre virtyteve në karakterin dhe në mënyrën e jetesës së dibranit. Ajo është e vetëdijshme se këto rrethana nuk gjenden më në realitetet e sotme shoqërore ku jetojnë dibranët. Por kjo nuk e lëkund aspak bindjen e saj se një trashëgimi e tillë përbën një thesar shumë të çmuar dhe të dobishëm për edukimin e brezave të rinj në përballjen e tyre të natyrshme me sfidat e zhvillimit të shoqërisë së konsumit në kontekstin e hapjes dhe të globalizmit. Një trashëgimi e tillë duhet të jetë për brezat e rinj sot siç është rrënja për pemët.

Filmi dokumentar Kush është "dibranët"? përbën një arritje të re në krijimtarinë e Donika Mustafajt dhe shënon rritje të dukshme në pjekurinë e saj si artiste.

-Zonja Donika, si lindi ky film ?

Kam një jetë në Tiranë, në fillim si studente, pastaj si grua, si bashkëshorte, si nënë, me një jetë të larmishme profesionale dhe private. Reagimi më i shpeshtë që kam ndeshur kur kam thënë se jam dibrane, ka qenë: "Ah! Dibrane, po!". Kam shumë kohë që e mbaj në kokë dëshirën artistike për të bërë një vepër, ku të tregoja nga vjen ky perceptim i veçantë nga të tjerët për ne, dibranët. Mesa duket, tani që po i afrohem fundit të karrierës, u "poq" lënda, frymëzimi dhe i hyra punës.

-A e dinë dibranet historinë e tyre?

Mendoj se brezat e rinj, jo vetëm ata dibranë, por në përgjithësi e njohin pamjaftueshëm historinë dhe traditat e vendlindjes së tyre. Historia, pjesë e rëndësishme e të cilës janë traditat, formon identitetin, qytetarinë. Një lënie e tillë pas dore e Historisë, një shpërfillje e tillë e rrënjëve, dëmton rëndë jo vetëm të sotmen, që jetojmë, por sidomos të ardhmen tonë si bashkësi dhe si komb. Ky është mesazhi i filmit tim dokumentar: Kush është "dibranët". Ata, qe ndërtuan nëpër

"Kush është "dibranët"

Nëpërmjet një paradikme gjuhësore të theksuar qysh në titull, autorja synon të tërheqë vëmendjen te fakti se "dibranët" nuk janë një grumbull njerëzor me një fytyrë të përbashkët, por janë secili veç e veç individualitete me personalitet të qartë.
"Për të treguar se është e qëllimtë, unë kam përdorur thonjëzat. Kam dashur kështu të tërheq vëmendjen qysh në titull te një fakt. Ne, dibranëve, na drejtohen gjithmonë në shumës: "Ju, dibranët" a thua se, si bashkësi, ne kemi një fytyrë dhe një karakter të përbashkët me veset dhe virtytet, që përsëriten të shumëfishuara nga njëri te tjetri... Dibranët janë, secili veç e veç, individualitete njerëzore të dallueshme qartë njëri nga tjetri.
Në këtë film kam synuar edhe të tregoj si është krijuar ky stereotip me kalimin e kohës duke shqyrtuar ngjarjet historike dhe manifestimet artistike të njerëzve që banonin në territorin e quajtur Dibër deri në vitin 1990 duke i parë bashkë dhe jo të ndara dy Dibrat për të parë se si ata i kanë ushqyer apo mbështetur këto stereotipe që janë pjesë e identitetit kulturor dibrane.



Stafi i realizimit të dokumentarit gjatë premierës së filmit

cyan magenta yelloë black

Brezat e rinj, jo vetëm ata dibranë, por në përgjithësi e njohin pamjaftueshëm historinë dhe traditat e vendlindjes së tyre. Historia, pjesë e rëndësishme e të cilës janë traditat, formon identitetin, qytetarinë. Një lënie e tillë pas dore e Historisë, një shpërfillje e tillë e rrënjëve, dëmton rëndë jo vetëm të sotmen, që jetojmë, por sidomos të ardhmen tonë si bashkësi dhe si komb

Ju rrëfej dibranët e mi



kohë lë të themi imazhin e dibranit, kishin një mënyrë jetese, e cila po bëhet sot gjithnjë e më e rrallë. Sot po ndodh me shpejtësi njëfarë spastrimi kulturor gati – gati i dhunshëm në kujtesën tonë kolektive. Do të doja që ne si prindër të uleshim me fëmijët tanë tashmë të rritur për të shtruar pyetjen: A do të ishin krenarë të parët tanë për atë që ne kemi bërë me trashëgiminë e tyre? Ose: A duhet që fëmijët tanë t'i brejë sadopak meraku për t'u ndjerë të denjë për paraardhësit e tyre? Në kërkim të përgjigjeve për pyetje të tilla me siguri do e shohim më qartë dhe do e kuptojmë më mirë standardizimin që po pushton mënyrën tonë të jetesës.

-Nisur nga përvoja juaj në këtë rast, a është më lehtë apo me vështirë të bësh një film dokumentar për një vend e komunitet me të cilin ke lidhje të shumëfishta njerëzore, shpirtërore, kulturore?

Më besoni, lehtësia ishte vetëm në dukje, para se të filloja punën. Nëse ishte vërtet e thjeshtë për mua te identifikoja virtytet e dibranëve, nuk ishte aspak e tillë qasja për t'i deshifruar e për t'i rindërtuar ato me gjuhën e filmit dokumentar, ku duhej të tregoja në mënyrë bindëse për një publik jo dibran si u rrënjosën këto virtute në mendësinë dhe në mënyrën e jetesës së përditshme të këtyre njerëzve gjatë rrjedhës së kohës historike. Meraku im fillimisht si skenariste e pastaj si regjisore ishte për të thënë disa të vërteta pa zbukurime folklorike. Po ju sjell vetëm një shembull: pastërtia. Ajo është rezultat i një rrjeti detyrimesh, zbatimi i të cilave ka një çmim, e ku më kryesoret janë disiplina dhe bindja. Nuk po përmend dobinë e pastertisë për shëndetin. Atë e di gjithkush. Por, si praktikë, ashtu siç na është edukuar ne nga nënat qysh në vegjëli, historia e saj lidhet drejtpërdrejt sa me nocione racionale aq edhe me automatizma padyshim kufizues: jemi mësuar me një prag të lartë kërkesash, nën të cilat nuk ndihemi rehat. Zbërthimi i një vlere në dukje kaq shtëpiake dhe të pafajshme, e megjithatë kaq zbuluese, ishte i vështirë dhe delikat.

-Ju e paraqisni sikur kjo është një kriter kryesor vlerësimi…

Është një vlerë pozitive, legjitimiteti i të cilës vështirë të vihet në dyshim. Dibranët besojnë fort në pastërtinë, është një bast i sigurt. Ndikimi i saj vihet re në sjelljen tonë, në mënyrën e rregullimit të hapësirës, në vlerësimin që kemi për të tjerët, në ndjenjën e mirëqenies ose të parehatisë.

-A ka diçka që nuk shkon në titullin e filmit tuaj?

Kush është "dibranët"? përmban një mospërputhje morfologjike, keni të drejtë. Për të treguar se është e qëllimtë, unë kam përdorur thonjëzat. Kam dashur kështu të tërheq vëmendjen qysh në titull te një fakt. Ne, dibranëve, na drejtohen gjithmonë në shumës: "Ju, dibranët" a thua se, si bashkësi, ne kemi një fytyrë dhe një karakter të përbashkët me veset dhe virtytet, që përsëriten të shumëfishuara nga njëri te tjetri. `Ky është një stereotip pa ngarkesa negative. Por stereotip mbetet gjithsesi. Kurrë s'më ka ndodhur që dikush të më drejtohet në numrin njëjës: "Ti, dibrania". Ndërsa e vërteta, në realitet, paraqitet krejt ndryshe. Dibranët janë, secili veç e veç, individualitete njerëzore të dallueshme qartë njëri nga tjetri. Në këtë film kam synuar edhe të tregoj si është krijuar ky stereotip me kalimin e kohës duke shqyrtuar ngjarjet historike dhe manifestimet artistike të njerëzve që banonin në territorin e quajtur Dibër deri në vitin 1990 duke i parë bashkë dhe jo të ndara dy Dibrat për të parë se si ata i kanë ushqyer apo mbështetur këto stereotipe që janë pjesë e identitetit kulturor dibrane.

-A ka një kufi midis së vërtetës dhe stereotipit?

Ka gjithmonë një bërthamë të së vërtetës. Por duke e bërë këtë lloj vëzhgimi një parametër identiteti, riprodhohen stereotipet. Është e gabuar të thuhet se dibranet në përgjithësi ndajnë të njëjtin koncept për pastërtin, nderin, besën e shumë të tjera pa dashur të bëj një listë të gjatë. Disa karakteristika transmetohen midis brezave, por ato duhet të riinterpretohen vazhdimisht.

-Të jesh dibran, çfarë do të thotë sot?

Është gjithmonë më e lehtë të shohësh qartë të kaluarën sesa të ardhmen. Sot dibranët nuk janë më si dikur, të bashkuar pse flasin të njëjtin dialekt dhe banojnë në të njëjtin territor, ndajnë bashkë gëzimet dhe hidhërimet e që rrjedhimisht e njohin njëri – tjetrin me rrënjë e me degë, dinë për njëri – tjetrin edhe sa lugë e pirunj ka në shtëpi. Ata janë sot të shpërndarë anembanë botës, janë gjithnjë e më të përzier me martesa jo vetëm me shqiptarë të viseve të tjera, por edhe më të huaj. Pra, kemi njëfarë shumëfishimi të "hapësirës dibrane". Unë vërej me kënaqësi se kudo ende bien në sy si punëtorë të mëdhenj dhe njerëz që i kushtojnë vëmendje të veçantë pastërtisë dhe rregullit dhe sidomos njerëz që i merr malli për njeri tjetrin dhe kërkojnë mundësi për t'u takuar e për të ndarë sëbashku të paktën shijen për artin. Jo rastësisht ka shoqata të dibranëve që nga Tirana e deri në New York.

-Në vitin 2022 a është e vjetruar ideja e një identiteti dibrane? A po shkohet drejt një identiteti më të pasaktë?

Për t'iu përgjigjur pyetjes suaj duhet të identifikojmë faktorët që kanë influencuar me shumë mbi Dibrën dhe dibranet pas viteve '90. Emigrimi, migrimi, influencat e kulturave të ndryshme etj. Megjithate do të ishte e vështirë të parashikohen me saktësi efektet e këtyre faktorëve afatgjatë në përkufizimin e asaj se çfarë është sot te jesh dibranë. Sot dibranet duan të ruajnë përkufizimin e identitetit të së kaluarës. Ata kanë nevojë për një ndjenjë përkatësie ndaj një entiteti kulturor të mirëpërcaktuar. Kjo besoj ka ccuar në përjetesimin e namit të mirë.

-A shërben mësimi për kulturën e Dibrës dhe dibraneve për të përjetësuar stereotipet apo çon në mirëkuptim dhe tolerancë?

Do të kisha thënë të dyja. Takimet dhe veprimtaritë e përbashkëta kulturore, komunitariste, dashje pa dashje ushqejnë në sytë e të tjerëve stereotipet. Por unë, të them të drejtën, në gjithë këto vite jete jashtë Dibrës, në marrëdhënie familjare, shoqërore dhe profesionale me "jo dibranë", kam vënë re me kënaqësi se ka shumë pak stereotipe negative për ne dibranët. Nga ana tjetër, këto veprimtari të përbashkëta i shërbejnë gjallërisht ushqimit të mirëkuptimit dhe tolerancës, cilësi këto që janë në substancën e kulturës jetësore të dibranit. "Oda dibrane" ishte një tempull i respektit dhe tolerancës për tjetrin.



Në Odën dibrane. Fragment nga filmi.

> Dibranët janë sot të shpërndarë anembanë botës, janë gjithnjë e më të përzier me martesa jo vetëm me shqiptarë të viseve të tjera, por edhe më të huaj. Pra, kemi njëfarë shumëfishimi të "hapësirës dibrane". Unë vërej me kënaqësi se kudo ende bien në sy si punëtorë të mëdhenj dhe njerëz që i kushtojnë vëmendje të veçantë pastërtisë dhe rregullit dhe sidomos njerëz që i merr malli për njeri tjetrin dhe kërkojnë mundësi për t'u takuar e për të ndarë sëbashku të paktën shijen për artin. Jo rastësisht ka shoqata të dibranëve që nga Tirana e deri në New York.

-Sikur babai juaj te ishte gjalle, çfarë do të dëshironit t'ju thoshte pasi ta shihte filmin?

Babai im i ndjerë ishte një burrë shumë kërkues, ishte një perfeksionist në mënyrën e tij. Unë i kam pritur gjithnjë duke mbajtur frymën vlerësimet e tij për punët e mia. Ai ishte njësoj serioz si atëherë kur donte të sigurohej se i lava duart me sapun para së të ulesha në tryezë për të ngrënë edhe shihte dëftesën e notave të shkollës. Dëshira ime e parë në këtë rast do të ishte ta shihja me fytyrë të qeshur kur të ndizeshin dritat e sallës. Kështu do të mund t'i afrohesha duke e parë drejt në sy me shpresën se do të më thoshte se po, i kisha kuptuar dibranët.

-Ju jeni autore e afro njëzet filmave dokumentarë. Nëse do të detyroheshit të zgjidhnit vetëm njërin për t'ua lënë trashëgim brezave të ardhshëm, a do të ishte ky për Dibrën?

E kam sinqerisht të vështirë përgjigjen për një pyetje të tillë. Si çdo autor, edhe unë kam një lidhje të veçantë me secilën nga veprat e mia. Por, nisur nga fakti se këtu flas për njerëzit e mi, pra i laj një borxh vendlindjes, trashëgimisë time, do të thosha se këtë vepër e kam bërë jo vetëm me mendje, por edhe me zemër. Rrjedhimisht do të thosha se po, ky është filmi që po u lë brezave të ardhshëm. Duke e zgjeruar pak arsyetimin për të dalë përtej qasjes sentimentale, pra për t'i shkuar te mesazhi, unë këtu shtroj problemin e rëndësisë që ka tradita për të ushqyer krenarinë identitare, domethënë krenarinë kombëtare. Një ndjenjë të tillë e shoh si jetike për t'u përballur me sfidat e mëdha të progresit teknologjik dhe të zhvillimit globalist. Mbetem e bindur se tradita si këto, që kam pasqyruar unë këtu nuk janë për t'u mbyllur në muze. Pra, ato janë një ushqim i shëndetshëm për mënyrën e jetesës së njeriut shqiptar të sotëm dhe të nesërm. Ato çojnë tek modelet pozitive, për të cilat ka nevojë jetike edhe njeriu modern, pavarësisht se shumë punë ai i kryen dhe do t'i kryej nëpërmjet arritjeve të inteligjencës artificiale. Tradita dibrane është shenjtërim i moralit.

Marrë nga gazeta "Dita"

cyan magenta yelloë black

Greva është një fshat model i urtësisë dhe mençurisë së përcjellë në mexheliset e odave të Grevës, i filozofisë së të drejtës, e cila nuk e ka humbur kurrë orientimin, edhe në kohët më të vështira, kur e drejta dukej se nuk ekzistonte dhe shpërfytyrimi e degradimi qenë ngritur në sistem.

Greva, siç nuk e kemi njohur

Nga **SHAQIR SKARRA**

Kam qenë disa herë në Grevë, kam shumë miq e shokë atje. Më ka tërhequr pamja e fshatit, shtrirja e tij rrëzë malit , me tokat e shumta pjellore deri rreth rrugës nacionale. Pastërtia, rrugët e fshatit, shtëpitë pranë njera tjetrës. Vërtet bukuria është e pranishme kudo në Grevë por më shumë është bukuria shpirtërore tek këto njerëz bujar, fisnik,intelektual e të gjithë të dashuruar e lidhur shumë me vendlindjen. Kam mbledhur në Grevë folklor, këngë, legjenda, anekdoda, fjalë të urta, shprehje frazeologjike, duke i dëgjuar direkt nga goja e popullit . Pra, kontaktet e mia me Grevën dhe disa nga banorët e saj, pjesën e shëndoshë intelektuale kanë qenë të vazhdueshme.

E them me bindje të plotë se megjithatë Grevën nuk e kisha njohur. Kisha ditur shumë pak për të si fshat. Ishte pikërisht miku im i mirë, autori i të vetmit libër të botuar për këtë fshat të bukur të Dibrës "Greva e Dibrës" Nehat Daci. Isha me fat unë që librin e lexova i pari. Them e lexova i pari se pata mundësinë ta lexoi që në zanafillë kur autori materialet që sot na i ka dhënë të botuara, atëherë ishin në dorëshkrim, në blloqe shënimesh e fletore të ndryshme, fletë-fletë edhe të zverdhura e të shlyera nga boja por që në fakt falë një shkrimi kaligrafik të mirë lexoheshin qartë.

Vetë autori nga që e kishte për herë të parë, ndjehej në dilemë për të iu futur punës të botonte libër për Grevën.Sot që librin të gjithë e kemi në duar dhe po e lexojmë me dëshirë e endje, bindemi plotësisht në zotësinë e profesionalizmin e autorit se na ka dhënë një libër jo do si do por një vepër shkencore, një enciklopedi jo vetëm për Grevën por edhe jashtë sinorit të saj.


Nehat Daci ka hedhur një gur të madh, një shkëmb në themelet e sapo hapura të ngrehinës së historisë së Grevës dhe falë modestisë së tij që e karakterizon gjithmonë, nuk pretendon se ka bërë gjithçka, por ama , diçka të mirë e mjaft të bukur e ka bërë. Themelet e ngrehinës së historisë së Grevës janë hapur, godina është ngritur. Le të vijnë të tjerë, të shkruajnë përsëri. Ka ende histori, ngjarje, personazhe që duhen trajtuar.

Për ta shkruar e botuar këtë libër monografik për Grevën, vendlindjen e tij të dashur, mendoi se për autorin Nehat Daci nuk ka qenë diçka e lehtë por një punë mjaft e vështirë e pse jo, disa vjeçare.

Në fillim ndoshta as vetë autori siç e përmenda më lart nuk ka qenë i vetëdijshëm se po i futet një pune sa të rëndësishme aq edhe me përgjegjësi morale, sepse temën, përkatësisht lëndën, të cilën ia ka vënë vetes për detyrë që ta përgadis për botim, i është dashur ta vështrojë me kujdes nga segmente shumë dimensionale, punë kjo e cila ka kërkuar shumë njohuri paraprake për të bërë gjurmime fotografike, qoftë duke shfrytëzuar libra të ndryshëm të botuar më parë, qoftë duke bredhur vetë në teren, përmes kontakteve me shumë njerëz të niveleve të ndryshme, përmes bisedave e tregimeve, për të ardhur pastaj në fakte konkrete dhe dëshmi të argumentuara shkencërisht, gjë që nuk i kishim më parë për Grevën.

E themi me bindje se autori do ta kishte më të lehtë të ndalej vetëm në Grevën e ditëve tona, por qëllimi i tij nuk ishte ky pasi duke u ballafaquar me atë literaturë që kishte lexuar vetë, me të dhëna gojore e dëshmi të lëna nga pleqtë e Grevës ia ka arritur qëllimit duke na dhënë sot në duar një vepër të plotë shkencore për Grevën.

Duke lexuar këtë libër nga faqja në faqe kuptojmë më së miri se Grevën nuk e paskemi njohur edhe pse e kemi parë, kemi qenë, kemi pi kafe e kemi ngrënë ndonjë drekë, kemi patur kontakte të shpeshta me miq e shokë nga Greva, përsëri ajo si fshat paska qenë një oaz i madh e i mbuluar. U desh pena e Nehat Dacit që të na jap gjithçka për Grevën që nga antikiteti, nga ngulmimet e para e deri sot në ditët tona. Duke u marrë me lashtësinë, me antikitetin, me ngulmimet e para, me etimologjinë, me toponimet, mendoj se kjo ka qenë pjesa më e vështirë për vetë autorin, jo që nuk kishte lëndën por që këto botoheshin



Greva e Dibrës: histori, etnokulturë, personalitete
774 faqe / Çmimi: 2000 lekë
ISBN 978-9928-353-62-7
Botimet M&B

Ky libër duhet të jetë një libër tavoline për çdo familje grevase, për çdo grevas, kudo që ndodhen, në vendlindjen e tyre tek rrënjët a degët apo në treva të tjera të atdheut, urbane apo rurale qofshin ato, në emigracionin e vjetër apo të ri, në diasporë e gjetkë.

për herë të parë e shumë vetave mund t'ju vinte si çudi.

Duke lexuar librin "Greva e Dibrës" bindemi se vetë autori ka marrë një hap të guximshëm pasi ka dashur të dëshmojë një realitet që ne në fakt nuk e kemi njohur, një histori ndryshe të fshatit Grevë treguar bukur e rrjedhshëm nga një jo profesionist por nga një mësues i cili di fare mirë edhe shkencat ekzakte, edhe historinë e vendlindjes duke përdorur me vyrtuozitet ashtu si formulat kimike edhe penën. Me këtë libër, autori nuk është nisur as të konkurojë, as për të sfiduar ndokënd. Jo, përkundrazi, ai ka lënë hapësira për gjithkënd pasi historia mbetet ende një fushë e virgjër.

Është më se e vërtetë se në këtë libër pena e Nehat Dacit ka ligjëruar e kënduar bukur. Ai ka nxjerrë në pah të gjitha vyrtytet e bukura njerëzore, të folmen, doket, zakonet, etnokulturën, festat, lojrat, veshjen, historinë e gjeografinë e Grevës.

Autori është treguar i kujdeshëm dhe nuk i ka mbetur as një detaj sado i vogël pa trajtuar në faqet e këtij libri voluminoz. Ai me të gjithë thjeshtësinë që e karakterizon, me bujarinë dhe përzemërsinë e tij, me një fjalor mjaft të pasur, me të folmen e vjetër të Grevës që në fakt sot po e humbet shkëlqimin e kohëve të shkuara, na i ka hapur portat që ta njohim më mirë Grevën e Dibrës me ata njerëz dashamirës, bujarë, mikpritës, të besës, të sinqertë,trima e të zgjuar, puntor e liridashës, atdhetarë e të sakrificës.

Çdo rrjesht, fjali, fjalë , paragraf e faqe e këtij libri është shkruar me pasion e skrupulozitet shkencor. Në të gjen histori, gjeografi, filozofi,letërsi,etnografi, folklor dhe një mori dokumentash të pa ndriçuara ma parë dhe të pa trajtuara deri më sot, me përkushtimin e një mësuesi, kimisti, biologu e pse jo shkencari.

Me mjaft art ka përshkruar relievin e natyrën e bukur të Grevës, lartësitë dhe pjerrësitë, malet e bjeshkët, tokat dhe burimet,florën dhe faunën. Me një gjuhë mjaft të pastër e plot metafora dhe me mjaft ëmbëlsi të fut në botën e emocioneve e cila të ndjek nga rrjeshti në rrjesht, nga faqja në faqe deri në fund të librit.

Dhe nëse diku tjerr histori, nuk e bën aspak për nostalgji e as për të të shuar kureshtjen por për të treguar e mësuar se si e qysh e pse, është falur jeta nga banorët e Grevës pa hezitim kur atdheu ka qenë në rrezik. Për të thënë atë që dihet pak, apo aspak. për të nderuar dëshmorët, ata që dhanë jetën për këtë liri që gëzojmë ne sot.

Nehat Daci me modestinë e tij na thotë se ky libër është jo vetëm një vështrim i shkurtër gjeografik-historik por edhe etno-kulturor e etnografik. Në fakt është një libër i një lloji krejt të veçantë i cili do të shërbejë edhe si model nga shumë njerëz të penës.Autori të fut e të josh nën ylberin e vet. Siç duket është vërtet një libër i rrallë, i shkruar me mjaft kulturë, i cili lartëson dhe hijeshon krejt botën e brendëshme, si ideoartistike ashtu edhe psikologjike. Është një enciklopedi, që të ndriçon,lartëson, edukon e të pasuron mendjen e shpirtin dhe të zbukuron bibliotekën tënde.

Autori mbetet objektiv si në përshkrimin bukur dhe vlerësimin e plotë të figurave të ndryshme historike të Grevës. Ai nuk përpiqet për të na dhënë me ca penelata bardh e zi, por ashtu në fakt siç kanë qenë në jetë. Një analizë të përsosur dhe me mjaft fakte dhe argumenta shkencor, duke u bazuar në burime historike të botuara, autori analizon të gjitha luftrat kundër pushtuesve të huaj, të gjithë pjesmarrësit në këto lufta, të gjithë të rënët, humbjet, djegjet dhe masakrat e pushtuesve të huaj mbi popullsinë e Grevës.

Një hapësirë të madhe në libër zë edhe lufta e madhe nacional-çlirimtare. Mbi të nuk ka hedhur dafina të tepërta e as një grimcë balte mbi figurat e ndryshme që kanë luajtur atë rol që u ka caktuar koha.Është ky qëndrim burrëror e prej artisti që e bën këtë libër mjaft të pëlqyer, të lexueshëm dhe autorin të nderuar e respektuar.

Nga Greva kanë dalë figura të njohura në kohë e periudha të ndryshme të cilët kanë lënë gjurmët e tyre edhe në historinë tonë kombëtare.Dhe barra për të treguar këtë të vërtetë, të pa thënë e treguar aq sa duhej i ra njeriut të thjeshtë e të vyrtytshëm, Nehat Dacit. Ai me mjaft finesë, mençuri dhe e zgjuarsi na i paraqet ata ashtu siç kanë qenë në jetë dhe në luftë; burra të fortë, me besë dhe të vetëdijshëm plotësisht që ndoshta do të falnin edhe jetën për të mbrojtur fatet e atdheut. Portretet e tyre i ka gdhendur, pikturuar e përshkruar me dashuri e përkushtrim. Edhe këtë e ka bërë me vetëdije të plotë, se ka në damarët e vet të njëjtin gjak e ideal.

Duke e lexuar me kujdes të plotë këtë libër, bindesh plotësisht se autori ka njohuri shumë, ka kulturë, ka lexuar shumë literaturë të ndryshme për Dibrën dhe më gjërë. Autori na tregon në përgjithësi se e kaluara jonë vërtet ka qenë e lavdishme pasi sot ne jo që duhet të mburremi por edhe kemi se çfarë të tregojmë për të parët tanë, ne duhet ti tregojmë botës sot se në këto troje nuk jemi ardhacakë por jemi vendas prej mijra vjetësh. Fqinjët shumë vite më vonë erdhën, u zgjeruan me tokat tona dhe nga luftrat e gjata e të përgjakëshme na coptuan, na vranë, na gjakosën.

Nëpërmjet këtij libri autori përcjell trashëgiminë tek pasardhësit, duke bërë kështu thirrje për njohjen e vetvetes. Ashtu thjeshtë e mjaft bukur bën lidhjen e së shkuarës me të sotmen, por me sytë nga e ardhmja.Libri ka jetë se fundja është jeta ajo që përcakton nivelin e njerëzimit, stadin e tij. Duke dhënë këtë pasuri të madhe të Grevës, vetë autori jep një mesazh që pasardhësit të mos e harrojnë historinë, traditat, doket, zakonet, se ndëshkimi më i madh që mund të japësh është harresa.

Njohja me historinë tënde, do të thotë ruajtje e kujtesës, e kjo do të thotë të bëhesh pjesë e popujve historik, të cilët nuk harrojnë nëpër cilat rrugë të historisë kanë kaluar të parët tanë,për ta mbajtur gjallë jetën siç nuk harrojnë se pa sakrifica nuk ka vlera.

Në librin e Nehat Dacit ka materiale të bollshme që ndoshta sot do të na duken si një vlerësim i thjeshtë, por jemi të bindur se pas disa vitesh, vlera do të jetë e shumëfishtë. Pasardhësit do ta kenë më të lehtë të vlerësojnë historinë e të parëve pasi mjaft dokumenta janë gati.

Në libër parakalojnë personazhe historikë, të njohur por të treguar në mënyrë mjaft të bukur, me një gjuhë të thjeshtë e mjaft origjinale. Në udhën drejt përshkrimit të veprimtarisë historike të Grevës, në mënyrë inteligjente dhe tepër fine kalojnë mjaft ngjarje, ndodhi të rëndësishme e ndonjë edhe pak të rëndësishme dhe pse jo edhe të panevojshme. Me mjaft interes për lexuesin, pse jo, edhe për studiuesin, janë jo vetëm ngjarjet e kronikat historike por dhe ritet, doket, zakonet e njerëzve të thjeshtë. Pra të gjitha këto i gjen në monografinë e shkruar nga Nehat Daci për Grevën dhe banorët e saj.

Duke lexuar këtë libër rrjesht pas rrjeshti, pasazh pas pasazhi e kapitull pas kapitulli, bindesh plotësisht se autori ka bërë një punë vërtet serioze, me pasion e përkushtim, për të na përcjellë historinë e një fshati, vendlindjes tonë të dashur, të cilit i ka mjaftuar vetvetja për të mbijetuar dhe përcjellë mesazhe nëpër kohë, gjer në ditët tona.

Greva nuk është një fshat i zakonshëm e për rrjedhojë dhe ky libër për të, shkruar me aq ngrohtësi e dashuri nga autori Nehat Daci, nuk është një libër i zakonshëm. Greva është një fshat model i urtësisë dhe mençurisë së përcjellë në mexheliset e odave të Grevës, i filozofisë së të drejtës, e cila nuk e ka humbur kurrë orientimin, edhe në kohët më të vështira, kur e drejta dukej se nuk ekzistonte dhe shpërfytyrimi e degradimi qenë ngritur në sistem.

Ky libër përcjell sagëen e fiseve të një fshati që e duan jetën dhe në emër të saj, të vlerave më qenësore të ekzistencës njerëzore, si nderi,dinjiteti, besa, bujaria, kanë sakrifikuar e vazhdojnë të sakrifikojnë, pasi një jetë e vlefshme dhe kuptimplote për të jetuar nuk mund të ketë kuptim pa këto kode të forta të ekzistencës njerëzore.Në shpalimin e gjithçkaje shpirtërore, që nga kultura e mikpritjes, gjer tek ushtrimi i riteve, zakoneve e traditave të ardhura brez pas brezi, Greva është krejt e veçantë dhe shpreh mendësinë e një fshati që di të respektojë vlerat, di të ndërtojë jetën dhe të shijojë mirësitë e natyrës dhe universit.

Autori depërton në shtresimet e mendësive dhe psikologjisë grevase, që kanë vënë në veprim mekanizmin e jetës në këtë fshat të madh, me një etje të pashuar për dinjitet njerëzor. Në këtë këndvështrim, kuptimshmëria e rrëfimeve të Nehat Dacit, në këtë libër janë të ngrohta, të vizatuara lehtë dhe të spërkatura me nuanca të imta nostalgjike e malli, ç'ka është më se e natyrshme që niset në një "aventurë" shkrimore drejt rrënjëve të vendlindjes, të cilat janë rrënjët e tij dhe të të gjithë ne të tjerëve, që në fakt jemi pjesë e tyre, pjesë e një sage krenarie dhe dashurie njerëzore.

Autori duhet përgëzuar për punën e madhe që ka bërë me shumë përkushtim e përgjegjësi në qëmtimin dhe përcjelljen efakteve dhe detajeve jetësore e historike, me një gjuhë të thjeshtë e të kapshme për të gjitha moshat.

Ky libër duhet të jetë një libër tavoline për çdo familje grevase, për çdo grevas, kudo që ndodhen, në vendlindjen e tyre tek rrënjët a degët apo në treva të tjera të atdheut, urbane apo rurale qofshin ato, në emigracionin e vjetër apo të ri, në diasporë e gjetkë. Por ia vlen ta kenë si libër shtëpie të gjithë ata që duan të njohin më në gjerësi e më në thellësi historinë e trojeve tona, nëpërmjet dyerve, fiseve e fshatrave më në zë, histori e përgjithshme kjo, ku rri me aq natyrshmëri e dinjitet historia e veçantë e Grevës, përcjellë nga autori Nehat Daci.

botime

"Pasqyra e thyer" nga Xhafer Martini

Janë disa njerëz me të cilët nuk ke kontakte të vazhdueshme, nuk i merr dhe nuk të marrin në telefon çdo ditë, nuk i thërret për kafe dhe për evenimente të tjera jetësore, nuk i ke, pra, në rrethin e ngushtë e as të gjerë familjar, miqësor e shoqëror, por, ama, sa takohesh, të duket se je ndarë dje me ta dhe gjithë biseda, përveç përmbajtjes, ka brenda mallin dhe dashurinë. Kjo ndodh për faktin se ti je takuar me ta në pika kulmore të jetës tënde ose "të kanë dalë në shteg" atëherë kur nuk e prisje dhe ti kishe nevojë për dorën e ngrohtë të një njeriu dhe ata ta kanë dhënë këtë dorë me sinqeritet dhe dashuri. Këta njerëz mund t'i takosh fort rrallë në jetë, ose takimi i parë ka qenë edhe i fundit, por harresa nuk vepron mbi ta, siç nuk vepron lima mbi një gur diamanti. Dashuria dhe mirënjohja për ta është si zjarri i dushkut, që mbulohet me hi, por nuk shuhet. Këta njerëz, për të cilët do të shkruaj këtu poshtë, të tillë janë. Ata kanë hyrë shumë tangent në jetën time, por nuk kanë dalë më prej saj. Ata mund të mos mendojnë kështu për mua, sepse, kur jemi takuar, kanë qenë në pozita superiore, janë ata që më kanë ndihmuar mua dhe jo e kundërta. Këta e kanë konsideruar tjetrin si të barabartë çdo shoqëri, edhe në shoqërinë më të keqe, në regjimin më despotik, ka forca të gjalla dhe përparimtare që, po të lidhen, dhe të bashkohen me njëra-tjetrën, krijojnë modelin e ri të jetës dhe u japin një bukuri të re marrëdhënieve njerëzore. Këta burra, siç kanë vepruar me mua, me siguri kështu kanë vepruar edhe me të tjerë si unë. Kështu duhet kuptuar se hapësira e së mirës vjen duke u zgjeruar, kurse hapësira e së keqes vjen duke u ngushtuar. Sikur secili prej nesh të jetë i pajisur me këtë prirje- të bëjë mirë ku të mundet dhe sa të mundet,- e mira do ta kishte mundur të keqen.

Ky libër është mirë të lexohet duke filluar nga figura e parë e deri tek e fundit, ashtu siç janë renditur ato. Edhe pse janë figura krejt të pavarura nga njëra-tjetra, i lidh zinxhiri i ngjarjeve, i cili pa dyshim që ka kronologjinë e vet. Një ngjarje, episod, veprim që del te një figurë, jam përpjekur që të mos e përsëris te figurat e tjera, veç në rastet kur kam pasur nevojë për thellim dhe zgjerim të mëtejshëm. Del, pra, që secila nga këto figura, meqë kanë të bëjnë me jetën time, kanë edhe "koherencën" e vet në shtjellimin tërësor të ngjarjeve. Mjaft prej tyre i kam takuar para se të shkoja në shkollë të lartë, të tjerë i kam takuar ose kam pasur të bëj në periudhën e shkollës së lartë, kurse pjesën më të madhe, gjatë gjithë kohës që kam qenë në punë. Ka prej tyre që i kam takuar në dy ose më shumë periudha kohore, por në këtë libër kam mbajtur në fokus takimin më me ndikim në jetën time.

Të gjitha episodet dhe ngjarjet, me ndonjë përjashtim të rrallë, janë të periudhës së sistemit totalitar. Këto ngjarje kanë të bëjnë me jetën time, por nuk janë e gjithë jeta ime. Thënë me figurë, ky libër ngjan me një pasqyrë të thyer, që, kur e vë para syve, nuk ta jep tërë fytyrën me saktësi dhe hollësi, por vetëm disa pjesë të saj, aty ku copëza e thyer nga e tëra ka qenë më e madhe dhe më e pagërvishtur. Në një kuptim, por më figurativ dhe më të përgjithshëm, ky libër dëshmon që jetët e njerëzve u ngjajnë pasqyrave që pak prej tyre kanë mbetur të pathyera.

Dallimi qëndron në faktin se disa janë thyer shumë dhe janë shndërruar në grimca, kurse disa më pak janë shndërruar në copëza.

(Marrë nga hyrja e librit)




"Pasqyra e thyer" nga Xhafer Martini / Botimet M&B
ISBN:978-9928-353-57-3 /Çmimi: 700 lekë


Libra të tjerë nga Botimet M&B të autorit Xhafer Martini














TREGIME ALEGORIKE

ÇSHENJTËRIMI

Në një katund njerëzit shkonin dhe faleshin tek një trung lisi. Nuk i binte kujt ndërmend për të ndërtuar xhami se puna, sipas tyre, bëhej njësoj. Vetëm një burri kjo gjë nuk i dukej për së mbari. Të falesh pranë një druri, sipas tij, do të thoshte se i besoje atij druri dhe drurëve të tjerë, shkurt, i besoje çdo sendi të natyrës, çka ishte një mëkat i madh. Ky burri duroi sa duroi e një ditë mori sopatën dhe u nis për ta prerë lisin. Në udhë i doli Qoftëlargu, i figuruar si njeri, pikërisht ai që i shtynte njerëzit të faleshin tek një dru, me qëllim që t'i hidhte në prehërin e mëkatit.

– Ku po shkon me këtë sopatë? – e pyeti Qoftëlargu burrin.

– Do të pres lisin ku falen njerëzit.

– Lisin nuk ke për ta prerë, – i tha Qoftëlargu me vendosmëri dhe i zuri rrugën.

– Ec dhe më mbaj, – i tha burri i gatshëm për t'u përleshur për të përmbushur misionin e vet.

U kacafytën mu në rrugë. Burri që donte të priste lisin, ndjeu një fuqi të madhe në veten e tij që nuk e kishte provuar kurrë. Megjithëse Qoftëlargu ishte shumë i fortë, burri u bë dhjetë herë më i fortë dhe i dukej sikur po matej me një fëmijë pesë vjeç. E zdruqi mirë Qoftëlargun, i cili nuk pati ç'të bënte dhe u largua. Burri që doli fitimtar, kapi sopatën dhe filloi të presë lisin. Po trungu qe i trashë dhe nuk mund të pritej për një ditë, aq me tepër që ai humbi shumë kohë duke u mundur me Qoftëlargun. E la ta vazhdonte punën të nesermen. Ditën tjetër u ngrit më heret e shkoi tek lisi. Qoftëlargu i kishte zënë prapë rrugën. I tha:

– Lisin nuk ke për ta prerë!

– Largohu se ta bëj më keq se dje. Të më kishte ndodhur mua si të ndodhi ty, nuk dilja më këtu. Po ti qenke i pafytyrë.

– Sot nuk kam dalë për t'u mundur me ty, por për t'u marrë vesh, – i tha me të butë Qoftëlargu, duke krijuar përshtypjen që ishte i arsyeshëm.

– Për çfarë do të merremi vesh? – e pyeti burri.

– Do të të japë çdo ditë tri lira veç mos ta presësh lisin. Mendoje vetë ç'propozim është ky!

Burri vërtet u mendua. "Kjo punë po më del me leverdi të madhe, " – tha ai me vete dhe filloi të arsyetonte ndryshe: "Ta zëmë se e preva lisin, ç'fitova? Asgjë! Do të ruaj nga mëkati ca njerëz që nuk e meritojnë, ata nuk do ma dijnë për nder. Nëse unë i largoj nga ky mëkat, ata bëjnë njëqind të tjerë. Sikur të mos e pres lisin, sot marr tri lira, neser tri të tjera e kështu me radhë. Për pak kohë bëhem i pasur dhe shikoj hallin tim..."

– Po më dhe çdo ditë tri lira, nuk e pres lisin, – i tha burri Qoftëlargut.

Qoftëlargu hapi qesen dhe i dha tri lirat.

– Neser dua tri të tjerat, – tha burri.

– Do të t'i sjell në shtëpi, mos u bej merak, – i tha Qoftëlargu.

Burri vuri sopatën në krah dhe u kthye nga rruga pa e përmbushur misionin që i kishte vënë vetes. Shkoi tek shtëpia dhe neser priti t'i shkonin tri lirat. Nuk i shkuan. Priti pasneser, tjetërpasneser. Nuk i çoi kush lira. U zemërua shumë, por priti edhe dy javë. Askush nuk shkoi me i çue lirat. Mori vendim të pakthyeshëm për ta prerë lisin. Vuri sopatën në krah dhe drejt e tek vendi. Qoftëlargu i doli para, si dy herët e tjera. Burri i tha:

– Ti nuk m'i prure lirat dhe unë do ta pres lisin.

– Pare nuk ke për të marrë dhe lisin nuk ke për ta prerë, – i tha me ton tjetër Qoftëlargu. – Merr rrugën dhe shko në shtëpi, ndryshe t'i thyej hundët.

– Largomu nga udha se ti ma di hujin, – i tha burri që kishte sopatën në dorë.

Qoftëlargu jo vetëm nuk ia liroi udhën, por iu hodh në grykë që t'ia merrte shpirtin me duar. Burri mundi t'i shmangej, por pati përshtypjen që e shtrënguan jo dy duar njeriu, po darë çeliku. Qoftëlargu ishte bërë dhjetë herë më i fortë, apo ai ishte bërë dhjetë herë më i dobët, këtë burri nuk arrinte ta ndante, por e kuptoi se me të nuk ia dilte dot. Puna ishte të shpëtonte gjallë kësaj radhe...Deshi t'ia mbathte, por Qoftëlargu e kapi dhe bjer e bjer, deri sa burri nuk jepte më shenjë jete. Qoftëlargu e la, se nuk donte ta mbyste fare. E ngriti nga toka si thes me patate dhe i tha:

– Këput qafën e mos u duk më këtu.

Burri iku në shtëpi shpirt e trup dërrmuar. "Si ndodhi kështu, – thoshte me vete ai. – Atë ditë ky njeri m'u duk si bashkë leshi, kurse sot nuk luante vendit, ma sa luan mali !"

(Marrë nga libri Kanuni i Dibrës, Botimet M&B, Tiranë 2016)

Rruga e Arbërit nr. 187

histori

Marrë nga libri "HISTORIA E DIBRËS" - Që nga lashtësia deri në mars 1939 i prof. dr. Kristo Frashëri. ISBN: 978-99956-04-82-0, Botimet M&B, Tiranë 2012

KUNDËR NDËRHYRJES JUGOSLLAVE

Nga akademik **KRISTO FRASHËRI**

(vijim)

Për t'i bërë ballë ofensivës së armikut, Komiteti Luftarak i Arrasit vendosi në pikat kyçe të kufirit forcat e veta të komanduara nga Dan Cami në Viçisht, Destan Puca në Çerenec, Dine Dema në Homesh, Dine Hoxha në Bllatë, Dine Maqellara në Maqellarë, Myftar Kaloshi në Skërtec, Isuf Xhelili në Sorokoll (Kala të Dodës), ky i fundit për të mbrojtur shpinën nga ndonjë sulm eventual i armikut nga ana e Lumës. Ofensiva jugosllave filloi pas dy javësh, më 2 shtator 1920, në sektorin e Bllatës dhe Maqellarës. Forcat dibrane i bënë një rezistencë të fortë sulmit të armikut, por nga mungesa e armatimeve dhe nga pamundësia e Dine Hoxhës dhe Dine Demës u tërhoqën nga Kodrat e Qenokut. Gjatë marshimit të tyre ushtritë jugosllave i përsëritën në një masë më të kufizuar barbarizmat e vitit 1913. Masakruan me qindra vetë dhe dogjën një varg fshatrash të zonës së Maqellarës. Edhe këtë radhë shovinistët serbë nuk kursyen asgjë. Mizoritë e shfrenuara të armikut dhe rënia e Qenokut po atë ditë shkaktuan panik në disa nga krerët e lëkundur të Dibrës. Për të shpëtuar popullsinë nga shfarosja prej armikut, Elez Isufi, në krye të mijëra malësorëve rezistoi me armë, derisa të nesërmen banorët e fushës (Topalltisë) kaluan Drinin dhe ishin në rrugë për në Lurën malore, nga ku pastaj vazhduan për në Mat, Qafë Shtamë, Krujë, Tiranë. Të nesërmen, më 3 shtator 1920, në mbrëmje ushtritë jugosllave hynë në Peshkopi, ku për hakmarrje masakruan banorët e pakët që gjetën aty, midis të cilëve Xhem Dacin, vëllanë tjetër të Shaqir Dacit.

Ushtritë jugosllave nuk u ndalën në "vijën strategjike", por e vazhduan marshimin në thellësi të Shqipërisë për ta detyruar qeverinë e Tiranës të kapitullonte përpara kërkesave të Beogradit ose t'ia linte vendin një qeverie tjetër kapitulluese. Për ta rritur më tepër presionin e vet, qeveria jugosllave vuri në veprim mbeturinat e forcave esadiste të strehuara në Jugosllavi, të cilat, të organizuara në banda të parregullta, nën komandën e Taf Kaziut dhe të Osman Memës, marshuan në të njëjtën kohë, në drejtim të Martaneshit dhe Çermenikës për të dalë në Tiranë dhe në Elbasan. Thirrjes që lëshoi qeveria shqiptare për të kundërshtuar me armë intervencionin jugosllav, malësorët dibranë iu përgjigjën duke zënë shtigjet e rrugëve, të cilat vendosën t'i mbronin me çdo kusht. Përpjekja më e përgjakshme u bë në Grykën e Setës (Çidhën), ku ishte strehuar shumica e popullsisë së zonës. Ushtritë jugosllave u gozhduan në vend dhe, pasi pësuan humbje të mëdha, u detyruan të tërhiqeshin në brigjet lindore të Drinit. Me shpartallimin e bandave esadiste në Martanesh nga forcat e tjera shqiptare, qeveritarët e Beogradit i tërhoqën ushtritë e tyre nga tërë fronti dhe i përqendruan brenda "vijës strategjike". Ndërhyrja serbe dështoi, por treva dibrane mbeti përsëri pjesërisht e pushtuar.

Pas dështimit të ndërhyrjes jugosllave qeveria e Tiranës i vazhdoi përpjekjet diplomatike për ta detyruar Beogradin t'i tërhiqte ushtritë e veta nga tokat e pushtuara. Për t'i hequr çdo argument politik apo juridik qëndrimit të forcave jugosllave brenda kufirit shqiptar, qeveria e Tiranës paraqiti më 12 tetor 1920 kërkesën për t'u bërë anëtare në Lidhjen e Kombeve. Më 1920 kur Lidhja e Kombeve sapo ishte formuar, hyrja e Shqipërisë në gjirin e saj ishte një akt formal me rëndësi të veçantë, mbasi nëpërmjet saj ajo sanksiononte statusin e vetë juridik, pavarësinë e saj kombëtare me kufijtë e caktuar më 1913. Si rrjedhim, me pranimin e saj si anëtare e Lidhjes së Kombeve, Jugosllavisë i pritej rruga për të kërkuar ndryshimin e kufijve të Shqipërisë. Për më tepër, ajo detyrohej të tërhiqte menjëherë ushtritë e saj nga territori shqiptar. Përndryshe ajo do të cilësohej si shtet agresor dhe si i tillë, në bazë të nenit 10 të statusit të Lidhjes së Kombeve, ajo do të dënohej me sanksione, të cilat arrinin deri në përjashtimin nga gjiri i saj.

Për të evituar pozitën e vështirë në të cilën do të ndodhej Jugosllavia nga pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, qeveria e Beogradit në bashkëpunim me qeverinë e Athinës u orvatën ta bojkotonin kërkesën e qeverisë së Tiranës. Në fakt, në fillim patën sukses. Komisioni i pestë i Lidhjes së Kombeve, duke shqyrtuar dokumentacionin që paraqiti qeveria shqiptare, u kap pas një elementi shumë të diskutueshëm – pas faktit se gjoja shteti shqiptar i krijuar më 1913 nuk ishte njohur de jure dhe de facto nga fuqitë e tjera. Si rrjedhim, sipas tyre, vendimi i krijimit të shtetit shqiptar më 1913 konsiderohej i shfuqizuar. Kështu që, pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u shty derisa kjo të pajisej me një akt tjetër ndërkombëtar, që të zinte vendin e akteve të shfuqizuara të viteve 1913 dhe 1914.

Me këtë rast rreth argumenteve juridike të pranimit ose jo të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u bënë mjaft debate. Si Jugosllavia, ashtu edhe Greqia dërguan në Gjenevë specialistët e tyre më të kualifikuar, të cilët rreshtuan një varg argumentesh teorike për të provuar se aktet ndërkombëtare vetvetiu shfuqizohen në rast se nënshkruesit e tyre hyjnë në luftë me njëri-tjetrin. Si rrjedhim, aktet e krijimit të shtetit shqiptar të viteve 1913 dhe 1914 të nënshkruara nga gjashtë Fuqitë e Mëdha, gjoja kishin humbur fuqinë e tyre për dy arsye: sepse nënshkruesit e tyre kishin hyrë gjatë Luftës së Parë Botërore në luftë kundër tjetrit dhe se akti i 31 korrikut ishte zhvleftësuar nga Traktati i Londrës, i cili e trajtonte Shqipërinë si objekt copëtimi dhe jo si shtet sovran.

Për të mbrojtur çështjen shqiptare qeveria e Tiranës dërgoi në Gjenevë Fan Nolin, i cili e trajtoi problemin në mënyrë të shkëlqyer nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare. Fan Noli parashtroi tezën se luftërat shfuqizojnë vetëm aktet të cilat trajtojnë çështje që u takojnë fuqive që i kanë nënshkruar ato akte dhe gjatë kohës kur ato fuqi ndodhen në luftë me njëra-tjetrën. Gjithashtu, luftërat shfuqizojnë, sipas tij, ato akte që trajtojnë çështje të kushtëzuara me afate të shkurtëra. Aktet që kanë të bëjnë me krijimin e shteteve – parashtroi Fan Noli – nuk mund të zhvleftësohen, sepse shtetet nuk krijohen me afat të shkurtër dhe nuk duhet të ndjekin fatin e fuqive që kanë nënshkruar krijimin e tyre. Fan Noli hodhi, gjithashtu, poshtë edhe tezën e zhvleftësimit të akteve të krijimit të shtetit shqiptar nga Traktati i Londrës. Lidhur me këtë çështje ai solli tri argumente: se Traktati i Londrës nuk u shpall botërisht, se ai nuk u vu në zbatim dhe se ai u suprimua me akordin e Tiranës të nënshkruar me 2 gusht 1920 nga Italia, e cila hiqte dorë nga përfitimet që i sillte ai traktat. Shtojmë ne edhe një argument të katërt: vetë Traktati i Londrës nuk përmbante vendime, por vetëm premtime të papërcaktuara, të cilat për më tepër mbetën në letër.

Fjala e Fan Nolit la përshtypje të thellë në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve. Krahas saj një përshtypje po aq të thellë la edhe jehona që kishte shkaktuar lufta çlirimtare e Dibrës. Lajmet që vinin nga Beogradi tregonin shqetësimin e madh që kishin pushtuar qarqet qeveritare jugosllave nga ngjarjet e Dibrës dhe mobilizimin e prej tyre të forcave të konsiderueshme ushtarake për të sulmuar truallin e Shqipërisë. Nga ana tjetër, lajmet që vinin nga Tirana paralajmëronin se me patriotizmin që kishte pushtuar popullsinë dibrane ato ishin gati të fillonin përsëri kryengritje çlirimtare në qoftë se forcat ushtarake jugosllave nuk do të tërhiqeshin në kufirin e vitit 1913. Qarqet politike evropiane konsideronin përgjegjëse për këto veprime qeverinë e Beogradit, e cila, duke u kapur pas argumenteve artificiale rreth vlerës së akteve ndërkombëtare të vitit 1913 dhe 1914, ishte gati të hapte një vatër lufte. Për këtë arsye, për habi të qeverisë jugosllave edhe dy përkrahëset më të mëdha të saj, Anglia dhe Franca, hoqën dorë nga rezoluta që ato vetë kishin mbështetur në Komisionin e pestë dhe pranuan më 17 dhjetor 1920 së bashku me anëtarët e tjerë të Asamblesë, hyrjen e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.

Shqipëria u pranua si anëtare e Lidhjes së Kombeve, duke e shtyrë për më tutje caktimin në terren të kufijve me fqinjët e saj. Duke shfrytëzuar shtyrjen e takimit të kufijve, qeveria jugosllave nuk pranoi t'i hiqte ushtritë e veta nga zona e Dibrës. Për më tepër ajo i vazhdoi provokimet e saj duke shpërthyer terror kundër popullsive të nënshtruara dhe duke organizuar inkursione jashtë vijës strategjike.

Në të vërtetë, kufijtë shqiptaro-jugosllavë ishin caktuar që më 1913. Kishin mbetur pezull vetëm disa çështje të parëndësishme nga shkaku i fillimit të Luftës së Parë Botërore. Duke parë se qeveria jugosllave po e shfrytëzonte këtë rrethanë për të mbajtur në tension krejt vendin, qeveria e Tiranës i kërkoi Këshillit të Lidhjes së Kombeve më 29 prill 1921 që kjo të ndërhynte për largimin e trupave të saj nga territori shqiptar. Në diskutimin e kërkesës shqiptare në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, Shqipërinë e përfaqësoi përsëri Fan Noli, i cili e paditi qeverinë jugosllave si agresore duke kërkuar dërgimin në Shqipëri të një Komisioni Ndërkombëtar, i cili të vëzhgonte zbatimin e vendimit që do të merrte Këshilli në lidhje me largimin e ushtrive jugosllave.

Përfaqësuesi jugosllav Jovanoviç u përpoq të mbrohej nga akuza shqiptare, duke e cilësuar praninë e ushtrive serbe në ultësirën dibrane jo si zonë të pushtuar, por si zonë demarkacioni. Veç kësaj, ai kërkoi që çështja e ngritur nga Fan Noli të trajtohej jo nga Asambleja e Lidhjes së Kombeve, e cila, sipas tij, ishte e prirur të mbante anën e Shqipërisë, por nga Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, mbasi vetëm asaj, sipas tij, i takonte e drejta të merrej me një çështje të trajtuar edhe më parë nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës.

Kështu i Lidhjes së Kombeve pranoi kërkesën jugosllave, kurse Fan Noli në shenjë proteste e ngriti çështjen përpara Asamblesë së Lidhjes së Kombeve. Kështu, çështja e kufijve të Shqipërisë u mor në shqyrtim nga dy instanca ndërkombëtare njëkohësisht – nga Asambleja Plenare e Lidhjes së Kombeve dhe nga Konferenca e Ambasadorëve të katër fuqive të mëdha. Për të larguar vëmendjen e Lidhjes së Kombeve nga problemi i kufijve, qeveria e Beogradit deklaroi se tensioni në Shqipëri nuk rridhte nga provokacionet ushtarake jugosllave, por nga luftërat e brendshme që gjoja zhvillonin fiset e ndryshme lokale dhe grupet fetare shqiptare. Për këtë qëllim, ajo e nxiti politikisht dhe e ndihmoi financiarisht kapedanin konservator të Mirditës, Marka Gjonin, të organizonte një kryengritje të armatosur kundër shtetit shqiptar. Rebelimi i tij filloi në fund të qershorit të vitit 1921, por shumica dërrmuese e mirditorëve, me gjithë pakënaqësinë që kishin ndaj qeverisë së Tiranës, nuk e pasuan kapedanin, i cili pas dy javësh u detyrua të arratisej në Jugosllavi. Disfatën më të rëndë ai e pësoi në Shkallën e Gjonit nga Batalioni i Drinit, i formuar me rezervistë dhe vullnetarë dibranë nën komandën e Ali Rizaj. Me pretendimet për ndihmë ushtarake që i dhanë shovinistët serbë, Marka Gjoni, pasi shpalli më 17 korrik 1921 në Prizren "republikën autonome të Mirditës", u kthye përsëri në Shqipëri. Por edhe këtë radhë nuk pati sukses. Në ndihmë të kapedanit mirditor u nisën me të shpejtë nga territori jugosllav në dy drejtime – nga Dibra dhe nga Prizreni – forca mercenare të armatosura. Repartet mercenare që erdhën nga krahu i Dibrës e vendosën shtabin e tyre në Arras, duke i detyruar anëtarët e Komitetit Kombëtar të tërhiqeshin në thellësi. Duke parë epërsinë e forcave armike, Elez Isufi mobilizoi një mijë vullnetarë të tjerë me malësorë nga Reçi, Dardha, Çidhna e Lura, të cilët së bashku me disa qindra ushtarë të Batalionit "Drini", i thyen më 1 gusht 1921 mercenarët te "Gropa e Gëlqeres" dhe i detyruan të ktheheshin në Arras, pasi lanë rreth njëqind vetë të vrarë. Pas ndeshjes së dytë që u zhvillua më 10 gusht, forcat mercenare u detyruan të tërhiqeshin në viset përtej Drinit.

Malësorët nuk i ndoqën më tej, sepse iu drejtuan Mirditës, për të asgjësuar së bashku me repartet qeveritare mbeturinat e bandave të Marka Gjonit. Pas disa ditë ndjekjesh kapedani tradhtar u gjend pisk dhe kërkoi të dorëzohej në "besë" te Elez Isufi. Ndërsa Elezi priste në Lurë dorëzimin e tij, forca të ushtrisë së rregullt jugosllave, të shoqëruara nga bandat renegato-shqiptare dhe nga reparte mercenare bjellogardiste (rusë) u përqendruan gjatë Drinit të Zi. Më 17 shtator komanda jugosllave u dërgoi forcave shqiptare në Dibër një ultimatum me afat 24 orë, me të cilin kërkonte largimin e tyre nga viset malore të Çidhnës, Dardhës dhe Lurës, pra nga rruga që do t'i çonte ato në Mirditë. Komanda shqiptare refuzoi dhe dibranët lëshuan kushtrimin. Të nesërmen, më 18 shtator, ushtritë jugosllave filluan bombardimin. Forcat ushtarake dhe vullnetare shqiptare u tërhoqën në vende strategjike, në malin e Sinës dhe të Xharxhishtit. Më 19 shtator, duke kujtuar se rruga ishte hapur, ushtritë armike marshuan nga ana e Dardhës, por në Soricë u thyen dhe u tërhoqën pasi lanë 15 veta të vrarë. Më 20 shtator provuan të marshonin nga krahu tjetër, nga ana e Sinës, por edhe këtej u detyruan të tërhiqeshin, pasi lanë rreth 30 vetë të vrarë, në pritat që kishin zënë malësorët te Guri i Sukës dhe te Kodra e Pëllumbit. Më 21 shtator sulmi u përsërit nga ana e Sinës. Këtë radhë, kundërsulmi i shqiptarëve qe më i rreptë dhe armiku, i cili u tërhoq përsëri, pati 230 vetë të vrarë.

Pas këtyre disfatave qeveria e Beogradit i ndërpreu sulmet, me shpresë se kriza politike, që ato javë pushtoi Tiranën, do ta detyronte qeverinë shqiptare të pranonte pretendimet jugosllave. Por kur më 19 tetor 1921, në Tiranë erdhi në fuqi qeveria e "Grupit të Shenjtë", e vendosur për të mos bërë asnjë lëshim territorial, Beogradi përgatiti me të shpejtë një ofensivë të rrufeshme për të arritur sa më parë në Mirditë. Këtë radhë komanda jugosllave përqendroi në një front të ngushtë rreth 5400 ushtarë e mercenarë të pajisur me 31 topa dhe me qindra mitraloza të rëndë e të lehtë. Nga pala shqiptare qëndronte Batalioni i Drinit me 400 ushtarë, 700 vullnetarë, 2 topa dhe 4 mitraloza, nën komandën dyfishe të Ali Rizajt dhe Elez Isufit, si dhe një batalion tjetër prej 300 vetash, nën komandën e Nazif Voshtinës, që dërgoi qeveria e Tiranës, i përbërë kryesisht nga bedelë, të cilëve, si të tillë, u mungonte shpirti luftarak. Kur erdhi lajmi i rifillimit të ofensivës armike, gati 2000 malësorë të tjerë rrëmbyen armët dhe u vunë në dispozicion të komandës ushtarake shqiptare.

Ofensiva ushtarake jugosllave filloi në mëngjesin e 26 tetorit 1921, me një bombardim të gjatë kundër pozitave shqiptare, i cili u pasua nga sulmi i gjithanshëm i reparteve të rregullta dhe mercenare. Shqiptarët rezistuan me heroizëm, por krahu i Muhurrit, nga sulmonte tradhtari Taf Kaziu, u detyrua të tërhiqej. Këtë çarje e shfrytëzuan forcat jugosllave, të cilat depërtuan në thellësi të Malësisë, derisa dolën në Dejën e Macukullit, në shpinë të forcave shqiptare. Në sektorët e tjerë, ushtarët dhe vullnetarët dibranë rezistuan gati 40 orë, pastaj u tërhoqën në Lurë. Ditën e tretë, më 28 tetor 1921, në Lanën e Lurës u zhvillua beteja vendimtare. Me një vetëmohim të jashtëzakonshëm, malësorët dibranë, ushtarë dhe civilë, u përleshën me ushtritë jugosllave dhe, në përfundim të një beteje të përgjakshme, e detyruan armikun të tërhiqej në breg të Drinit.

Fitorja e Lanës së Lurës pati pasoja të rëndësishme. Me të u dogj karta e fundit e qeverisë së Beogradit. Fuqitë e Mëdha u bindën përfundimisht për saktësinë e akuzave që qeveria e Tiranës kishte ngritur herë pas here kundër qeverisë së Beogradit. Veprimet aventureske të Jugosllavisë vunë në shqetësim edhe miqtë e saj. Britania e Madhe, e informuar me saktësi mbi çfarë po ndodhte në Dibër, u shqetësua jo aq për fatin e Shqipërisë sesa për atë të Jugosllavisë. Kjo për arsye se Jugosllavia po e çonte vendin e saj në një konflikt me shqiptarët e egërsuar, nga i cili ajo mund të kishte pasoja të rënda. Për të evituar këto pasoja të rënda, të cilat qeveritarët nacionalistë të Beogradit nuk donin t'i merrnin parasysh, kryeministri britanik, Llojd Xhorxh, i drejtoi Lidhjes së Kombeve, më 7 nëntor 1921, një telegram me një ton tepër idhnak e tepër të prerë:

"Përparimi i vazhdueshëm i trupave jugosllave në Shqipëri, – thuhej në telegram – duke qenë nga ato veprime që turbullojnë paqen ndërkombëtare, po e shtyn qeverinë britanike që të tërheqë vëmendjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve mbi këtë ngjarje dhe ju lutet që të merrni menjëherë masa për të thirrur mbledhjen e Këshillit me qëllim që të studiojë situatën dhe të bjerë në ujdi mbi masat që duhen marrë në bazë të artikullit 16 në rast se qeveria jugosllave do të refuzojë ose do ta vonojë zbatimin e detyrimeve që i ngarkon statuti i Lidhjes së Kombeve. Konferenca e Ambasadorëve, – thuhej më tej, – i ka caktuar kufijtë e Shqipërisë. Vendimi i saj do t'u njoftohet shumë shpejt palëve të interesuara. – Llojd Xhorxhi".

Në bazë të nenit 16, Jugosllavia akuzohej kështu si një shtet agresor kundrejt Shqipërisë dhe paralajmërohej se, po të mos i tërhiqte trupat e veta nga treva dibrane, do të përjashtohej nga Lidhja e Kombeve. Në të njëjtën kohë u shpall se po nisej për në Shqipëri një komision ndërkombëtar për të vërtetuar në terren zbatimin e vendimit që mori Këshilli i Lidhjes së Kombeve më 9 nëntor 1921, për largimin e menjëhershëm të ushtrive agresore jugosllave nga Shqipëria. Megjithatë, qeveria e Beogradit i vazhdoi provokacionet për të shkaktuar trazira në Shqipëri, përpara se të vinte në kufi komisioni ndërkombëtar i caktuar për të vëzhguar zbatimin e vendimit të Lidhjes së Kombeve.

Në fakt, këtë radhë, qeveria e Beogradit nuk pati më mundësi t'u bënte bisht akteve ndërkombëtare. Ajo mori menjëherë masa për të tërhequr ushtritë nga trualli shqiptar para se të arrinin në Dibër anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar. Kështu, kur komisioni i përbërë nga një finlandez (J.J. Sederholm), një norvegjez (J. Meinich) dhe një luksenburgaz (Ch. Schaefer), pasi kaloi përmes Lurës arriti në Arras më 11 dhjetor 1921, ushtritë jugosllave ishin larguar përtej kufirit 24 orë më parë. Disa ditë më vonë, ata i raportonin Këshillit të Lidhjes së Kombeve, ndër të tjera:

"Të gjitha fshatrat që ndodhen në fushën e Drinit, kanë vuajtur barbarisht nga serbët; në pjesën më të madhe të këtyre fshatrave, shumica e shtëpive janë rrënuar. Megjithatë, duket se këto rrënime u takojnë okupacioneve serbe të viteve 1913 dhe 1920, por ka mundësi që ndonjëra prej tyre të jetë rrënuar këtë vit".

Vendimi që mori Këshilli i Lidhjes së Kombeve më 9 nëntor 1921 për largimin e menjëhershëm të ushtrive agresore jugosllave nga Shqipëria ishte një fitore e madhe që korri Shqipëria në arenën ndërkombëtare, të cilën popullsia patriote e Dibrës e pagoi duke i dhënë atdheut me qindra dëshmorë. Se ç'vlerë pati kjo fitore shqiptare për palën jugosllave, do t'ia lëmë të na e thotë një studiues serb, Dragutin Nikoliqi, doktor i shkencave në fushën e së drejtës ndërkombëtare, i cili ka shkruar ndër të tjera: "Kudo u formua bindja se Jugosllavia kishte synime agresive ndaj Shqipërisë. Ja përse qeveria jugosllave doli nga kjo grindje jo vetëm e poshtëruar, por njëkohësisht e mundur, sepse kjo qeveri, në këto rrethana nuk mundi të bënte asgjë tjetër veçse të nënshtrohej përpara vendimit të 9 nëntorit 1921, kundër të cilit do të ngrihet gjithë opinioni publik i vendit". ■

profil

Një nga njerëzit më interesantë që njoha në Veri, një njeri që do të dëshiroja të më dilte diku papritur dhe ta ftoja për një kafe.

‘Bacë’ Baftjar Zajmi i Dohoshishtit të Dibrës

Nga **PETRO MEJDI**

NJË IMAZH

Imazhi i tij më ka mbetun i patretun në kujtesën time, a thua se jam ndarë dje prej tij dhe jo para 41 vjetësh. Ai ishte një njeri kompleks, një karakter i veçantë, në të ndërthureshin konservatorizmi, patriarkalizmi, mençuria, pasioni për leximin, sidomos të librave historikë, kapriçoja, fanatiku, shpirti revoltues ndaj padrejtësisë. Fliste ngadalë, me një mënyrë bindëse, rrjedhojë këto të përjetimeve midis burrash që shquheshin për përdorimin mençurisht të fjalës. ...

BACA

Që Baca, kështu dëgjova që t’ i thërrisnin me shaka kolegët, një prosonim që ia vuri vetë vetes, është ai shaluar mbi kalë (në foton që shoqëron shkrimin), nuk është vetëm se ishte më i madhi në moshë, por se ishte dhe pak.... bajraktar, kështu thoshte, se nuk rridhte nga një fis dosido, por nga Zajmët e Dohoshishtit. Ishte një njeri i çuditshëm, i veçantë, një tip njeriu, i panjohur deri atëherë për mua që isha i sapodalë nga auditorët dhe jugor. Ai si personalitet, si karakter, si ngjizje dokesh, zakonesh, virtytesh e sjelljesh, ishte pjellë e odave, mexhliseve dhe kuvendeve dibrane, ndoshta më i vogli i familjes, ose ndoshta më i përkëdheluri, të cilin, me siguri, babai dhe gjyshi e mbanin para gjunjëve, dhe ai thithte çdo gjë të atyre kuvendeve, u mëkua me mençurinë e atyre njerëzve, që një intelektuali, sidomos jugor, nuk u besohej se ata pleq me kësula të bardha, me tirqe e xhamadanë, do të ishin aq të mençur, por ata zotëronin alegorinë dibrane dhe që t’ i kuptoje duhet të zbërtheje alegorinë, as përfaqësuesit e organeve sekrete të shtetit nuk i kuptonin se ku rrihnin me ato tregime që rrëfenin, veç po të tradhëtoheshin nga brenda.

Në Veri kuptova se ka dy interpretime të historisë; ai zyrtari, i cili është dhe më i dyshimti në vërtetësinë e tij, pasi ajo, historia, shkruhej nga fitimtarët dhe ai i odave, i cili ishte më pranë së vërtetës, që nuk ka interpretime të qëllimta, por historia thuhet dhe përcillet siç ka ngjarë.

Unë çuditesha me Baftjarin, me guximin e tij për të gjykuar njerëz aq lart kupolës së shtetit, kur binte fjala për Haxhi Lleshin, ai gjithmonë e emërtonte presidenti, duke ulur kokën, ndoshta për të fshehur diçka nga fytyra, nga sytë, për atë që thoshte me zë të ulët, gati sa thoshje se po i flet vetes: “Hajt mor, presidenti, kur iku nga Zogu u strehue tek jugosllavët”. Dhe me pak ironi përsëriste një varg nga një këngë e njohur e kohës me çifteli “Në Zogjej të Dibrës këndon bilbili”. E këndonte kështu që në zërin e tij fshihej një ironi dhe sarkazëm e lehtë. Ai e dinte rrezikun e kësaj që thoshte.

Shumë ngjarje të historisë të lexuara në botimet historike baca i redaktonte sipas versionit të dëgjuar nga dëshmitarë të ngjarjeve historike, ose të dëgjuara në bisedat e odave dibrane. Fliste në një mënyrë të tillë për historinë e Dibrës, që unë nuk e kisha ndeshur dhe dëgjuar. Katër grykët, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, Gryka e Homeshit, Nëntë malet e Dibrës, nuk thoshte Fushë Çidhën, por në Fushalie, Çidhna është përtej Drinit, thoshte me nënkuptim. Përmendte dhe fliste me një simpati të fshehur mirë emra fisesh si Demajt, Hoxhajt, Aliajt, Elez Isufi dhe Cen Elezi, Dali Ndreun etj. Tallej me zogistët dhe antizogistët, me revolucionarët pa shkak, me atentatorët, me komunistët, të cilët gjenin strehë te Pashiqi dhe në Jugosllavinë e Titos. Ato vite në Ostren me Baftjarin kreva dhe studimet për Histori, një histori e palexuar ndër libra. Mbaj mend se si reagonte kur lexonte librin e një veterani dibran, kur nuk ishte dakord me të thoshte duke turfulluar: “Budalli”.

Biseda ndizej kur në të merrte pjesë dhe Pëllumb Cami nga Gjorica. Ngjanin në kuptimin e historisë. Kur hapeshin biseda të tilla historike midis Baftjarit dhe të tjerëve, në fillim largoheshin komunistët mësues, edhe drejtori. E dinin mënyrën e gjykimit të historisë nga



Baftjar Zajmi

Baca dhe nuk donin të ishin dëshmitarë për ato që ai thoshte. Baca vetëm kur dialogonte me Sul Katën, mësuesin specialist nga Maqellara, atij nuk i kundërshtonte. Kisha vënë re se ata të drejtorisë dhe Partisë në shkollë, dhe ishin disa, kishim organizatë bazë, sikur druheshin t’ i mprehnnin thikat me Baftjarin. Ai vinte nga një fshat afër qytetit, njihte në komitete e seksion, dhe mendonin se ai mund t’ u bënte keq. Por Baca ishte burrë i mençur dhe serioz. Nuk merrej me vogëlima.



Në fotografi: (nga e majta) Petro Mejdi, Ilir Jorgo (agronom nga Tirana) Baftjar Zajmi, dhe i fundit Shkëlqim Shehu, (Gjoricë.)

Intermexo: in memoriam:

FIQIRI TOPI I SOPOTIT.

Një ditë Baftjari po i thoshte me zë të lartë një kolegu, Fiqiriut, nga Sopoti i Zerqanit: “Or Fiqiri, o ty të hangërshin ujqit”. (I tha kështu se ai ikte në të ngrysur përmes pyllit të Ramnagorës për në Sopot.)

“Pse m’thu kështu, o Baftiar”, - dëgjoja përgjigjen e Fiqos, me një të folur si e marrë zvarrë, ndaj dhe kur fliste Fiqiriu duhej të ishe shumë i vëmendshëm për ta kuptuar.

“Pse nuk martohesh?”, - ia ktheu Baca si për sqarim se përse e kishte nëmur.

U çudita kur e dëgjova nga goja e Baftjarit këtë këshillë miqësore. Ai dhe vetë ishte beqar. Kur e pyesnin Baftjarin se pse nuk martohesh, ai nuk përgjigjej menjëherë, qëndronte, të shikonte në sy dhe thoshte: “Nuk ka lind hala ajo cucë për mu, unë e du nga inkubatori. Ku ku, po a ke besë në cucat e sotme?!”

Fiqiriu nuk e keqkuptonte Baftjarin, bile ai ishte mbrojtësi i tij, diçka si kujdestar. U fliste nxënësve të fillores, disa djemve nga Tolajt e Lagjes së Gurit, Nakamen, i thonë në gjuhën e tyre vendasit, të cilët nuk rrinin mirë në orën e mësimit, dilnin nga dritaret. I gjori Fiqo, pas mësimit, dhe e kishte mësimin pasdite, shkonte deri në Sopot, afër Zerqanit. “Kam nanën vetëm - më tha një ditë, “s’un e la fillikat”.

Kur nuk gjente fletore për nxënësit, shkonte deri në Smollnik dhe Tërnovë. Drejtori këto i mbante mend dhe i përmendte në raportet e mbledhjeve të këshillit pedagogjik, si për t’ u marrë shembull. Fiqiriu i dëgjonte dhe skuqej i tëri, nuk ishte i mësuar që ta lavdëronin në kolektiv.

Një ditë kjo vërejtje e Baftjarit ndaj Fiqiriut mori përmasa më të mëdha. Ja dhe dialogu: Baftari: - Pse nuk martohesh, or Fiqiri?

Fiqiriu: - Sun gjej, o Bafjar. Ja, merr S (një mësuese nga Tirana). Nuk më merr, i dukem i keç (i keq, i shëmtuar), tha Fiqoja dhe rrotulloi pak sytë problematikë dhe filloi të skuqej.

- Merr L, këmbënguli Baca, duke i marrë me radhë të gjitha mësueset beqare.

- E kam milet, (e kam timen), or Baftjar.

- Mirë, merr E.

- More ku jeta, atë e ka Petro, - thirri si duke bërtitur Fiqoja.

Këtë herë Fiqoja jo vetëm që u skuq i tëri, por dhe u zemërua.

Fiqiriu ishte mësues i fillores. Para disa vjetësh e kishin pushuar nga puna. Nuk e mbaj mend arsyen. Kishte vetëm nënën. Ja bënë për inat dhe ai i shkruajti Enver Hoxhës. Aty ku nuk e priste Fiqon e thërrasin në zyrat e Partisë në Peshkopi dhe i thonë për përgjigjen e Enverit dhe se në shtator do të emërohet përsëri në arsim. Ndaj dhe i ziu Fiqo punonte shumë në klasë.

...

Baca martohet, por fati kishte për të dhe një gotë të hidhur.

Po të jetoje me bacën bindeshe se ai nuk e kishte shumë problem beqarinë. Ishte një kuzhinier i mbaruar. Ishte mjeshtër në gatimin e makaronave të skuqura. Gjente momentin kur ua hidhte ujin e zier që më parë dhe ato, makaronat, lëshonin një aromë të këndshme dhe nuk ngjiteshin. Me atë bukë që kishte kooperativa, makaronat ishin një zgjidhje ideale. Ato ashtu siç i gatuante Baftjari nuk të mërziteshin, edhe pse hanim shpesh.

Nuk e di nëse Fiqoja e vuri në jetë këshillën e Baftjarit për t’ u martuar, por vetë Baca, edhe pse e vonoi dhe disa kohë, u martua. Më së fundi ai gjeti një vajzë të mirë dibrane, ashtu siç ai e donte, të urtë, të ndershme e punëtore. Këto nënkuptonte ai kur thoshte se e donte nga inkubatori. Dhe krijoi familje të madhe. I erdhën në jetë katër fëmijë. Por jeta, kishte ruajtur një gotë të hidhur dhe për Bacën. I vdes vajza gjatë lindjes. Dhe ngushëllimin e gjeti te fëmija që lindi dhe i malcoi pak plagën e vajzës.

SKICIMI I NJË PORTRETI

Mund ta përfshish në burrat e gjatë, pak i bëshëm, gjithmonë me kostum, e mbaj mënd ngjyrë kafe të errët, këtë imazh kam në kujtesën time, nuk ishte i modave dhe i salltaneteve, nuk e kam parë kurrë të këndojë dhe vallëzojë, vinte vetëm në mbrëmjen për Enverin, më 16 Tetor, nuk mundej që t’ i shmangej, në kishim në shkollë një organizatë bazë dhe bashkime profesionale, që i shfrytëzonin këto raste. Dhe nuk e bënte se ishte kundër, jo, kështu ishte prerë si karakter. Flokzi, me një çetinë që mbulonte ballin e gjerë, kjo ngjante pak rinore. Kjo çetinë e kishte bërë me një huq, kalonte shpesh dorën mbi flokë për të disiplinuar çetinën, që kur i binte mbi ballin e gjerë, e tregonte pak më të ri, pak çapkën. Vinte i zeshkët, më shumë me ngjante me një ngjyrë gruri të dendur, kur ne shokët shikonim gjurmë të mëdha këpucësh në dëborë, thoshnim me shaka se para nesh ka kaluar baca, kur ecte i hepohej trupi, a thua se do të rrëzohej si lisi nga era, nuk e kam dëgjuar që të merret me thashetheme, as me biseda që fshihnin intimitete, kur ishim grup dhe takonte të kalonin ato vajzat e gjata dhe të bukura të Ostrenit, ai as mirëmëngjesi nuk u thoshte, përkulte pakëz kokën, sa për mirësjellje, kishte krijuar miq ostrenas, ishin nga ata të veprave të mëdha në ndërtim, që vinin nga kantieret, çoku e pinte ndonjë gotë rakie kumbulle, ashtu si dhe ne të tjerët, e shoqëronte me turshi që na sillnin nxënësit, shokët e tij ishin nga ana e Shupenzës e tutje, rrinte me Xhemalin, farmacistin e talentuar, them i talentuar, se Xhemal Hyseni bënte më shumë se sa një shitës i thjeshtë ilaçesh,, me Kujtimin, dentistin, por miku i tij, me të cilin ngjanin në njohuritë e thella për historinë, sidomos për atë që nuk e gjeje në libra, ishte Mehmet Loka, veterineri nga Tirana. Baftjari i lëshonte udhë Metit, nuk i kundërshtonte për të gjitha, megjithëse Baca i ruhej Metit, kishte frikë nga ai, jo nga ai vetë, por nga ca biseda të tij gjithë alegori, atëhere Baca i shmangej me marifet bisedës. Unë dhe disa të tjerë, të cilët kishim diçka në biografitë tona, “ trembeshim “ nga bisedat e të dyve. Më shumë frikë kisha nga prania në bisedat e Mehmet Lokës, ai e kishte me sistemin ku jetonim, Baca nuk fliste për aktualitetin, atij i dhimbte fakti që historia e Shqipërisë, dhe sidomos e Dibrës, nuk ishte shkruar realisht, ashtu siç ai e kishte dëgjuar në odat dibrane. Por thoshte histori të tilla që në librat shkollorë dhe politik thuheshin ndryshe. Por shoqëria jonë bëhej më e madhe kur takoheshim me agronomët, ekonomistët, oficerët e ushtrisë dhe ata të sigurimit. Në doje që ta vrisje Bacën ishte që të mos e dëgjoje me kujdes, ose më e keqja ta ndërprisje. --Burrat e ndigjojnë deri në fund njani - tjetrin, thoshte Baca gjithë zemërim. Ai që e zëmëronte shpesh ishte një koleg i fillores, ndodhte që dhe ai të dëgjonte Bacën dhe kur para sheshit të shkollës kalonte ndonjë për të cilin ai kishte antipati, fërkonte duart, duke i afruar tek gjunjët dhe thërriste pa përcaktuar se kujt, në gjuhën e vendit: - Doxhdollnik (salamandër). Baftjar Zajmi ishte armik i kuadrove mediokër, partiakë dhe shtetërorë. Kur ishte i detyruar që t’ i dëgjonte nëpër mbledhje, ulte kokën njësh me syprinën tavolinës ose bangës së nxënësve, dhe skroftinte për një çast, sa për të shkarkuar mllefin, që të mos e thoshte hapur dhe me zë qëndrimin dhe përshtypjen që i bënë ato që thoshnin sekretarët dhe instruktorët.

NJË KAPITULL ME PAK HUMOR

Baftjari kishte tre hobe; të lexuarit, lojërat e tavolinës dhe të shikonte ndeshje ndërkombëtare futbolli. Për të parë ndeshjet e kupave të Evropës, televizor kishte në vatrën e kulturës, por ne donim ndeshjet që jepte Shkupi, shkonim te ndonjë koleg ose në shtëpitë e nxënësve. Më ka rastisur disa herë që me Baftjarin të shoh ndeshje në shtëpinë e Flamurit dhe Islam Muçës. Në një ndeshje të kupave të Evropës midis Cervena Zvezdës dhe një skuadre gjermane, komentatori (Atanas Kostovski) përmendi shpesh fjalën greshi, që në sllavisht do të thotë gabim, gabim në pasim. Baca, i cili, edhe pse punoi disa vjet në Ostren, nuk mësoi thuajse asnjë fjalë. Aty nga fillimi i pjesës së dytë, kur vëmendja jonë ishte te loja, ai thotë: “Sa lojtar i madh ky greshi!” Ne qeshëm me të madhe. Ishte orë e vonë dhe me siguri të tjerët e familjes kishin rënë për të fjetur. “Or Bacë Bajrami, greshi do të thotë gabim, jep pasa të gabuara”.

Ai nuk foli. Ndoshta i erdhi inat që nuk e mësoi gjuhën e vendit. E kisha vënë re që nuk i pëlqente kur kolegët dhe nxënësit flisnin atë gjuhë në mjediset shkollore. Nxënësit nuk flisnin kurrë para tij. As në mensë nuk përdorte fjalë sllave. “Me sllavët jemi vra në shekuj”, thoshte Baca. Dhe nuk e kishte si justifikim, por po thoshte një të vërtetë historike. Ne të gjithë, herë dhe për shaka, i drejtoheshim kuzhinieres: “Kara imat sa jadime? (Çfarë ka për të ngrënë)? Dhe ajo rreshtonte gjellët: “Komomani (patate) pirinxhi (pilaf), graf (fasule) kromid (qepë. E vetmja fjalë që e kuptova, është një greqizëm) mleko (qumësht), mleko kisello (kos) etj...

EPILOG

Baca nuk bënte kurrë atë që nuk ia thoshte zemra, që nuk ishte pjesë e karakterit të tij. Ai këtë e quante pjesë të patriotizmit të tij. Dhe Baca ishte dhe është patriot. E përshëndes. I them se është një nga ata njerëz të njohur në udhët e jetës, të cilin do të doja që ta takoja, ta pinim një kafe së bashku.

Artistja e Popullit Margarita Xhepa
i jep çmimin e parë për poezinë "Sa shpejt ikin vitet"

Poezia e dhimbjes njerëzore
në pesë *libra* të Demir Rusit

***Nga* Halil RAMA**



Katër librat me poezi të Demir Rusit: "Ura e fjalës"; "Mos ik të lutem"; "Anja"; "Mos perëndo o dielli im" dhe libri me tregime e rrëfime "Djali që bleu vdekjen" janë promovuar bujshëm dhe mirëpritur nga lexuesi.

Nga libri i parë "Djali që bleu vdekjen", tek i dyti "Ura e fjalës", si dhe në tre vëllime me poezi të botuara në harkun kohor të dhjetë viteve të fundit, poeti e publicisti Demir Rusi, identifikohet si poeti i dhimbjes njerëzore.


Nëse në librin e parë me titullin sinjifikativ "Djali që bleu vdekjen", sipas recensentit Namik Selmani, "Mbetet në gjithë sipërfaqen shkronjore dhimbja, mbetet drama, mbeten viktimat dhe fajtorët e një tragjedie që quhet kurbet i paligjshëm. Mbetet emocioni i rrëfimit...", në vëllimet me poezi *"Ura e fjalës"; "Mos ik të lutem"; "Anja"; "Mos perëndo o dielli im"* është trashëgimia e bukur që mund të gjesh në gjuhën shqipe". Duke lexuar poezitë e këtyre vçllimeve nuk është e vështirë të konstatosh krijimtarinë produktive e cilësore të këtij autori, duke evidentuar kulturën e lartë gjuhësore, në ditaret, përshkrimet e poezitë e tij. Profilin e tij të e veçantë krijues D.Rusi e shpërfaq sidomos në poezitë që përçojnë plagët e rënda sociale që perjeton shoqëria e sotme.

Kështu nëse kriza globale e shkaktuar pas agresionit rus në Ukrainë reflektohet në vargjet e tij: *"Kriza tek ne, për fajin tonë/ Mirë ta ndreqim sa nuk është vonë/Kriza për naftën s'mund të besohet/Nëntoka jonë me naftë mbulohet..."*, kur vjen puna tek shkaktari i saj, vargjet e tij kanë nota të theksuara revolte: *Si nuk i mbaruam hallet njerzimit/ Mangut kishim dhe këto të Putinit/ Fashist i ndyrë, xhelat i pashpirt/Vret e pret dhe gratë e fëmijët"*.

Po ashtu pas vëzhgimit e investigimit të realitetit të trishtë, të krijuar nga veprimtaria e krimit të organizuar, fjala poetike e D.Rusit është alarmuese: *"Paksa te SPAK-u njerzit shpresojnë/ Po të vakët duken e spo veprojnë/Ata që ishin, po ato janë/ Veç po shtyjnë kohçn e gja s'po bajnë.."*

Vargje revolte krijon poeti edhe në poezinë "Mëkatarin, mëkati ndjek": *" Dëgjuar e kam e s'e mbaj mend/ Madje dhe lexuar në ndonjë vend/ "Shemben malet ngritën halet"/ Ndaj e keqja nuk po ndalet.../ Se nga vijnë këto të këqija/Topi mbetet tek qeveria/ Bëhen zgjedhje ndërron partia/ Hiqen të aftët vjen hajnia!!!"*

Poezia e Demir Rusit është poezi që recitohet, madje që interpretohet me ndjenjë, siç e ka inpertretuar atë Artistja e Popullit dhe Nderi i Kombit Margarita Xhepa në promovimin e librave të tij. Nga katër vëllimet e tij të promovuara njëherazi mund të përzgjedhësh si të tilla poezitë e titulluara: *"Shteti vret", " Se ke hall askush s'ta var", "Paraja dihet se të ngroh xhepin"; " Helmi"; Pse bën keq o njeri"; "Mos luaj me punën"; Karrikja ime"; "Skizofrenia"* e *"Vitet nëpër libra"*. Madje nuk qe rastësi që në takimin jubilar të 15-vjetorit të krijimti të Shoqatës Kulturore "Jehona Shqiptare", poeti Demir Rusi të nderohej me çmimin e parë të Konkursit ndërkombëtar të shpallur nga kjo shoqatë për poezinë më të mirë, ku si e tillë u vlerësua poezia e D.Rusit "Sa shpejt ikin vitet", çmim që iu dorëzua nga Presidentja e Nderit e kësaj Shoqate, ikona e teatrit e kinematografise Margarita Xhepa – Artiste e Popullit dhe Nderi i Kombit.



Nëse lexon poezinë e autorit Demir Rusit nuk ke nevojë të vërtitesh rreth qëllimit për të cilin shkruan autori. Poezia e tij e nxjerr prej dhimbjes njerëzore është si mushti.

Por nga libri *"Mos Perendo o Dielli im"* mund të veçojmë edhe poezinë me titull: *"Epitaf për vehten"*, kur poeti shprehet në vargje se *"nuk do t'ia shkruajnë të tjerët epitafin e pasvdekjes..."*

Le të ndalemi së fundi tek libri i tij i parë me tregime e rrëfime "Djali që bleu vdekjen", një botim produktiv dhe cilësor ku rrëfehet intelektuali që përjetoi strese të fuqishëm shkatërrues, por që nuk u tundua nga grishja për veprime aventurore në fushën e kontrabandës mafioze.... Në këtë libër rrëfehet intelektuali i mirëfilltë që kishte shërbyer me devotshmëri si oficer dhe si publicist ushtarak e si kryeredaktor i gazetës "Minatori", të cilin koha e gjykoi së mbrapshti, duke e dëbuar nga puna me motive krejt absurde dhe pa asnjë mbështetje, as juridike dhe as logjike. Duke përshkruar si askush tjetër emigranët që i janë lënë rastësisë, të jetojnë ku të mundin e si të mundin, të fituar apo të humbur, të gjallë apo të vdekur, pa një mbrojtje juridike siç e kërkojnë Kartat Ndërkombëtare, D.Rusi shpreh njëherazi dhimbjen për djemtë e mbetur deteve, kufomëprishur, ushqim për peshqit!.

Ndjeshmëria e mërgimtarit shprehet qartësisht sidomos në rrëfimin për hollësitë e asaj nate pus të zezë në Grykën e Otrantos.

Në librin "Djali që bleu vdekjen", (si edhe në vëllimin poetik) autori dallohet dhe për gjuhën e pasur në përshkrimin e personazheve dhe sidomos të miqësisë së tij me profesorin e nderuar italian, Xhovani Karbone.

Pikërisht kur shpreh admirimin, respektin e mirënjohjen për këtë personalitet të shquar italian, teksa ai e takon me një nga miqtë e tij që kishte shërbyer në Shqipëri gjatë luftës së lavdishme nacionalçlirimtare, evidenton edhe kontributin e partizanëve të batalionit "Antonio Gramshi" dhe veçanërisht heroizmin e Tercilio Kardinalit. Dashuri të pakufishme shpreh autori sidomos për nënat që janë njësoj në gjithë botën, që një emër dhe një zemër kanë.

Duke lexuar me vëmendje librin e D.Rusit "Djali që bleu vdekjen", edhe më pesimisti gjen forca për t'u bërë optimist, pasi përvoja e tij jetësore na mëson se "njeriu duhet të bëhet i fortë dhe t'u bëjë sfidë vështirësive që i dalin përpara; duhet të jetë optimist nëse dëshiron t'i mposhtë pengesat...Edhe kur është keq, njeriu nuk duhet t'i nënshtrohet së keqes....".

Ndërkohë autori është mjaftë bindës në konkluzionin për ekzistencën e të gjitha mundësive që Italia dhe Shqipëria të kthehen në simbole të vërteta miqësie e solidariteti. Kësisoj Demir Rusi prezantohet si vëzhgues i mprehtë i realitetit shqiptar dhe atij italian.

BUJTINAT MIKPRITËSE



BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: **Tomin** Tel: **0692053492**
E-mail: **aminasalkurti@gmail.com**



BUJTINA E JUFKAVE
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **069 937 7337**
E-mail: **agro_zerja@yahoo.com**



GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 511 4003**
E-mail: **guesthousesabriu@gmail.com**



KULLA HUPI
Vendndodhja: **Dushaj, Bulqize**
Tel: **068 837 3793**
E-mail: **kullahupi5@gmail.com**



BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: **Arras, Fushë-Çidhën**
Tel: **068 650 6061**
E-mail: **markuvladimir@yahoo.com**



GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **0218 20306**
E-mail: **bujtina.tershana@outlook.com**



BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 642 9888**
E-mail: **fitimgoleci1@gmail.com**

arkiv

Kuplon, "Vjeshtë e parë" 1991

NGA "FLETË TË VERDHA '90"

Qenoku e Ravnat, Kallaveret e Kabet, Bordet e Kubeni, Gjarajca e Pasmari... me rreshtat "fyell pushke" të pemëve, një nga krijimet më të bukura t mendjes e dorës punëtore dibrane, përbëjnë "rrethimin ekologjik" më të fortë që mund ti bëhet një qyteti si Peshkopia

TËNDEN E KE APO TË BABAIT

Pemëtaria në Kuplon është në hapat e parë. Këtë vit u morën 18 kuintal qershi nga 10 kuintal në plan. Pak? Kur e ndal vështrimin në atë bllokun 20 e ca vjeçar të Kubenit ku Bezat Cibaku me shokë mori 521 kuintal nga 430 në plan e ku u siguruar rreth 1.5 milionë lekë për hektar, sigurisht që është pak. Por kur mëson se ato janë kokrrat e para të qershive të reja, "lulet e para", kur të thonë se ato piqen 15-20 ditë më vonë e një kilogram është shitur me 6 lekë (badihava kur e mat me tregun e këtij viti e me faktin se ata janë "qershi gushti me kokrrën sa grushti"), kur sheh jo pak por mbi 12 mijë rrënjë që gjelbërojnë, thua se nuk janë pak. Këtë e thua duke pasur në sy të ardhmen: qershinë, mollën, por në veçanti lajthinë.

Njerëzit, specialistët e rinj: Jovani, Muhameti, Hakiu, Sabriu... menduan ta "zbusnin" malin. Ashtu siç "zbutën" paraardhësit e tyre,: Xhaviti, Mehmeti, Xhetani, Sabriu, Sadiku, Hajdari...kodrat poshtë.

Kanë dalë ca njerëz që nuk kanë haber nga bujqësia, që e njohin atë vetëm në pjatë, dhe akuzojnë se i prishën kodrat, e lanë blegtorinë pa kullotë...

Le të flasin, thonë disa, aq dinë e aq thonë. Edhe unë ashtu them, por kur i njoh si e bëjnë pazarin, më kujtohet ai i mençuri që para se të blejë të sheh në sy e të thotë: "Vetë e ke bërë apo e ke nga babai".

AFARIZMI I SALI ROSHIT

Sali Roshi i ka kaluar të pesëdhjetat. Kuploni ka edhe djersën e tij, prandaj ka forcë në fjalën e tij, ka bindje në mbrojtjen e asaj që ai me shokët e tij ka krijuar me mund. Se vetëm të ngjitesh nga Begjuneci në Kuplon, vetëm të vish nga Greva e Belllova në këto lartësi duhen 1-2 orë rrugë vajtje e po kaq ardhjeje. Nuk mund të humbet djersa e kësaj rruge. Pa le djersa e punës.

Veçse Saliu e ka një merak. Kështu siç është organizuar puna, siç janë varur përgjegjësitë në "qafën e vendit", nuk ecet përpara. "Kam mbjellë thekër në pemëtore, thotë ai duke u ndalë në një matematikë të thjeshtë. Ndërmarrja një kilogram thekër e merr me 1.7 lekë kurse shumë njerëz të lusin me 5 lekë kilogramin. Për të marrë kokrrën u detyrova ta shijë thekrën me autokombajnë. E copëtova kashtën, atë pjesë të bimës që për fshatarin është qëllimi i mbjelljes. Dhe kjo ndodh kur njerëzit vijnë e të lusin me 2 lekë kilogramin. Tash ajo nuk vlen për asgjë..."

Një temë interesante: prodhuesi përballë pazarit privat. Brigada përballë "tregut të madh" dhe "tregut të vogël". Kërkesa dhe oferta, siç përdoret rëndom në bisedat ekonomike. Po ta thellojmë pazarin vëren se kashta e thekrit, e përpunuar nga brigada "në ditët e shiut dhe të dëborës, në shtëpi", për qëllime artistike për eksport e dyfishon vlerën nga 2 në 4 lekë për kilogram. "Babai" e shet kështu "mallin" aq sa bën. I biri (burokracia në ndërmarrje dhe më lart) e shet badihava, e prish, e kalb.

E bëmë "llogarinë" me thekrën e një "parcele" të vogël në Kuplonin 10 hektarësh. Potëngulemi në "parcelën e madhe", në Kuplonin siç është në idenë e Sali Roshit dhe specialistëve të bujqësisë atëherë koha kërkon alarm të vërtetë, terapi "shok" në mendimin përpemëtarinë.

Po cila do të ishte kjo terapi "shok"? E thjeshtë. Me një urdhër administrativ Kuploni ti jepet Sali Roshit me brigadën e vet. Me që pemëtaria është në rritje "pronarit" ti jepet kredi për zhvillimin e shpejtë të saj. Kaq si fillim.

Pas këtij "shoku" Kuploni do të "privatizohej" apo "kolektivizohej". Për secilin anëtar të brigadës do të ishte i "Joni" me J të madhe. Shpenzimet do të niseshin drejt "kandarit të farmacisë" ashtu siç do të niseshin edhe shpenzimet dhe çmimet. Mendimi që midis radhëve të qershive të futet luleshtrydhja (natyralja, thotë Saliu, këtu bëhet aq shumë sa aroma mbush malin), mendimi që 200-300 dele mund të dimërojnë fare mirë, veprimi që gjen shprehjen në shartimet për vete në "fidanishten e Saliut" apo kujdesi që nga çdo gëmushë lajthie të merren fidanë duke plotësuar nevojat e veta, marrin rrugën e afarizmit.

Flasim shpesh për afarizëm. E konceptojmë atë si pronë të njerëzve të ditur. Lëmë mënjanë "afarizmin e vogël", dëshirën dhe kontributin e njerëzve të thjeshtë për tu marrë me biznes.

Sali Rroshi kërkon të rrezikojë, kërkon të provojë riskun e vet. Dhe e kërkon në një majë mali, në 1200-1400 metra lartësi, në lajthishte. Dhe e kërkon në një sektor shumë të vështirë, të "dështuar" siç thuhet rëndom në gazeta. E kërkon në bujqësinë malore. Në atë bujqësi ku kambanat e kohës po bien me tërsëllimë marramendëse "Braktisni malet!", "zbrisni në fushë!"

Erozioni ekonomik drejt fushës pengohet duke i dhënë malit atë që i takon malit. Me laps. Me vullnet. Me afarizëm. Me interesa të çastit por edhe të perspektivës. Biznesi (ato 12.520 qershi, 3920 mollë, 170 dardhë e në veçanti ato 4070 lajthi kokërrmadhe "Visoku") i dhjetëfishon në numër, i shumëfishon në prodhim dhe në të ardhura.

TI HEQËSH SËPATËS BISHTIN

Pasi zbrita nga Kuploni shkova në Kuben, në Kastriot e Ostush. Takova punëtorët e brigadës tek vilnin kumbulla. Mu ftoh pak zemra kur pashë Kastriotin pa mollë, Kubenin e Ostushin me pak kumbulla, edhe atë të krimbur. Pranvera e lagësht e këtij viti, shoqëruar me ngricën politike i rrëzoi lulet e mollës, i krimbi kumbullat. Pak menduam dhe aspak vepruam për të përballuar ngricat e luftuar sëmundjet e dëmtuesit. Menduam e luftuam për partitë politike e replikat në takimet në rrugë. Pasoja shihet: Lulet e mollës nuk lidhën kokrra e kokrrat e kumbullave u krimbën.


Dikush, një partiak nga këta të rinjtë që bredh nëpër vend për vota, thotë se kur kaloi para do ditësh këtej tha: "Këto kodra janë të bukura për blegtorinë" (dikur një partiak pat thënë "Këto kodra janë të bukura për pemëtarinë)". Kaq u desh që të nesërmen bagëtia të sulmonte pemëtoret. Kaq u desh që sëpata të binte mbi pemët 20-30 vjeçare. Me gjithë kokrra...

Njerëzit e dinë se sëpata pa bisht nuk pret dot një dru të vetëm e jo më të presë një pyll të tërë pemësh...

ABDURAHIM ASHIKU

Qenoku e Ravnat, Kallaveret e Kabet, Bordet e Kubeni, Gjarajca e Pasmari... me rreshtat "fyell pushke" të pemëve, një nga krijimet më të bukura t mendjes e dorës punëtore dibrane, përbëjnë "rrethimin ekologjik" më të fortë që mund ti bëhet një qyteti si Peshkopia.

Njerëzit e dinë se sëpata pa bisht nuk pret dot një dru të vetëm e jo më të presë një pyll të tërë pemësh...



Legjenda



Nga **SHAQIR SKARRA**

Zanat e Shumbatit

Poshtë Kroit të Verës, në një luginë që ndan fshatin Shumbat në dy mëhallë, ndodhet një emër vendi që në popull quhet "Hurdha-Togë", një emër vërtet disi i çuditshëm. Këtu, nga uji i rrjedhshëm që vjen nga poshtë luginës, krijohet një ujëvarë e vogël, ku lahen fëmijët gjatë verës.

Gojëdhëna ka ardhur deri në ditët tona, se ndodhte që në orët e vona të natës, pikërisht, kur udhëtarët kalonin këtej, dëgjonin tinguj të ndryshëm, lodra dhe curle, tamam siç ndodh në një dasmë fshati

Të moshuarit tregojnë se tingujt dëgjoheshin deri sipër në kodër. Herë-herë këto tinguj ishin të frikshëm dhe herë-herë bëheshin të dashur për udhëtarët, të cilët rrinin lart në rrugë e dëgjonin.

Askush nga pleqtë e fshatit nuk e kuptonte drejt se kush kërcente tek "Hurdha-Toga" në orët e vona të natës nën tingujt e lodrave dhe curleve.

Kjo ndodhte në orët e vona të natës se ditën "Hurdha-Toga" ishte pronë e fëmijëve të fshatit, të cilët, pasi laheshin, shulleheshin në gurët e nxehtë që ndodheshin aty pranë. Lidhur me këto tinguj muzike, natën shumë veta nga fshati thoshin se janë 'ato që qofshin larg', dikush thoshte se janë xhindet se këto dalin natën.

Shpeshherë, gratë e fshatit, kur kishin ndonjë fëmijë sëmurë apo shëndetlig, e merrnin dhe e linin pak kohë tek "Hurdha-Toga". Besonin se këtë fëmijë e merrnin xhindet dhe e ndërronin me një fëmijë tjetër. Ka pasur mjaft raste që në fshat shpreheshin që "filan fëmijë është i ndërruar" (i këmbyer me një tjetër).

Kjo ka ardhur si besëtytni deri në ditët tona se tashmë nuk dëgjohen tinguj lodre dhe curle. Megjithatë legjendat tona janë mbushur me zana dhe shtojzovalle. Ndoshta dhe "Hurdha-Toga" ka qenë një mriz i bukur, një log ku dëfrenin në qetësi zanat e malit pikërisht tek kjo ujëvarë e vogël me ujë si kristal. Sot këtu nuk dëgjohen si më parë tinguj lodre dhe curle, por ama toponimi "Hurdha-Togë" apo "Logu i zanave" ka mbetur.

Liqeni i Zi

Megjithëse ka mjaft gojëdhëna të ndryshme, në Kala të Dodës ndodhet një vend që ende është i mbuluar me mister dhe një nga vendet më të bukura dhe piktoreske në të gjithë zonën. Sot i thonë "Liqeni i Zi".Edhe kjo ka legjendën e saj. Tregojnë se pikërisht këtu është mbytur një nuse e re bashkë me burrin e saj. Kishin dalë të dy herët në mëngjes burrë e grua dhe po punonin tokën me qé, që atëherë kjo ishte një pllajë e bukur e mjaft prodhuese.

Kur dielli ishte në të perënduar e toka ishte në përfundim e sipër, duke u lëruar nga qetë sakaq çahet një zgafellë e madhe në mes të saj dhe i përpiu të dy burrë e grua, si dhe qetë bashkë me parmendën dhe zgjedhën. Flitet se stolitë e florinjta të nuses së re dolën aty ku sot është "Kroi i Mirë".

Vite më vonë kjo copë are u mbush me ujë e u bë një liqen, që sot në popull quhet "Liqeni i Zi". Kështu i mbeti nga mallkimi që i bënë banorët për mbytjen e nuses së re. Tek "Kroi i Mirë", ku thonë se dolën stolitë e nuses, ka ujë të rrjedhshëm, por ujë është mjaft i rëndë në të pirë. Udhëtarë të ndryshëm ndalojnë tek ky krua dhe shpeshherë lënë dhe ndonjë penj apo diçka tjetër nga rrobat e trupit që kanë veshur dhe pinë ujë.

Kjo lidhet me besëtytnitë se gjoja ky krua sjell mbarësi.

ANEKDOTA

Atë trung nuk po e gdhend kurrë

Unis një plak nga Luznia për të shkuar një natë tek një mik në Çidhën. Sapo u fut në oborrin e shtëpisë, djali i vetëm ndodhej jashtë dhe këtë mikun nuk e priti mirë, bile i tha se baba nuk ndodhet në shtëpi. Luznakut i erdhi mjaft keq për këtë pritje që i bëri djali, por përsëri u fut në shtëpinë e mikut. Sapo u ul, i zoti i shtëpisë nisi e po e pyet mikun si je e a u lodhe rrugës.

- Mirë jemi të gjithë e rrugës nuk u lodha, por më erdhi keq se bash tek porta jote hasa me një trung të pagdhendur e desh rashë përdhe. I zoti i shtëpisë e kuptoi se çfarë i kishte ndodhur mikut, ndaj ia ktheu:

- Mos u mërzit, bre burrë! Unë kam mbi tridhjetë vjet që merrem ta gdhend atë trung, por ende nuk po e gdhend. Asnjë ashkël nuk i del.

Neki Osmani,
mësues e drejtues shkollash

Neki Osmani, mësuesi i Grazhdanit

Nga **OSMAN XHILI**

Ai lindi në Grazhdan të Dibrës më 15 prill të vitit 1942.Ishin vite të vështira, lufte dhe urie, por fëmija i vogël u mëkua me dashurinë për familjen, për dijen dhe patriotizmin.I jati, Veseli, për shumë vite shërbeu si xhandar në administratën e Zogut. 7 prilli i vitit 1939 e gjeti si roje në burgun e Tiranës. Bashkë me lirimin e të burgosurve iku dhe Veseli, duke u larguar përfundimisht nga puna. Në vitin 1943 u rreshtua me forcat partizane të Aqif LLeshit, deri në çlirimin e vendit. Mori pjesë në luftën për çlirimin e Peshkopisë, Dibrës së Madhe e shumë beteja të tjera.

Nga viti 1945 deri në vitin 1965, pra për 20 vite rresht, babai i mësues Nekiut shërbeu si kryetar i këshillit të fshatit.Duheshin kapërcyer pasojat e luftës, duhej siguruar buka e gojës, që aq shumë mungonte asaj kohe.Duheshin bërë përpjekje për hapjen e shkollës fillore, aqshumë e nevojshme për fëmijët e fshatit.Jo vetëm kaq.Veprat e mëdha të kohës që po ndërtoheshin me punë vullnetare donin krahë pune e sakrifica të tjera.Vesel Osmani shkoi të punojë për gjashtë muaj si vullnetar në ndërtimin e hidroçentralit të Ulzës. E zgjodhën si zëvendës komandant brigade dhe u dekorua dy herë me medaljen e punës nga presidiumi i Kuvendit Popullor.

Kështu pra, Nekiu i vogël, mori mësimet e babait, dëshirën për punën e dijen.Në vitin e largët 1948 filloi arsimin fillor, për të vazhduar shtatëvjeçaren në Maqëllarë. Duke qenë se doli me rezultate shumë të mira, ju dha e drejta për të vazhduar shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi. Sërish nuk munguan rezultatet pozitive, sidomos me prirje te shkencat e natyrës.

Në vitin 1959, ministria e arsimit e emëroi mësues në rrethin e Mirditës, në fshatin Reja e Velës. Nëse Migjeni flet për Lulin e vocër, mësuesi i ri gjeti shumë të tillë si ai, këmbëzbathur e me një këmishë të gërrisur në trup. Por pasioni e dëshira për dije dhe arsim, nga mësuesi dhe nxënësit triumfoi mbi skamjen dhe varfërinë. Për dy vjet pune të mësues Nekiut u bënë ndryshime të dukshme pozitive.Cilësia e notës dhe kalueshmëria njohën nivele më të larta. U shtua dhe shkolla e mbrëmjes, krahas asaj të ditës, ku frekuentuan mbi njëzetë të rinj e të reja.U ngritën kënde sportive për lojra të ndryshme, kurse vatra e kulturës zhurmonte nga vallet dhe këngët e të rinjve të talentuar. Mësues Nekiu shpalosi në këto dy vite gjithë energjinë dhe aftësitë metodike, duke merituar medalje nga presidiumi i Kuvendit Popullor.

Në vitin 1961 transferohet në Dibër, në shkollën shtatëvjeçare të Maqëllarës, pikërisht në atë shkollë ku kishte qenë si nxënës vite më parë. Duhej të jepte matematikë dhe pse prirjet i kishte diku tjetër. Por kjo nuk e zbehte aspak eksplorimin e mësues Nekiut në një shkencë ekzakte, siç ishte kjo lëndë e vështirë. Vetëm dy vite më pas emërohet drejtor shkolle në Majtarë, kur ishte vetëm 21 vjeç. Në kaq pak vite djaloshi i ri kishte treguar aq shumë vlera e këto vlera do të shtoheshin shumë më tepër në të ardhmen.

Të kishe shkollën e mesme pedagogjike në atë kohë, kur kishte plot mësues me shtatvjeçare, ishte njëluks i vërtetë. Por mësues Nekiut ju dha një bursë studimi për të vazhduar Institutin pedagogjik në Tiranë, në degën biologji e kimi. Pas kësaj ai emërohet drejtor shkolle në Maqëllarë, por jo vetëm për një shkollë, por dhe për gjithë zonën e Maqëllarës. Nga viti 1966 deri



Të shumta janë medaljet dhe vlerësimet e bëra për të në këtë hark të gjatë kohor.
Ministria e Arsimit i akordon çertfikatën, si Mësues i dalluar në shkallë vendi. Bashkimet profesionale të Shqipërisë i japin fletë nderi për kontributin e dhënë në edukimin e brezit tëri.
Në vitin 2018, Bashkia e Peshkopisë i lëshon çertfikatën me motivacionin "Personalitet i spikatur, që me cilësitë personale, njerëzore, artistike dhe vizionet moderne, ngriti në nivelet më të larta, arsimin në Dibër, duke u bërë ambasador i denjë i saj.

në vitin 1973, Neki Osmani do të ishte në qendër të zhvillimeve të kohës për çeshtjen e arsimit të kësaj zone.

Për gati njëzetë vjet, nga viti 1945 deri në vitin 1965, arsimi shqiptar kishte pasur qëllim masivizimin, luftën ndaj analfabetizmin, hapjen e shkollave fillore në çdo fshat të Shqipërisë. Ishin pjekur kushtet dhe kishte ardhur koha që gjërat të njihnin një cilësi të re. Duhej bërë një reformë e re, që konsistonte nënjë lloj tjetër mësimdhënje. Baza materiale dhe ngritja e kabineteve për çdo lëndë të veçantë do ti shërbenin më së miri kësaj reforme arsimore. Mësuesit, por dhe nxënësit u angazhuan dukshëm në ngritjen e kabineteve të historisë, gjeografisë, biologjisë e kimisë e fizikës.Emra të tillë si Hajdar Poliçi, Shahin Lazri, Hajri Xhili, Remzi Sala, Avni Gjoni e shumë të tjerë, u bënë pika referimi, ku duhej marrë shembulli dhe modeli i mirë. U ngritën kënde sportive dhe fusha futbolli, volejbolli, gropa kërcimi,paralele e vegla gjimnastikore. Spartakiadat dhe evente të tjera sportive priteshin me shumë interes nga nxënësit, por dhe më gjerë akoma.Ekipet fituese ndesheshinme zona dhe rrethe të ndryshme të vendit.

Një kujdes i veçantë u tregua për lidhjen e nxënësit me punën prodhuese . Asaj kohe , shkollave u jepej në zotërim nga tre dynymë tokë. Aty nxënësit mbillnin e kultivonin perime e bimë të ndryshme, njiheshin me kërkesat, karakteristikat dhe fazat e tyre të zhvillimit. Krahas përfitimit të njohurive nga nxënësit, kishte dhe një tjetër vlerë nga kjo veprimtari.Siguroheshin mjaft të ardhura, që shërbenin për nevojat e shkollës, apo për eskursione të klasave të shtata në qytete të ndryshme të vendit.

Hapja e shkollës së mesme në Maqëllarë ishte një ngjarje e madhe për zonën.Gati për çdo vit në zonën e Maqëllarës mbaronin shkollën tetëvjeçare rreth 150 nxënës. Një pjesëjo e vogël e kësaj armate dëshironin të vazhdonin shkollën e mesme e ndoshta më pas dhe shkollimin e lartë. Kushtet nuk ishin aspak të përshtatshme për momentin, por do të rregulloheshin me kalimin e kohës. Mjafton që dëshira, vullneti dhe përkushtimi ishin në shkallën më të lartë.Fillimisht u përshtatën ambjentet ekzistuese të shkollës tetvjeçare, kurse programet u muarën nga shkolla e mesme e Peshkopisë.U vendos që shkolla e mesme të fillonte veprimtarinë e saj, si shkollë mbrëmje, pa shkëputje nga puna, me datën 15 tetor të vitit 1968.Ishte e para shkollë e mesme në nivel fshatrash në Dibër.

Kështu ndodhi, atë pasdite vjeshte, kur 36 nxënësit e parë të kësaj shkolle u ulën në bankat e saj për të vazhduar rrugëtimin katër vjeçar. Ishin të moshave e profesioneve të ndryshme, por i kishte bashkuar dëshira për të fituar dije të reja dhe për tu bërë dikushi në jetë.Orën e parë të mësimit e zhvilloi mësuesi Qamil Sula e më pas vazhduan dhe të tjerët...

Dy vite më vonë, u hapën dhe dy klasë të gjimnazit dhe tashmë po shtoheshin përmasat e saj. Në vitin 1971 shkolla e mesme u bë drejtori më vete dhe drejtor i parë i saj do të ishte Neki Osmani. Shkolla u shkëput dhe fizikisht si vendndodhje nga tetvjeçarja dhe u vendos në ndërtesën e Fiqiri Dines, ish kryeministër i Shqipërisë për pak kohë.

Në vitin 1975, tamam atëherë, kur mësues Nekiu kishte arritur kulmin e pjekurisë si një metodist i zoti dhe drejtues vizionar, ndodhi goditja e madhe. Shteti komunist i kohës, arreston dhe dënon me 16 vjet heqje lirije, vëllain e gruas. E shoqja, Shpresa, në atë kohë kryetare e këshillit për Dovolanin, largohet nga puna dhe dërgohet të punojë në një brigadë plehrash në kooperativë. Mësues Nekiun e dërgojnë të punojë në Melan, ku qëndroi deri në vitin 1979.Nga kjo kohë e deri kur doli në pension, në vitin 2001, punoi si mësues në shkollën tetvjeçare të Dovolanit.

Ditën e parë të fillimit të shkollës për vitin 2001, mësues Nekiu nuk merr regjistër në dorë, siç kishte bërë për 43 vjet. Shkolla kishte vendosur ta nderonte mësuesin me kontribute të shumta për arsimimin e zonës dhe më gjërë akoma. Nxënës, mësues, drejtues shkollash kishin ardhur në këtë ceremoni, sa të thjeshtë aq dhe madhështore, për nga mesazhet që përcillte. Vetëm nga Dibra e madhe kishin ardhur tre drejtues shkollash dhe 12 mësues.Drejtori i shkollës së Dovolanit foli për kontributin e paçmuar të mësues Nekiut, në gjithë këto vite mësimdhënje e drejtimi.Folën dhe miq e të ftuar me fjalë që u dilnin nga zemra.Nxënësit e shkollësi dhuruan buqeta me lule.U dha një program artistik dhe u zhvilluan shumë aktivitete sportive, fituesit e të cilëve u nderuan me çmime.

Zakonisht, me daljen në pension, kurba e veprimtarisë njerëzore sikur bije e merr të tatëpjetën, por me mësues Nekiun nuk ndodhi kështu.Ai nuk u veçua, nuk u plogështua dhe nuk u dorëzua.Një ndjesi e brendshme i thoshte se kishte për t'i dhënë akoma shoqërisë e komunitetit. Kishte një bibliotekë të pasur si një aleat shumë të fuqishëm.Shikimin e kishte akoma të mprehtë, si të një shqiponje. Lexonte libra, sistemonte kujtime dhe projektonte të shkruante diçka, që do të mbetej me shumë vlera në sirtarin e kohës. Pas disa vitesh punë e përpjekje, mësues Nekiu boton librin "Grazhdani i Dibrës".Është një libër që të përpin me materialin e pasur, me historik interesant të fiseve, që përbëjnë fshatin, me historikun e kalasë së Grazhdanit, e rrallë në llojin e saj, për nga mosha dhe përmasat e saj.Mësues Nekiu nuk ka të ndalur në krijimtarinë e tij. Ai po bën gati një historik tjetër për fisin e shquar Osmani të Pocestit. Më tej po vazhdon me historikun e arsimit në zonën e Maqëllarës, ku dhe vetë ka qenë aktor dhe pjesëmarrës aktiv në shumë evente, ashtu siç i përmendëm në fillim.Është autor i disa shkrimeve dhe bashkëpunëtor në emisione të ndryshme kushtuar Grazhdanit e trevës së Maqëllarës.

Në gjithë këtë veprimtari të dendur të punës së tij, si mësues e drejtues shkollash, mësues Nekiu ka provuar dy anët e medaljes, zhgënjimin dhe nderimin për punën e bërë. Të shumta janë medaljet dhe vlerësimet e bëra për të në këtë hark të gjatë kohor. Ai ka fituar medaljen e punës nga presidiumi i Kuvendit Popullor.Më pas, Ministria e Arsimit i akordon çertfikatën, si *Mësues i dalluar* në shkallë vendi. Bashkimet profesionale të Shqipërisë i japin fletë nderi për kontributin e dhënë në edukimin e brezit tëri. Në vitin 2018, Bashkia e Peshkopisë i lëshon çertfikatën me motivacionin "Personalitet i spikatur, që me cilësitë personale, njerëzore, artistike dhe vizionet moderne, ngriti në nivelet më të larta, arsimin në Dibër, duke u bërë ambasador i denjë i saj".Të gjitha këto janë vlerësime dhe nderime, që do ti pëlqenin çdo njeriu, por vlerësimet dhe respektet më të mëdha vijnë nga ish nxënësit, mësuesit e bashkëpunëtorëve të tij të shumtë.

Më datën 15 prill, mësues Nekiu feston 80 vjetori. Një jetë e mbushur me mund e përpjekje për t'i dhënë më të mirën brezit të ri, ashtu siç dinë ta bëjnë mësuesit e devotshëm. Urojmë që jeta e tij të jetë e gjatë, që mendja e tij të punojë akoma dhe penda e tij të shkruaj gjëra të bukura e të vlefshme për njerëzit.

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

BOTIMET M&B
mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283
Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose mund t'i porosisni online.
Posta brenda vendit është FALAS

Për librin poetik të Basir Bushkashit ”Nëpër valë malli”.

Valët e jetës, të kthyera në valë malli…

Nga **MEVLUD BUCI**



Duke lexuar në vite krijimtarinë poetike të poetit matjan e mbarëkombëtar, Basir Bushkashi, hetojmë me kënaqësi sesi rritet e bleron kjo krijimtari, nga libri në libër.Trinomi shpirt-vlerë-dashuri shfaqet edhe në librin e fundit, të gjashtëmbëdhjetë, botuar në këtë fillim viti, 2022. Basiri dallohet për një verb të frymëzuar, realist, të thjeshtë, komunikues, të urtë, ai shfaqet në dashamirësinë e tij dhe me lirikën e vet edhe si ëndërrimtar, gjurmues e ngulmues, që fjala të ketë peshën e vet artistike.

Te çdo poezi e këtij libri, pasqyrohen çaste të kohës përmes testamentit të mirësisë, në një këndvështrim liriko-poetik, larg çdo mode apo të dukuri. Poezia shkon në fillesën dhe ngjyresën e vet më origjinale si një lirikë e pastër. Kryemotivi i poezisë së Basirit është dashuria për njeriun, zbulimi i vlerave të tij përmes të thjeshtës, prandaj poezia e tij rrezaton dritë dhe një harmoni të butë. Delli i tij poetik shpreh krenarinë për këto vlera, që mund t`i zbulojë një poet i vërtetë. Dhe këto vlera transmetohen natyrshëm përmes mesazheve filozofike, ku toni lirik i vendos ato në atë drejtim që e meritojnë, në kahun e komunikimit të drejtpërdrejtë, si një urtësi, këshillë, si zbulime poetike. Malli, sinqeriteti, është një cilësi e rrallë në poezi, cilësi që vjen natyrshëm te ky poet, ku vargu buron prej frymëzimit dhe harmonisë që ai e ndërton në shpirtin e tij. Melodiciteti, ritmika, tonaliteti i butë lirik, transparenca, kthjelltësia dhe drita e shquajnë poezinë e Bushkashit dhe mbeten tejet të veçanta. Livadhi i blertë i poezisë së sotme ka shumë lule, por në këtë livadh nuk mund të hysh, pa zgjedhur një lule nga poezia e Basirit.

Basirin do ta quaja dritë-kënga e urtësisë, një zbulues i thesarit të fjalës, që këtë thesar nuk e mban për vete, por ua dhuron lexuesve të tij të shumtë me bujari. Ndaj, poezia e tij këndohet dhe mbahet mend, jo vetëm për detajet, por edhe për organizimin e saj ritmik dhe zgjuarsinë intuitive në kapjen e detajit, pa e anashkaluar dhimbjen njerëzore.

Si çdo poet i vërtetë, edhe Basiri diagnoztifikon kohën, por pa e nxirë atë. Ka aq shumë mirësi, humanizëm dhe dritë, në poezinë e tij, sa edhe e keqja, fenomeni negativ, sikur turpërohet para kësaj mirësie. Poeti nuk e godet të keqen me satirë, as me nervozizëm, por me butësi, duke e nxjerrë këtë cilësi në kontrast me të shëmtuarat e jetës.

Libri hapet me poezinë “Fisnikëri” dhe me një faksimile nga Bajram e Drita Gjoni, të cilët midis të tjerash shkruajnë:””I dashur Basir! Kontributi juaj në botimin e librave është shumë i madh. Sipas mendimit tonë, ju nuk i përkisni vetëm Matit, por krijimet tuaja kanë jehonë në rang kombëtar”.

Dhe poeti shkruan me dëlirësi shpirti:

Njeriu i bukur
Kudo bën dritë,
Qoftë në Mat,
Qoftë në Amerikë.

Bajram Gjoni
Aq zemërflorinjtë,
Bashkë me Florën
N`pension, n`Amerikë.

Po aq njerëzisht
U kish shkrep në shpirt,
Një librin tim
Ta nxjerrin në dritë.
Nderim për ju
Nderim për fëmijtë…

Si modest edhe mirënjohës, cilësi të një poeti të vërtetë, Basiri do ta shfaqë këtë edhe në poezi të ndryshme për njerëz të tjerë, sepse poezia e vërtetë vjen nga dashuria për njerëzit, nga përditshhmëria e të jetuarit me ta. Ndaj në vargjet e tij shfaqet ky mision aq konceptual:

Shkruaj për t`i thënë qiellit
Me ty kaltëroj,
Për t`i thënë detit
Me ty dallgëzoj,
Për t`i thënë lules
Me ty erëmoj,
Për t`i thënë zogut
Me ty fluturoj
Për t`i thënë jetës:
Sa shumë të çmoj!

Poezitë e tij:”Rrathët e shpirtit “, ”Fjala”, ”Nëpër kohë”, ”Veç mos kujto”, ”Asgjë”, ”Si nëpër mjegull”, ”Ismail Kadaresë”, ”Eh, kjo botë”, ”Për pakëz qiell”, ”Vijnë ca pëllumba”, ”Bora”, ”Përpëlitet fjala”, ”Vehbi Skë nderi”, ”Ashtu çapngadalë”, ”Rrënjët e gjakut”, ”Dhembshurisht”.., ”Mbi çdo ligësi”, ”Zef Serembes”, ”Pa femra”, ”Nëpër valë” etj, pasqyrojnë imazhe drithëruese plot sharm e kuptim. Shfaqet aty-këtu, në poezitë:”Zef Serembes”, ”Me njëqind ngjyra “etj; shpirti lirik që trazohet nga një rebelizëm i beftë

Në poezinë e Bushkashit natyra merr një gjallëri të veçantë, ajo ripërtërihet dhe shfaqe t në pamje të ndryshme. Herë jepet si idil, e herë në trazimin e vet përmes detajeve e peizazheve të llojllojshme. Natyra nuk vjen si element dekorativ, po ajo përthithet dhe shpaloset aq natyrshëm, sikur frymon.

Në për gjithësi poezia e Basirit është e shkurtër, e koncentruar me fuqi goditëse të mendimit dhe të imazhit. Ajo zbulon enigmat e shpirtit, kontrastet dhe të befason me nxjerrjen në dukje të tyre, përmes fjalës së zgjedhur e të kujdesshme. Melodia vjen si shushuritja e përrenjve malorë, flladi si era e freskët e verës dhe poeti i rrethon e u afrohet me shpirt jo vetëm sendeve, objekteve, por më së shumti njerëzve.

Ai është poeti që e ndërton fabulën përmes së thjeshtës, zbulon gjëra që shfaqen çdo ditë para syve tanë, që flasin me praninë e tyre, por poeti i vërtetë i bën më të bukura këto zbulime përmes fuqisë së tij të fjalës. Dhe poeti skanon këto vlera, të cilat mbulon herë -herë nga indiferenca e të tjerëve ose pazotësia e vëzhgimit të disave.

Me pak vargje ai sjell një poezi që portretizon. Dhe në këto portrete lëvizin si në kaleidoskop gjurmët e thjeshtësisë, brengave, dhimbjeve, mirënjohjeve, kujtesës:

Ahmet Beshiri
Iku nga kjo jetë,
Zemërpërvëluar,
Se s`i erdhi jeta
Siç e kish ëndërruar.
U prehtë në paqe
Lulembuluar!...

Në këto vrulle të dashurisë për njeriun, moshën, jetën, bashkëshorten, prindërit, shokët, miqtë, figurat e ndritura të kombit e të letërsisë botërore, nuk mund të mos ndalesh herë pas here për të kuptuar dhe ndjerë pulsin e poezisë së Basirit, që frymon si një organizëm i gjallë. Kjo duket te poezitë:”Në krahët e moshës”, ”Mikpritja italiane”, ”Kësaj bote të çuditshme”, ”Petrit Ruka”, ”Zogjtë shtegtarë”, ”Agim Dervishi”, ”Me zemër të bardhë”, ”Lumturisht pi”, ”Nëna ime”, ”Si shpirti yt”(babait), ”Dehur nëpër këngë”, ”Dashuritë”, ”Si një manushaqe”, ”Vilat”, ”Brengat” e të tjera. Nga poezitë e Basirit mund të krijosh buqeta me ngjyra të ndryshme, ku nuk mungon dhe i përbashkon vetëm një ngjyrë;ngjyra e dashurisë.

Figura në poezinë e tij vjen spontane, pa e kërkuar, pa lodhje. Dhe kështu mund të gjejmë paralelizmin figurativ, metaforën, krahasimin, inversionin etj, një tërësi figurash që nuk e rëndojnë mendimin, përkundrazi e mbajnë atë në këmbë me fuqinë e tyre të natyrshme .

Po Nënë Tereza,
E ndritura shenjëtore,
Ka ngritur vilat
Më madhështore.

Eh, ne të varfërve
Krejt të harruar,
Ajo vila gëzimi
U ka dhuruar.

Tematika e gjerë që vjen në përthyerje motivesh, gjetjet, pathos në frymëzim, fjalor i pasur, nuk janë zbukurime të rastësishme, por vijnë domosdoshmërisht si shenjë talenti. Ai tashmë është një poet i konsoliduar, një zë lirik i veçantë, vetvetja, por edhe në vazhdën e poetëve më të spikatur lirikë, si një Esenin i Matit, që u këndon brengave, dhimbjeve, mirënjohjes dhe që shpalos vlera, thjesht, pa bujë, në mënyrë të natyrshme.

Redaktori Kujtim Stana, recensenti Gegë Tusha, mjeshtri i kopertinës, Agron Sejamini, grafisti Artan Dilaver Kurti, figura të njohur të artit, me emrat e tyre, ndihen mirë në këtë libër, ashtu siç u ndjeva dhe unë si lexues dhe poet, dhe kam besim se, mirë do të ndihet me këtë libër çdo dashamirës i artit dhe i poezisë.

SARKAZËM

EH, Ç'MË KUJTOVE VELIUN E FURRËS, OR MEC

Veliu ishte humori i viteve të mia të fëmijërisë. Të “miat” them edhe unë, kur ata ishin jo vetëm të fëmijëve por edhe të rriturve, burrave me një pashë mustaqe. Thashë “të miat” sepse ne ma shumë ia linim e të mëdhenjtë gajaseshin së qeshuri kur ai na ndiqte derisa të na e linte “peçin”.

E ne, në një stafetë njeri pas tjetrit, vazhdonim t'ia linim e ai vazhdonte të na ndiqte...

Peçi, për ata që nuk e gjejnë as në fjalorin e madh të gjuhës shqipe (se nuk e ka) është një lojë popullore në Dibër, lojë e fëmijëve, të rinjve dhe të rejave.

I shkon shokut a shoqes nga prapa, pa u ndjerë, e prek butë mbi shpatulla, dhe i thërret me zë të lartë që ta dëgjojnë të gjithë:

- Ta lash peçin...

Dhe ikën, vrapon, dredhon...

Ai të ndjek, vrapon, dredhon, gulçon...

Të tjerët në kor, mes duartrokitjesh, këndojnë, qeshin, lozin, thumbojnë ...

Peç...peç...peç...

Ta lashë...ta lashë...ta lashë...

Veliu në Peshkopi njihej me emër e mbiemër Veliu i Furrës për shkak se ditët e netët, edhe të nxehtat e verës edhe kallkan të dimrit, i kalonte në furrën e Dautit.Ishte një personazh grotesk popullor paraprijës i personazheve që erdhën më pas si Sehiti i Kadiut, Lam Zagradi, Ferrë Doka e që e mbushën qytetin e vogël rrëzë Korabit me gaz e hare, bile, bile edhe me hamendësimepër Ferrën se ishte spiunë i superfuqive.

Veliu herë pas here merrte një sapllak me ujë të nxehtë nga furra dhe në mes të dimrit e hidhte mbi ujin kallkantë përroit. E hidhtepër ta nxeh e për tu la. E hidhte poshtë rrjedhës dhe lahej lart...

Veliu e kishte një merak.

Nuk toleronte ta prekte kush e ti thërriste “Peç or Veli ! ”.

Të ndiqte deri sa të ta linte...

Edhe po nuk arrinte të të kapte në ato çaste ngarendjeje nëpër hapësirën e gjerë sa një stadium të pazarit, ta ruante “në kësulë”. Të mbante mend dhe, kur nuk e prisje, ndjeje mbi shpatulla dorën dhe zërin e tij të trashë “Ta lashë”...

Nuk e di se si më erdhi në kujtesë Veliu me atë mjekrën si thirri i furrës e ato rrobat blozë të zeza, me sapllakun me ujë të nxehtë e vendosmërinë e tij për të ta lënë “peçin”.

Mbase nga beteja e politikanëve që nuk pranojnë ta mbajnë mbi kurriz “peçin” që e kanë përshtatur jo me ndonjë fjalë të shqipes por me një të huaj nuk e di se nga çfarë diksionerësh gjetur, REPLIKË.

Në parlament “peçi” qarkullon aq shumë sa lodhen së ngarendur deputetët, e lodhet deri në stërlodhje kryparlamentarja për ti ndalë e për ti ndarë.

Kjo edhe në dritare televizive, kombëtare e lokale, portale, partiake e të pavarura për këmbësh (vetëm për koke).

Peçi është bërë lojë kombëtare. Jo e fëmijëve që i iknin Veliut me vrap, por i të “rriturve me grada e ofiqe” që e ndjekin njeri tjetrin me nge e me hap. Peçi është bërë lojë edhe qeveritare. Provo po të duash ti bësh një vërejtje kryeministrit.

Prodho thuash: Ta lashë!
Ngarend e ngarend, në tërë Shqipërinë.
Të gjen e thërret me të madhe.
Peç! Ta lashë!
Dhe Peçi vazhdon,
ditë për ditë,nga mëngjesi në mesnatë...
Lojë e bukur.
Të bën të qeshësh,
kur ia le.
Të bën të qajsh,
Kur ta le...

* * *

Mos harroni të luani “peç”,
fëmijë e të rritur,
djem edhe vajza.
Fushave, kodave, maleve...
Nga liqeni,
bulevardit...
Iku Ditë Vera,
Vjen Nevruzi,
Më pas Shëngjergji...
Shënkolli,
Shënmërija,
Shmitri...
festa pagane...
Merr shëndet,
zgjon humor,
ju jep jetë...
KOHË PËR PEÇ...

* * *

Eh ç'më kujtove Veliun e Furrës or mec.
Qesha dhe shkrova me lot!
PEÇ, UA LASHË!

A. ASHIKU, 15 mars, 2022

Rruga e Arbërit nr. 187

Edhe njëqind vite të lumtura mësues Nazmiu!

profil

Nazmiu, *shtatore diturie te ish nxënësit e tij*

Nga **SELMAN MËZIU**



Shkrimi i tij gjithë formësh, skicat, pikturat e futën muhurrakun mësues në udhë të reja njohje, pune krijuese, zbukurues, duke zbuluar një mjeshtër të kaligrafisë e të paraqitjeve me plot hijeshi të kandeve te ndryshme që vareshin mureve të korridoreve ose klasave.

Puna e mësues Nazmiut në brezni të shumta, duke mësuar abetaren e deri në historinë e gjeografinë e Shqipërisë ka mbetur shtatore diturie te ish nxanësit e tij. Për 28 vjet iu shërbeu muhurrakëve për shkollim. Tani ai ndjen lumturi kur ish nxanësit e respektojnë, e ftojnë në përvjetorë, festa etj. Prandaj në 81 vjetorin e lindjes, gjithë ish nxanësit dhe kolegët e urojnë me gjithë zemër: Edhe njëqind vite të lumtura!

Ishte ditë e nxehtë gushti. Në udhën që kalon pranë shkollës tetë vjeçare Fushë Muhurr kishte një shtresë pluhuri. Lëvizjet ishin të kursyera. Sa kaq udha vërtet mori një shkëlqim, ju shtua bukuria. Ndodhin zbukurime të tilla. Ju kujtoi se ndodhin rrallë në këto vite. Oborri i shkollës ishte i shkretuem. Rrethuar me trina prej binarësh me pamje joshëse. Ndërtesa e shkollës së vjetër ka formën e shkronjës U. Eh ato mure, ajo çati, natyrshëm më trazojnë kujtime të shumta vegjëlie! Ato, sa herë kur ndodhem pranë tyre më biskojnë emra mësuesish e mësuesesh, librash, orësh dituri natyre, gjuhe shqipe, fizkulturë, këndimi, aritmetike edhe abetare.

Ndalova mësuesin tim, duke i thirrur si gjysëm shekulli më parë. "Mësues, mësues jam unë Sela". Kështu më thërriste ai kur isha ulur në bankot e kësaj shkolle si nxënës. E përqafova me mall Nazmi Hamit Mëziun. Kapelja republike i hijeshonte ballin e fytyrën me mollëza të ngritura me dy sy të zes nën vetullat që merrnin hark në afërsi të hundës me kurriz paksa të ngritur. Trupi ishte i pakët, me një xhaketë që i shtonte volumin trupor.

Sa kaq filloi të recitoi qetë me një buzëqeshje të amël pjesë nga ''Lahuta e malsisë,, të Gjergj Fishtës. Ja dhe vargjet: ''Persè flamuri kuq e zí, Sod mâ s'pari, bukurí; Porsì fleta e Engjllit t' Zotit, Po valvitë mbí tokë t' Kastrjotit.,, Ai vazhdoi për disa minuta. Më habiti kujtesa e tij e plleshme. Këto ai i mësoi nga libri i këndimit kur krijimtaria e Fishtës lejohesh të mësohej në shkolla në vitet '50. Muzikaliteti i recitimit të vargjeve më dëshpëroi thellë kur kujtova 6 shkurtin e vitit 1967. Pas kësaj date letërsia u përgjysmua mizorisht. Por ja që edhe rilindka. Fatë lumësi e gjenive.

U ulëm në një tavolinë në klubin përball shkollës. Nazmiu, edhe pse ka vite i shpërngulur në Kamëz pranë kryeqytetit Tirana, katër apo pesë muaj i kalon në fshatin e lindjes Fushë Muhur. Ajri i freskët, gjelbërimi i pemëve të shumta rreth shtëpive, arat me misra, udhët dhe udhëzat i risjellin mallin e fëminisë e të rinisë së hershme. Ato vite i sjellin purpuri kujtimesh nga më të thekurat. Në shtëpinë e vogël me qita, pjekun në diell, mbuluar me kashtë thekri, lindi ai më 2 prill 1939. Pak ditë para se qiellin shqiptar ta mbulonin me pamje të frikshme e zhurmë tmerruese, aeroplanët e pushtuesve italian. U rrit nën buqitjen e pushkëve, në aromën e barotit dhe me urinë për bukën e gojës, mbushur me tmerret e luftës. Pasi mbaroi shkollën pedagogjike në Tiranë në moshën 16 vjeçare fillon detyrën e mësuesit. Ushtelenza me shkollën e saj e pritën mësuesin njomëzak Nazmiun krahëhapur.

Krahina ku lindi po rritej si ekonomi e si banor. Kërkesat edhe për mësues shtoheshin. Në detyrën e mësuesit grishën mësuesin e diplomuar. U prit me plot dashuri e respekt nga drejtori Muhamet Xhambulla. Filloi në këtë tempull të dijes ku mësonin bijtë e bashkëfshatarëve të tij. Korrektësia në detyrën e tij, përvetësimi i artit të të shpjeguarit ishin treguesit cilësor të vazhdimësisë së punës e cila zgjati pesëmbëdhjetë vjet. Mbushur me punë të gjithëfarëshme e detyra të shumta.

Krahina ku lindi po rritej si ekonomi e si banor. Kërkesat edhe për mësues shtoheshin. Në detyrën e mësuesit grishën mësuesin e diplomuar. U prit me plot dashuri e respekt nga drejtori Muhamet Xhambulla. Filloi në këtë tempull të dijes ku mësonin bijtë e bashkëfshatarëve të tij. Korrektësia në detyrën e tij, përvetësimi i artit të të shpjeguarit ishin treguesit cilësor të vazhdimësisë së punës e cila zgjati pesëmbëdhjetë vjet. Mbushur me punë të gjithëfarëshme e detyra të shumta.

Më ndillnin kënaqësi pemët frutore pas shkollës. Në pranverë hynte nëpërmjet dritareve era e kandshme e luleve të mollëve. Kishte ndodhur që ndonjë nxënës shkruante dy ose tre strofa poezi kushtuar pranverës lule shuma ta këtij kopshti magjik. Atë e kishte krijuar mësues Nazmiu. Aty lulëzonin lule që prodhonin gjithëfarë frutash, që nga qershia e deri te ftoi, arra e lajthia. Kjo përdoresh si bazë prodhuese për nxënësit muhurrak. Aty mësonin që nga mbjellja me farë, shartimin e pemëve. Shërbimet kulturore, mbledhja e frutave etj. Ato mësonin të dashuronin tokën, punën, prodhimin e ndjenin shijet e frutave të tyre. Kënaqësi pune, djerse, të mësuarit teorik e praktik ishin të tjera gjëra qe përfitonin. Kështu që vogëlushët merrnin shprehitë e bujkut, pemëtarit, agronomit të ardhshëm. Mësues Nazmiu ndiqte me kujdes punën e tyre me durim kujdes e këmbëngulje për t'iu mësuar gjithçka.

Përsëri mësues Nazmiu transferohet si mësues e bazës prodhuese të Shkollës Pedagogjike Peshkopi në vitin 1968. Ai atje gjen një mjedis të ngrohtë mësuesish dhe nxënësish. Krahas shuma punëve ai fillon edhe si disenjator. Shkrimi i tij gjithë formësh, skicat, pikturat e futën muhurrakun mësues në udhë të reja njohje, pune krijuese, zbukurues duke zbuluar një mjeshtër të kaligrafisë e të paraqitjeve me plote hijeshi të kandeve te ndryshme që vareshin mureve të korridoreve ose klasave. Udhëtimi ishte i lodhshëm nga vendlindja në qytetin e Peshkopisë. Ai bëhej me makina rasti edhe mbi zhavorre, ose duke shkuar në kambë.

Një natë tetori të viti 1967 ai ftohet te shtëpia e Dan Mëziut në Kodër të mëzeze. Merr me vete çantën me pajisjet e dizenjatorit. U ulën pranë votrës. Zjarri digjte qetësisht drutë e çara të dushkut. Xhevzia e kafes ishte vendosur mbi prushin e ndezur. Mullirin e kafes e mbushi gjyshi me kafen e sapo pjekur dhe filloi ta bluante. Tabakun e filxhanave e solli Ganiu ku hodhi kafen në ato. Oda kundërmonte aromë të kandshme kafeje. Nazmiun e ulën në krye të vendit. Ai e dinte mirë se para ardhësit e tij kishin banuar te shtëpia e madhe në këtë kodër. Pastaj ishin larguar dhe ndërtuar shtëpinë në korridorin ose rrypin e tokës të fisit Mëziu, që fillonte nga buzë Kodras sa Rame e vinte deri në fillimin e rrafshes të Thanxës. Pasi pinë kafen diskutuan me Ganiun simbolet që do të skaliteshin në gjur. Në bisedë e sipër u vendos që të vizatoheshin shqiponja, pëllumbi, emri i zotit të shtëpisë dhe viti i fillimit të punimeve. Shqiponjës nuk i vendosën në mes yllin.

Drita elektrike ndriste në dhomën shtruar me mutaf e lëkura delesh edhe pse llambat ishin të vogla. Korrenti merresh nga hidrocentrali i Fusha Muhurit. Ai ishte ndërtuar buzë murrës nën shtëpinë e Nus Lalës. Fletët e hekurta për të sjellë dinamon silleshin nga forca e ujit të vijës të Zallit. U vizatuan me laps nga Nazmiu, shqiponja, pëllumbi, shkronjat e numrat dhe pastaj u prenë format dhe u përcaktuan ngjyrat. Kuptohet shqiponja e zezë, pëllumbi i bardhë, shkronjat ta zeza. Ishin këto modele të krijuara në këtë natë tetori vjeshte, që edhe sot ndodhen të skalitura nga Gani e Sinan Mëziu në shqemat e dyerve e qoshet e gdhendura në shtëpiat e Xhetan Ismrisa, Emin e Ramadan Meziu. Mjerisht këto vepra arti ta skalitura me shije në gjurët marrë në Sukë të Leke do të zhduken nga xholi i Skavicës. Pas qindra vjetësh arkeologët do t'i zbulojnë e historianët do të shkruajnë historinë.

Përqark oborrit të shkollës në Fushë Muhurr kishte plepa kanadez të krasitur fort. Mbaheshin të tillë prej vitesh. Në punën prodhuese mësues Nazmiu ju mësonte nxanësve të shkollës të prisnin filizat një vjeçare disa metra dhe nga këto të prodhonin kalema dhjetë centimetra gjatësi. Ato i dërgonin në fidanishten e Zall Sinës. Nga këto prodhoheshin me qindra fidana plepi, një ose dy vjeçar, ku shpërndaheshin në gjithë Dibrën për t'u mbjellë. Kjo punë bëhesh çdo vit, me mijëra kalema priteshin, baheshin tufa, futeshin në arka dhe dërgoheshin në fidanishte, ku nguleshin në toka lymore të formuara nga prurjet e ngurta të Drinit të Zi.

Ishte marsi i vitit 1971 kur mësues Nazmiu na tha se këto dy orë do të mbjellim plepa. Morëm lopata e bela në bazën prodhuese të shkollës dhe shkuam në bregun e majtë të lumit Murra, përball dyqaneve e Kullës së Kuqe. Aty na priste tekniku i pyjeve Xhetan Prençi. Pasi e piketuam ranishten ku kishte pak shelgje e verrinj, filluam hapjen e gropave dhe mbjelljen. Ato ishin fidanat që kishin ardhur nga kalemat tonë. Ne i mbollëm. Ato vegjetuan qind për qind. Aty pastaj u krijua Parku Dine Doda. Siç shkruan shkrimtari Halil Rama në librin ''Muhurri histori dhe personalitete,,. Bukuria natyrore e krijuar me freskinë e ujit të lumit Murra, tërhoqi me qindra vizitor e klient par të shijuar një kafe ose ngrënë një drek me trofta murre. U shkatërrua pas viteve '90, por nga cungjet dhe rrënjët janë zhvilluar përsëri plepat. Aty u derdh djersa e jonë rinore me drejtues mësues Nazmiun e Xhetanin, bij të krahinës së Muhurrit.

Puna e mësues Nazmiut në brezni të shumta, duke mësuar abetaren e deri në historinë e gjeografinë e Shqipërisë ka mbetur shtatore diturie te ish nxanësit e tij. Për 28 vjet iu shërbeu muhurrakëve për shkollim. Tani ai ndjen lumturi kur ish nxanësit e respektojnë, e ftojnë në përvjetorë, festa etj.

Prandaj në 81 vjetorin e lindjes, gjithë ish nxanësit dhe kolegët e urojnë me gjithë zemër: Edhe njëqind vite të lumtura!

25. 03. 2022

meditim

Unë nuk isha në varrimin e babait tim*



Kur binte fjala për vdekjen, thoshte se e kishte frike vdekjen në agoni.
Im atë vdiq në gjumë.

Para pesë vitesh, duke qeshur e duke folur me zë të lartë siç e kishte zakon, im atë me pati thënë:

"Se mos bësh gabim të vish në varrimin tim! Unë nuk e kam ndërmend të hap sytë se vjen ti. Kështu që, behu e mençur, çoja paratë e biletës Edlirës të bëjë njat mort e rri rehat aty, baba shifet vetëm për së gjalli".

Kur u fejova në 1994, me pati marre mënjanë e me pati pyetur:

E ke menduar mirë se ku shkon?

E ke idenë ti sa larg është Australia?

E pashe njëherë me ato sytë e te sapofejuarës me ëndrra te mëdha e mendova: epo përse do qe të ma prishe këtë ditë im atë?

Im atë i dinte të gjitha, kohë përpara se të ndodhnin, pak përpara se të ndodhnin, kur ndodhnin dhe se çfarë do të sillnin pas.

Të gjitha.

E urreja për këtë.

Ai urrente aeroportet, vendet ku i humbisnin nga sytë dy nga vajzat e tij.

Ai kishte lindur të jetonte...

Ishte ku ishte fjala, ku qahej miku e shoku, ku pihej me opingë, ku thirrej, ku recitohej e këndohej, ku shkruhej e diskutohej.

Ishte shpirti i festes e i tavolinës, egzagjerues e manovrues i tmerrshëm, hiperbolik e cinik, kërkues e i ashpër, i dashur, i dhembshur e zemërmadh, i këndshëm, sharmant.

I mprehte, brisk!

I talentuar, punëtor.

Lis i gjatë e zogu në majë të degës se atij lisi.

Im atë ishte njeriu me kompleks që kam njohur në jetë.

Mësova ta manipuloj që në moshë shumë të vogël sepse ishte aq i paparashikueshëm sa duhet të kisha një plan te kontrolloja situatën. Vetëm një shpullë ballit më pati dhënë...

Me shpinën e dorës së djathtë, kur isha vetëm 6 vjeçe, rreth tavolinës, kur po hanim dreke një dite vere dhe na kishte kapur një e qeshur me Lidën dhe Eden sa na doli ushqimi nga hundët.

Marrëdhëniet me volatile i kishte me motrën time të dyte, Lidën, sepse ishin njësoj. Ziheshin bashkë, duheshin bashkë, pinin e këndonin bashkë, shaheshin bashkë, ishin kopje karboni te njeri tjetrit.

Krenari kishte Eden,"bashkëpunëtore artistike" më kishte mua.

Nuk me kujtohet kush i pati përkthyer shumicën e poeteve franceze të shekullit të 19-te (Baudelaire, Hugo, Verlaine, Poe etj.) por di qe kishim një antologji të mrekullueshme në bibliotekën tone, te cilën e lexonim shtate here nga nëntë dhe kishim mësuarpërmendëshshumicën e poezive përfshirë në të. Darkave, luanim një lojë ku ai recitonte një varg e unë duhet të gjeja cila poezi ishte dhe kush ishte autori. Në shtëpinë tonë vetëm lexohej, ditë e natë.

Im atë nuk mësoi gjermanisht, paçka se Horst e Lida e ftonin herë pashere ne Hasbergen por shoqëria e tyre e njohin Mimin si recituesi pasionant i Gëtes!

Nëmemorie si prind kishte te fiksuar një ftohje te hershme te Edës, fliste shpesh për atë ankth prej prindi dhe sa here kollitej Eda thoshte: e ka një ftohje te vjetër. Ne qeshnim. Eda ishte sportiste e fizikun e saj nuk e kishim unë e Lida. Eda e Shpëtimi jetuan me te gjithëjetën.

Im atë e kthente çdo sfide në një eksperiencë, diçka qe do te mbahej mend. Nuk kishte rëndësinëse ishte një mesues i thjeshte a drejtor, libretist apo kaligraf, synimi i tij ishte suksesi.

Pasi gjyshi im, babai i tij, Jonuz Shehu, u lirua nga burgu (5 vjet për agjitacion e propaganda), prindërit e mi, te dy mesues, i degdisen ne nje nga zonat me te largëta te Dibres: Katër Gryket, me qender Qafmurren. Unë isha vetëm 14 muajshe, ndaj me lanë pas te me rriste gjyshja por Eden e Lidën i morën me vete. Banoret e Qafmurres jepnin jetënpër tim atë: ai e ngriti ne këmbëzonën, energjia e tij u përqendruamenjëherë ne jetën artistike te zonës, ngriti një trupe estrade, organizoi gratë, përgatiste materialin e humorit e sigurisht ekzekutonteçdo projekt. Po ta kërkosh, ka talent kudo, thoshte.

Ata njerëz u bene familja jone e dyte, miq te përjetshëm. Partia pastaj te afronte pak: në Brezhdan, i adhuronte nxënësit e tij. Ishte varfëri e tmerrshme, nuk kishte drithë e sapun, fëmijët vinin ne shkolle me një dru nen sqetull. Por nxënësit e tij ishin te lumtur. I studionte personalitetet e tyre, karakteret, iu bënte fotografi artistike dhe na i prezantonte ne shtëpi, iu përshtaste mënyrën e te nxënit. Një ditë, pasi kishte bere kontrollin e pastërtisë, i kishte vene ne rresht per një djemtë dhe i kishte dërguar tek berberi i fshatit: i kishte qethur, i kishte dërguar tek çezma e fshatit, iu kishte lare këmbë e duar me ujë e sapun te sjelle nga shtëpia dhe i kishte kthyer ne klase.

Çdo gjë e bënte me pasion, madje edhe parullat e partisë komuniste qe shkruanin me Dash Alliun! Ishte një kaligrafist i shkëlqyer dhe mbaj mend qe një here, i kishin komisionar te dy te freskonin te gjitha parullat e qytetit. Im ate e Dashi ishin antikomuniste te lindur...te qeshurat e tyre tek kthenin penelat me mjeshtëri ne letër, shakatë e tyre, tregoheshin te nesërmen neper tavolina. Dashi vdiq shume i ri. Samiu qau me zë. Bajram Mata, piktor i madh e njeri i mrekullueshëm, mik i ngushte, vdiq i ri. Samiu e qau si fëmijë. Im atë nuk qe kurrë me si me pare pas vdekjes se xhaxhit Bajram. Hysen Lala, mik e shok, bashkëpunëtor qe ne Qafmurre, vdiq shume i ri, i ishte zbardhur fytyra e zeshket kur na dha lajmin. Mirush Mati, mik i një jete, shok e vëlla, vdiq i ri, Samiu e solli kujën ne shtëpi. Im atë jepte jetën per shoqërinë.

Por treshja qe mban mend Peshkopia besoj ishin Samiu, Shpresa dhe Bardhi. Kjo treshe janë protagonistët e tregimit tim: "Gruaja ime ka nevoje per kostum". Miqtë e tim eti ishin miqtë e shtëpisë...ne çdo kohe, ne çdo ore te ditës dhe kur ndonjëherë ime ëmë gjendej e papërgatitur e trishtohej ne fytyre kur shikonte miq tek dera, im atë ia priste: Kumrie, e zonja e shtëpisë e nderon burrin kur i pret mysafiret me buzëqeshje! Ç 'rëndësi ka nëse nuk ke kafe e raki e dashur! Dhe aty fillonte humori e vazhdonte me ore te tera.

Im atë ishte gjuetar thëllëzash e lepujsh, derrash e rosash. Im atë ishte peshkatar, vinte bast se zinte aq e kaq peshq dhe e fitonte. Im atë gatuante çomlekun me te shijshëm ne bote: dy këmbë te pasme lepuri te egër, një kilogram qepe te vogla, një gote ujë, një gote vere e kuqe, një gote vaj ulliri, kripe e piper i zi dhe gjethe dafine, ne tenxhere me presion!! Im atëbënte raki! Double distilled! Dhe pastaj gatuante kukurecin me te mire ne bote!

Im atë kishte trupin me te drejte e fizikun me te forte ne bote, hapin me te gjate e ecjen me te shpejte. I kam ngjare ne shume gjera.

Im atë, ati i Edes dhe Lides, bashkëshorti i një jete i Kumries, djali i Jonuzit e Hafizes, vëllai i Sabahut dhe i Dritës, gjyshi i Bores, Erblinit, Elmes, Mariusit e Kodit, xhaxhi i Nerit e Gezimit, daja i Letes, Besit e Benit, ishte i vetmi Mim qe kishim. Mimi nuk është më.

Nga e ëma, Mimi vinte nga një familje jetegjatesh. Por kur iu fiken shokët e humbi dëshirën per jetën. Miqtë e tij ishin jeta e tij.

Shpesh i thonim me shaka: po si nuk vdiqe o burrë i dheut!!

Na e kthente: qe te tëvdesë baba, duhet me e dashtë fort. Duhet të lerë pas njerëz qëpikëllohen për të, duhet me i shkretu njerëzit e vet. Duameni fort që të vdes!

PS: unë nuk ia kam dërguarparatë e biletës Edes për funeralin e tim ati. Per të u kujdesën mami dhe Eda. Këto tre javët e fundit Lida preu një bilete vetëm për të shkuar dhe i qëndroipranë gjer në momentin e fundit.

**Ky post feston jetën e tij. Nëse mbani mend një anekdote a histori të treguar nga im atë, ju lutem ta postoni në komente.*

Ai kishte lindur të jetonte...
Ishte ku ishte fjala, ku qahej miku e shoku, ku pihej me opingë, ku thirrej, ku recitohej e këndohej, ku shkruhej e diskutohej.
Ishte shpirti i festes e i tavolinës, egzagjerues e manovrues i tmerrshëm, hiperbolik e cinik, kërkues e i ashpër, i dashur, i dhembshur e zemërmadh, i këndshëm, sharmant.
I mprehte, brisk!
I talentuar, punëtor.
Lis i gjatë e zogu në majë të degës se atij lisi.
Im atë ishte njeriu me kompleks që kam njohur në jetë.

Kur iku në përjetësi Sami Shehu

Ia kam lexuar shpirtin derdhur në vargje...

Ia kam parë gazin dhe harenë kur udhëtoi nga Melburni në Athinë thjesht për të pi një kafe në shtëpinë time e për të më uruar për martesën e djalit.

Nuk ishte vetëm. Ishte edhe e ëma, Kumria, Kumrie Lahi siç e njoha për herë të parë në vitin 1954, bashkë, në një klasë në shkollën shtatëvjeçare të Peshkopisë, Kumrie Shehu...

Ishte një nder që mu bë...

Nuk ma bënë as gjaku im...

Pas tyre, pas Kumries dhe Mirandës, ishte Sami Shehu...

Desha ta them një fjalë të mençur për Samiun, mësuesin e fshatit tim, bashkëpunëtor në shumë veprimtari.

Ma "ndali" Miranda...

Më shumë se ajo, më shumë se vajza, askush nuk e gjen fjalën për babanë...

Një elegji, një vajtim dhe një buzëqeshje, dalë nga shpirti, qarkulluar në gjak nga zemra...

Po përcjell fjalët e saj, shkruar sa poetët e elegjive, njerëzit që e njohën Sami Shehun, ulen në gjunjë...

Kështu janë vajzat...

I PËRJETSHËM KUJTIMI I SAMI SHEHUT!

Abdurahim Ashiku
Athinë, 21 mars 2022

BIGmarket

një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

Së shpejti...

HAP MARKETIN E RI NË PESHKOPI,
Rruga "Abdyl Frashëri", pranë kryqëzimit të policisë

Plot oferta dhe surpriza...

GJITHMONË KA OFERTA EDHE NË MARKETET E TJERA NË:
PESHKOPI MAQELLARË

Librat më poshtë dhe plot libra të tjerë i gjeni me 20% zbritje Gjatë gjithë muajit Prill 2022



700 lekë




1000 lekë




1000 lekë




1000 lekë



1500 lekë



800 lekë




1000 lekë



500 lekë



1000 lekë



800 lekë